



TË ZËNË NGUSHTË: SFIDAT E KOSOVËS NË PËRBALLJEN ME PANDEMINË COVID-19



Autorë: Teuta Avdimetaj

Plator Avdiu

Shpat Balaj

Kontribuese: Donika Marku

Redaktim i brendshëm: Mentor Vrajolli

Redaktim i jashtëm: Garentina Kraja

Shënim: Ky raport fillimisht është shkruar në Anglisht

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

B | T | D The Balkan Trust for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Ky publikim është realizuar me mbështetjen e Trustit Ballkanik për Demokracinë (BTD) në kuadër të projektit "COVID-19: Gatishmëria ndaj emergjencave dhe menaxhimi i krizave në Kosovë". Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të BTD-së, Fondit Gjerman Marshal të Shteteve të Bashkuara ose partnerëve të tij.

TË ZËNË NGUSHTË:
SFIDAT E KOSOVËS NË PËRBALLJEN ME
PANDEMINË COVID-19

Dhjetor, 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E AKRONIMEVE.	1
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	2
GJETJET KYÇE	2
REKOMANDIME PËR INSTITUCIONET E KOSOVËS.	4
METODOLOGJIA.	6
HYRJE.	7
KONCEPTET KYÇE: NJË DISKUTIM I SHKURTËR	9
RISQET E SITUATAVE EMERGJENTE NË KOSOVË.	11
MUNGESA E NJË ANALIZE KONSISTENTE PËR GATISHMËRINË DHE REAGIMIN NDAJ FATKEQËSIVE.	13
TË VEPRUARIT NË VAKUM: MOSANËTARËSIMI I KOSOVËS NË ORGANET NDËRKOMBËTARE. .	14
DISPOZITAT KUSHTETUESE GJATË NË GJENDJE EMERGJENCASH	15
KORNIZA LIGJORE.	17
KORNIZA STRATEGJIKE	20
HARTËZIMI I PALËVE TË INTERESIT.	26
PANDEMIA COVID-19 DHE REAGIMI I KOSOVËS	31
SFIDAT NË ZBATIMIN E MASAVE PARANDALUESE	41
PASOJAT POLITIKE TË COVID-19	45
IMPLIKIMET NDAJ SUNDIMIT TË LIGJIT DHE SIGURISË.	48
IMPLIKIMET SOCIO-EKONOMIKE DHE NDIKIMI NË TË DREJTAT E NJERIUT DHE LIRITË CIVILE	51
KONKLuzion.	54
BIBLIOGRAFIA.	55

LISTA E AKRONIMEVE

ZRRF	Zvogëlimi i Rrezikut nga Fatkeqësitë
SPH	Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm
ECDC	Qendra Evropiane për Kontrollin e Sëmundjeve
AME	Agjencia e Menaxhimit Emergjent
QK	Qeveria e Kosovës
KHV	Korniza Hyogo për Veprim
SIME	Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
PK	Policia e Kosovës
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
FSK	Forca e Sigurisë së Kosovës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSH	Ministria e Shëndetësisë
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike
PRK	Plani i Reagimit Kombëtar
KSZRRF	Korniza Sendai për Zvogëlim të Rrezikut nga Fatkeqësitë
RSSS	Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë
BB	Banka Botërore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim ofron një pasqyrë kritike të kornizës kombëtare të Kosovës për reagim ndaj emergjencave dhe menaxhim të krizave, duke përfshirë edhe kornizën ligjore dhe strategjike për trajtimin e emergjencave, si dhe rolet e institucioneve kyçe të përfshira në planifikimin dhe kundërpërgjigjen ndaj emergjencave. Përmes kësaj qasjeje, studimi synon të qartësojë faktorët që ndikojnë në efikasitetin e reagimit institucional ndaj krizave, të cilët shkaktohen, ndër të tjera, nga mungësitë e mundshme në kornizën ligjore, dykuptimësi në raport me rolet dhe përgjegjësitë e akterëve relevantë, çështjet e koordinimit mes institucioneve përkatëse, alokimi i pamjaftueshëm i fondeve, mungësa e trajnimeve dhe kapacitete të limituara të stafit. Ky studim vë në pah disa nga mospërputhjet madhore në kornizën ligjore, strategjike dhe të politikave mirëpo nuk paraqet një analizë të detajuar në këtë aspekt. Pjesa e parë e këtij studimi paraqet ligjet dhe dokumentet kryesore strategjike që drejtojnë politikëbërjen gjatë situatave të lidhura me emergjencat në Kosovë. Pjesa e dytë e studimit shtjellon reagimin e Kosovës gjatë pandemisë COVID-19 duke u fokusuar në ndikimin e përhapjes së sëmundjes në dimensione të ndryshme të jetës së qytetarëve, përfshirë pasojat politike, implikimet ndaj sigurisë, si dhe efektet socio-ekonomike. Pandemia COVID-19 paraqet krizën e parë në shkallë të gjerë me të cilën janë përballur institucionet e reja të Kosovës. Edhe pse situata pandemike e COVID-19 është ende në zhvillim e sipër në Kosovë dhe më gjerë, dhe mësimet e nxjerra nga kundërpërgjigjja kritike do të jenë të shumta, prapëseprapë që në këtë fazë bien në sy një numër i gjetjeve kyçe. Ky studim tregon se për shkak të mungesës së planifikimit, shumica e masave të marra nga qeveria nuk kanë qenë të mjaftueshme që COVID-19 të adresohet në mënyrë efektive dhe që jostabiliteti politik ka ndikuar që situata të vështirësohet edhe më tej. Në tërësi, përgjigjja e Kosovës në përballje me pandeminë vlerësohet si një kombinim i disa sukseseve në fazat më të hershme, dështime të shmangshme, dhe shumë të meta, gjë që ka krijuar konfuzion tek qytetaret dhe të lënë në mëshirën e fatit.

Kur puna për hartimin e këtij raporti ishte drejt përfundimit, qeveria Hoti ra pas vendimit të marrë nga Gjykata Kushtetuese, duke hapur kështu rrugën drejt zgjedhjeve të reja deri nga mesi i shkurtit. Gjasat janë që procesi zgjedhor t'i shpërqendrojë edhe më tej autoritetet e Kosovës nga ofrimi i një kundërpërgjigjeje efektive dhe të fokusuar ndaj pandemisë.

GJETJET KYÇE

- Në morinë e prioriteteve konkurruese të procesit të rindërtimit pas konfliktit dhe të përpjekjeve për shtetndërtim pas pavarësisë, gatishmërisë për emergjencë dhe menaxhimin të krizave i është kushtuar më pak vëmendje, përkundër faktit se ky sektor i sigurisë kërkon parashikim dhe planifikim strategjik. Të pakta janë masat e vendosura me qëllim që të parandalojnë ose adresojnë në mënyrë adekuate krizat e tilla përmes një kombinimi të mjeteve legjislative, të politikave dhe planeve operationale. Çështja ndërlikohet edhe nga mungesa e studimeve në lidhje me gatishmërinë ndaj emergjencave dhe menaxhimit të krizave në Kosovë, duke krijuar një hendek të njohurive si në mesin e politikëbërësve ashtu dhe publikut.
- Kosova përballlet me një numër risqesh që mund të shkaktojnë emergjencë në shkallë të gjerë e të kërcënojë sigurinë e qytetarëve të saj, duke vënë në provë kapacitetet institucionale për parandalimin e krizave për t'u përgatitur dhe për të reaguar ndaj tyre, por edhe kapacitetet e tyre për rimëkëmbje. Këto kërcënime mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale në komunitetet më të pafavorizuara, si dhe përkeqësohen nga cenueshmëritë ekzistuese, siç

janë ekonomia e brishtë, kapacitetet e kufizuara të shëndetësisë publike dhe ndërtimet e paligjshme në zonat e rrezikshme.

- Edhe pse Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban disa dispozita në lidhje me emergjencat, kjo nuk është e mjaftueshme për ta parandaluar dykuptimësinë ligjore në praktikë, veçanërisht në aspektin e përcaktimit të rrethanave që justifikojnë ose kërkojnë deklarimin e një emergjence mbarëkombëtare apo përcaktimit të roleve institucionale për kundërpërgjigjen ndaj saj.
- Për të informuar politikëbërjen dhe për rritur vetëdijesimin e publikut në lidhje me situatat emergjente, vlerësimet e rregullta të rrezikut që mbështeten në dëshmi janë të domosdoshme, përfshirë përdorimin e sistemeve të paralajmërimit të hershëm. Vlerësimet ekzistuese të rreziqeve janë të vjetëruara apo jo mjaftueshëm gjithëpërfshirëse për të mbuluar spektrin e rreziqeve dhe kërcënimeve me të cilat përballet Kosova - për shkak të planifikimit apo prioritizimit të dobët nga ana institucionale, mungesës së resurseve dhe kapaciteteve, dhe mungesës së një strukture funksionale institucionale për koordinimin dhe realizmin e vlerësimeve të rrezikut në mënyrë periodike.
- Ligjet ekzistuese të Kosovës përmbajnë dispozita për trajtimin e emergjencave, por ende ka hendekë kur flitet për sqarimin e roleve dhe përgjegjësi të palëve kyçe të interesit në kohë krize, mbulimin e një spektri më të gjerë të situatave emergjente, forcimin e dispozitave për të drejtat e njeriut dhe liritë civile gjatë një gjendje të jashtëzakonshme, promovimin e një qasjeje më gjithëpërfshirëse ndaj planifikimit të politikave dhe reagimit ndaj fatkeqësive, dhe reziliencën pas emergjencës. Po ashtu, ligjet e humbasin forcën edhe nga zbatimi i dobët.
- Shumica e dokumenteve strategjike në lidhje me gatishmërinë ndaj emergjencave dhe menaxhimin e krizave janë të skaduar apo të vjetëruara. Edhe pse që nga viti 2010 janë bërë ndryshime në legjislacion, Strategjia e Sigurisë Kombëtare, SIME dhe PRK-ja nuk janë përditësuar, dhe gjatë këtyre dhjetë viteve nuk është hartuar ndonjë dokument i ri strategjik - ligjërisht i detyrueshëm - për adresimin e situatave të lidhura me emergjencat.
- Ka mbivendosje dhe/ose dykuptimësi në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e akterëve relevantë dhe nuk është vendosur ndonjë proces i qartë dhe i qëndrueshëm në kohë krize;
- Kosovës i mungon qasja parandaluese si dhe ka kapacitete të kufizuara për gatishmëri; planet ekzistuese për zvogëlimin e rrezikut nga situatat emergjente, edhe pse me fushëveprim të kufizuar, nuk zbatohen plotësisht dhe, për pasojë, entitetet kyçe të përfshira në reagim nuk janë të informuara dhe të trajnuara në mënyrë adekuate për kundërpërgjigje ndaj emergjencave.
- Nuk realizohen masa me bazë komunitetin për të zvogëluar rrezikun, dhe nuk bëhen përpjekje për gatishmëri ndaj emergjencave në të cilat akterë të ndryshëm në shoqëri të përfshihen përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse.
- Qasja e Kosovës në përballje me COVID-19 u sfidua nga mungesa e qasjes parandaluese dhe përgatitore ndaj situatave emergjente, mungesa e bazës së qartë ligjore për vendimet e qeverisë, kufizimet në resurse dhe kapacitetet e stafit, luhatjet e besimit të publikut në institucione, pretendimet për keqmenaxhim dhe diskriminim, dhe mungesa e një sistemi të qartë, transparent dhe konsistent për komunikim me publikun.
- Pandemia COVID-19 ka pasur implikime domethënëse në politikë, në sundimin e ligjit, në fushën e sigurisë, si dhe atë socio-ekonomike. Ajo e ka përkeqësuar paqëndrueshmërinë

politike dhe i ka thelluar problemet socio-ekonomike, duke përfshirë edhe privimin në e komuniteteve më të pafavorizuara, siç janë gratë dhe pakicat. Ajo ka ekspozuar cenueshmëritë në sektorin e sigurisë, veçanërisht në hapësirën kibernetike - duke çuar në rritje të sulmeve kibernetike. COVID-19 ka ndikuar në sundimin e ligjit, por më së shumti është përdorur si justifikim për mungesën e rezultateve në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, të cilat janë të lidhura me vonesat dhe pandëshkueshmërinë sistematike.

- Eksiston një mungesë informatave publike mbi proceset e politkës në institucionet e Kosovës gjatë situatave të reagimit ndaj emergjencave dhe dhënies së ndihmave, duke përfshirë reagimin e shtetit ndaj pandemisë COVID-19.
- Niveli i ulët i besimit në institucione e ka minuar kundërpërgjigjen efektive dhe efikase ndaj pandemisë.
- Mosanëtarësimi i Kosovës në organet ndërkombëtare pengon më tej përpjekjet për një qasje më efektive ndaj situatave emergjente, çka krijon një hendek të njohurive, e bën më të vështirë qasjen në fonde, si dhe vështirëson bashkëpunimin ndërkombëtar për parandalimin dhe reagimin ndaj fatkeqësive.
- Vazhdimi i krizës politike në vend e vë në rrezik një kundërpërgjigje efektive dhe të fokusuar ndaj pandemisë.

REKOMANDIME PËR INSTITUCIONET E KOSOVËS

- **Të shqyrtohen dhe plotësohen ligjet ekzistuese në lidhje me emergjencat** për t'i sqaruar dykuptimësitë ekzistuese që burojnë nga dispozitat kushtetuese ose hendekët në legjislacion, për aspekte të tilla si mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive civile gjatë emergjencave ose caktimi i roleve dhe përgjegjësive në kohë krizash.
- **Të përditësohet korniza strategjike** për të siguruar që orientimi i dokumenteve strategjike i reflekton nevojat e qytetarëve për siguri në raport me evoluimin e kërcënimeve. Posaçërisht, nevojë urgjente është që të përditësohen Strategjia e Sigurisë Kombëtare, SIME dhe PRK-ja.
- **Të kryhen vlerësimeve të rregullta dhe ndërsektoriale të rreziqeve nën koordinimin e një organi të veçantë institucional** për të identifikuar në mënyrë periodike rreziqet e reja të sigurisë dhe kërcënimet ndaj sigurisë së qytetarëve, dhe të përdoren këto gjetje për të informuar politikëbërjen dhe publikun.
- **Të promovohet një kulturë e reziliencës ndaj fatkeqësive** dhe të vihet në praktikë qasja e "rindërtimit më të mirë" duke mësuar nga krizat e mëparshme, zvogëluar ndikimin trazues të krizave, dhe duke i mundësuar shoqërisë që të përshtatet më shpejt me modalitetet e reja organizative në shoqëri pas krizave. Kjo përfshin rritjen e vetëdijesimit të komuniteteve për rrezikun dhe cenueshmëritë ndaj fatkeqësive, veprimet që mund të ndërmerren për zbutjen e atyre rreziqeve, si dhe organizatat/institucionet parësore të ngarkuara me kundërpërgjigjen.
- **Të krijohet një sistem funksional për menaxhim të emergjencave** që shfrytëzon kapacitetet dhe resurset e koordinuara për një qasje efektive në lidhje me përgatitjen,

reagimin dhe rimëkëmbjen nga kriza.

- **Të forcohet bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë dhe anëtarësimi në organet ndërkombëtare në lidhje me parandalimin dhe reagimin ndaj fatkeqësive**, p.sh. duke forcuar kapacitetet lokale dhe duke i standardizuar praktikat e menaxhimit të emergjencave për ndërveprim më të madh me entitetet e tjera. Kosova do të përfitonte nga ndarja e njohurive, përvojës, fondeve dhe ekspertizës, si dhe do të shtonte kontributin e vetë Kosovës në përpjekjet rajonale dhe ndërkombëtare për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe reagimin ndaj emergjencave.

- **Të sigurohet një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj vendimmarrjes në lidhje me përgatitjen dhe reagimin ndaj krizave** duke qenë se situatat emergjente mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale tek komunitetet e marginalizuara. Gjithashtu është e nevojshme të përvetësohet një qasje pjesëmarrëse që i përfshin komunitetet e prekura lokale në kundërpërgjigjen më të barabartë dhe më efektive ndaj krizave.

- **Të rritet niveli i transparencës në procesin e vendimmarrjes në lidhje me situatat e emergjencave**, përfshirë gjatë COVID-19, duke vënë në dispozicion të publikut dokumentet përkatëse të planifikimit të politikave, vlerësimet e rrezikut dhe kërcënimeve, dhe dëshmi të tjera që informojnë politikëbërjen. Të shpërndahet informacion i saktë, në kohën e duhur, dhe që e mban publikun të informuar, paralelisht me përpjekjet për adresimin e dezinformimit. Kërkohet transparencë më e madhe edhe për të adresuar nivelin e ulët të besimit të publikut në institucione dhe luhatjet e qëndrimeve ndaj kundërpërgjigjes së tyre.

METODOLOGJIA

Ky raport mbështetet në të dhëna cilësore dhe sasiore të mbledhura përmes qasjes së metodave të kombinuara. Përmbajtja e këtij raporti u siguroi përmes hulumtimit, intervistave me palët e interesit, si dhe të dhënave të anketimit të mbledhura përmes instrumentit të Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS).

Fillimisht, është shqyrtuar literatura për të ndërtuar kontekstin dhe për të qartësuar të kuptuarit e koncepteve kyçe që lidhen me situatat emergjente dhe reagimin ndaj krizave. Në këtë aspekt, u konsultuan artikuj studimorë, dokumente të politikave dhe komentë të mediave rreth përkufizimeve dhe dilemave në fushën e hulumtimit të situatave emergjente. Veç kësaj, u realizua edhe një analizë e dokumenteve duke përfshirë, kornizën ligjore dhe strategjike, në mënyrë që të eksplorohej qasja e Kosovës ndaj përgatitjes, reagimit, menaxhimit dhe rimëkëmbjes nga situatat emergjente. Ky shqyrtim përfshiu shohitjen e ligjeve kryesore që udhëheqin politikën për situata emergjente dhe reagimin ndaj krizave në Kosovë. Së fundmi, studimi përfshin një shqyrtim të dokumenteve strategjike kombëtare, protokolleve institucionale dhe mandateve specifike për agjenci/institucione të ndryshme. Një qasje e tillë mundëson të kuptuarit më të mirë të roleve dhe përgjegjësisë të entiteteve të ndryshme duke e pozicionuar çështjen në kontekstin e temave më të gjera, siç është siguria kombëtare.

Raporti u plotësua edhe nga intervistat me palët e interesit. Këto intervista ofruan informacione nga politikëbërësit, punëtorët në vijën e parë, dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile. Këto të dhëna ishin posaçërisht të dobishme për të siguruar një pasqyrë të brendshme të përpjekjeve të Kosovës në përballje me pandeminë COVID-19. Palët e interesit theksuan sfidat aktuale, hendekët ekzistues institucional dhe organizativ, dhe rekomandime konkrete si të përmirësohet reagimi ndaj krizave në të ardhmen. Për më tepër, studimi shfrytëzon të dhëna sasiore të marra nga Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS), një instrument i posaçëm përmes të cilit Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) studion perceptimet publike në mbarë Kosovën për të matur besimin e publikut në institucione, perceptimet ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve, dhe çështjet prioritare që duhet të adresohen.

Studimi ofron edhe njohuri për nivelin aktual të gatishmërisë dhe reagimit të politikave ndaj emergjencave kombëtare në Kosovë. Megjithatë, ky studim përmban një sërë kufizimesh. Përgjatë punës në këtë raport, shkalla e infeksioneve dhe vdekjeve nga COVID-19 arriti kulmin në "valën e dytë" të pandemisë, përkatësisht në nëntor dhe dhjetor, dy muajt me më shumë raste të vdekjeve si pasojë e COVID-19 në Kosovë. Shifrat gjithnjë e më të rënda të pandemisë ndikuan ndjeshëm në hulumtim, duke qenë se palët kyçe të interesit që ishin angazhuar në përgjigjen ndaj e pandemisë ose nuk ishin të disponueshëm për intervista ose i shtynë ato. Për më tepër, vlen të ceket edhe mungesa e të dhënave të qasshme për publikun për proceset e vendimmarrjes së institucioneve gjatë situatave të reagimit ndaj emergjencave. Për qëllimet e këtij studimi, koncepti i emergjencave përmendet në kuptimin më të gjerë me arsytimin se shpesh herë vendet përballen me kriza konvergjente dhe iu duhet të trajtojnë më shumë se një lloj krize në të njëjtën kohë. Sidoqoftë, për një analizë më të plotë të kundërpërgjigjes së një shteti, mund të jetë më e dobishme që fokusi të vihet në një lloj të caktuar krize.

HYRJE

Të gjitha vendet - qofshin të zhvilluara dhe me më shumë resurse, apo në zhvillim dhe me mjete të kufizuara - përballen me sfida të shumta në reagimin ndaj emergjencave. Emergjencat mund të shfaqen nga fatkeqësitë natyrore deri te katastrofat e shkaktuara nga njeriu, fatkeqësi në shkallë të gjerë që shpesh janë të pamundura të parashikohen dhe që shkaktojnë një shkallë të madhe shkatërrimi që vështirë se mund të sanohet plotësisht ndonjëherë. Kriza të tilla mund të shkatërrojnë sistemet infrastrukturore dhe trazojnë jetët e njerëzve, duke vënë në rrezik sigurinë, shëndetin dhe qasjen e tyre në shërbime bazike. Për më tepër, emergjencat e përmasave të mëdha shkaktojnë edhe vuajtje në mesin e popullatës dhe humbje të jetëve, dhe jo gjithmonë kufizohen brenda kufijve kombëtarë. Teksa në shumë raste është e vështirë që situatat emergjente të parashikohen, prapëseprapë, për t'i zbutur pasojat e krizave dhe për ta zvogëluar rrezikun shtetet mund të ndër marrin një numër masash në fusha të tilla si legjislacioni, planet e veprimit, alokimi i buxhetit, mekanizmat dhe protokollet e koordinimit, kapacitetet e zgjeruara institucionale, trajnimi i personelit, vetëdijesimi publik dhe angazhimi gjithpërfshirës i komunitetit.¹ Përveç këtyre masave, vëmendje e posaçme duhet t'u kushtohet grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara, të cilat mund të preken në mënyrë disproporcionale nga krizat për shkak të karakteristikave të tyre specifike socio-ekonomike ose gjeografike, të cilat i vënë anëtarë të caktuar të shoqërisë në risk më të madh. Për vendet si Kosova, që ende janë në proces të konsolidimit të institucioneve demokratike dhe të ndërtimit të kapaciteteve, trajtimi i situatave emergjente mund të jetë një detyrë veçanërisht e rëndë për shkak të resurseve të kufizuara, mungesës së përvojave të mëparshme të cilave mund t'u referohen, dhe paqëndrueshmërisë së vazhdueshme politike. Rishikimi Strategjik i Sektorit të Sigurisë 2012-2014 (RSSS) në Kosovë theksoi se duhet të njihen kërcënimet jokonvencionale që vijnë nga fatkeqësi të tilla si tërmete, vërshime, zjarre ose përhapje të sëmundjeve ngjitëse.²

Mungesa e dukshme e fokusit adekuat të politikave dhe ndërtimit të kapaciteteve për këtë sektor u ekspozua veçanërisht nga shfaqja e pandemisë COVID-19, e cila i ka shpërfaq mangësitë e sistemit në lidhje me reagimin ndaj emergjencave kombëtare dhe administrimin e krizave. Ngjashëm me shumë vende të tjera nëpër botë, Kosova është munduar t'i vërë fre përhapjes së virusit ndërkohë që përpiqet t'u japë zgjidhje morisë së sfidave politike, ekonomike dhe logjistike në reagimin e saj të politikave. Përveç shqetësimeve në lidhje me shëndetin publik, pandemia ka krijuar efekte mpakëse socio-ekonomike dhe politike, të cilat kërcënojnë t'i përmbysin proceset zhvillimore në Kosovë, përparimin e reformave institucionale dhe funksionimin e përgjithshëm të demokracisë. Gjithashtu, situata aktuale pandemike nënvizon rëndësinë që ka besimi i publikut në institucionet për të mbajtur kontratën sociale mes qeverisë dhe qytetarëve të saj. Në rastin e Kosovës, niveli i ulët i besimit të publikut në institucione ndikoi drejtpërdrejt në gatishmërinë e qytetarëve për t'i respektuar masat kufizuese të vendosura nga qeveria si kundërpërgjigje ndaj pandemisë dhe për të frenuar përhapjen e saj.

Pjesa e parë e këtij studimi fillon me një diskutim të koncepteve dhe përkufizimeve kyçe që ndihmojnë për formulimin e çështjes së situatave emergjente dhe menaxhimit të krizave. Më pas ofrohet një përmbledhje e shkurtër e rreziqeve dhe kërcënimeve në Kosovë me potencial për t'u krijuar situata emergjente të përmasave të gjera. Më tej, ky studim ofron një pasqyrë të kornizës ligjore dhe strategjike të Kosovës, duke pasur si qëllim paraqitjen e legjislacionit kyç në lidhje me kapacitetet e vendit për gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje nga krizat. Përmes kësaj, studimi vë në pah zbatësitë ekzistuese në legjislacion që mund të ndikojnë në efikasitetin e kundërpërgjigjes. Studimi po ashtu hartëzon entitetet kryesore institucionale që janë të mandatuar me trajtimin e

¹Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), fq .9 https://www.who.int/hac/techguidance/preparedness/emergency_preparedness_eng.pdf?ua=1

² Zyra e Kryeministrit, "Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës."

emergjencave në Kosovë. Pjesa e dytë e këtij studimi shqyrton përvojën e Kosovës në trajtimin e virusit të ri COVID-19, duke theksuar efektet e ndryshme socio-ekonomike, politike, në shëndetin publik si dhe sigurinë. Duke u shërbyer nga ky diskutim dhe mësimet e reja të nxjerra në lidhje me adresimin e krizave të tilla siç është pandemia aktuale, ky dokument parashton një numër rekomandimesh në mënyrë që të përmirësohet aftësia e Kosovës për parandalim, reagim dhe rimëkëmbje më efektive nga krizat e ngjashme të përmasave të gjera.

KONCEPTET KYÇE: NJË DISKUTIM I SHKURTËR

Që në fillim të këtij studimi, është e rëndësishme të sqarohen disa koncepte kyç për të kuptuar situatat emergjente në përgjithësi dhe qasjet specifike të zgjedhura nga shtetet si kundërpërgjigje ndaj tyre. Një emergjencë përkufizohet si një “ngjarje e papritur, e cila vë në rrezik jetën dhe/ose pasurinë dhe kërkon një kundërpërgjigje të menjëhershme përmes përdorimit të resurseve dhe procedurave rutinore në komunitet.”³ Fatkeqësia është term që i referohet një hataje që e tejkalon kapacitetin përballues të popullatës së prekur, që shkaktohet nga rreziqet natyrore ose teknologjike ose nga veprimi njerëzor, dhe që rezulton në humbje të mëdha për njerëzit, infrastrukturën ose mjedisin.⁴ Kriza është një nocion tjetër që përfshin ngjarje dhe procese që bartin “kërcënime të rënda, pasiguri, rezultate të panjohura, dhe urgjencë” me pasoja kaq kritike sa të lënë gjurmë historike në kombe, grupe dhe jetë njerëzish - shpesh duke shërbyer si pika historike referimi për të bërë dallimin mes së kaluarës dhe së tashmes.⁵ Në literaturë ekziston tendenca që këto terma të përdoren në vend të njëri tjetrit, edhe pse në varësi të vendit ose kontekstit organizativ ato mund të nënkuptojnë dukuri të ndryshme. Si emergjencat, ashtu edhe krizat mund të kthehen në fatkeqësi, ndërsa një fatkeqësi është në vetvete situatë emergjente nëse mund të paralajmërohet para kohe.⁶ Ato gjithashtu mund të ndryshojnë në aspektin e shkallës, duke përfshirë ngjarje lokale, kombëtare, rajonale ose ndërkombëtare, dhe të kërkojnë një qasje holistike që mund të përfshijë një mori aktorësh të tillë si qeveritë, organizatat joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare.

Në aspektin konceptuale, modele të ndryshme përdoren për të kuptuar qasjen institucionale për të borjtur qytetarët, infrastrukturën dhe mjedisin në situata krize. Përgjithësisht, këto qasje përfshihen në tre kategori të gjera: a) parandalimi dhe gatishmëria, b) reagimi dhe menaxhimi, dhe c) rimëkëmbja dhe rezilienca. Planifikimi i emergjencave është një fushë relativisht e re zhvillimi i së cilës nxitet nga intensifikimi i rreziqeve, shtimi i cenueshmërive, dhe shfaqja e risqeve të reja.⁷ Parandalimi i emergjencave është procesi i përgatitjes sistematike për kontigjencat e ardhshme duke vendosur një plan për menaxhimin e ngjarjeve, si p.sh. përmes detyrave dhe përgjegjësisive të specifikuara institucionale, mekanizmave të komunikimit, fondeve të alokuara dhe trajnimit ose burimeve njerëzore.⁸ Këtu përfshihen programe që përdoren për të mbështetur dhe zgjeruar reagimin ndaj një emergjence ose fatkeqësie. Edhe pse gjatë përballjes me realitetin e krizës planet e përgatitura jo gjithmonë zbatohen në mënyrë të përsosur, ato janë esenciale për identifikimin e nevojave ekzistuese dhe munden të luajnë një rol vërtet të rëndësishëm për zbutjen e rrezikut dhe zvogëlimin e pasojave njerëzore dhe infrastrukturore nga emergjencat. Ato mund të marrin parasysh elementët e përbashkëta të të gjitha rreziqeve si dhe nevojën për plane specifike për rreziqe të caktuara të bazuara në vlerësimet e riskut.⁹

Zvogëlimi i rrezikut është çdo veprim për minimizimin e ndikimit të një fatkeqësie të mundshme, kurse gatishmëria i referohet masave specifike të marra para se të ndodhë një fatkeqësi, zakonisht për të dhënë paralajmërim, për të ndërmarrë masa paraprake dhe për të lehtësuar një reagim

3 “Udhëzues për menaxhimin e emergjencave dhe termat, përkufizimet, konceptet, akronimet, organizatat, programet, udhëzimet, urdhrat ekzekutivë dhe legjislacionin e lidhur”, B. Wayne Blanchard, 2008. fq. 48

4 Po aty, fq. 38

5 Farazmand, Ali. (2001). “Hyrje në menaxhimin e krizave dhe emergjencave.” Në Ali Farazmand (red.), *Doracaku i Menaxhimit të Krizave dhe Emergjencave*. New York: Marcel Dekker, fq. 3-4.

6 Al-Dahash et al. “Të kuptuarit e terminologjive: fatkeqësia, kriza dhe emergjenca”, 2016, fq. 1

7 Alexander, “Fatkeqësitë dhe planifikimi i emergjencave për gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen”, 2015, fq. 2

8 Po aty.

9 Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), “Një kornizë strategjike për gatishmërinë për emergjenca”, 2016,

të shpejtë.¹⁰ Për t'i zbutur risqet, ato duhet që së pari të identifikohen. Qasja e menaxhimit të riskut nënkupton një qasje sistematike për identifikimin, vlerësimin dhe zvogëlimin e risqeve të të gjitha llojeve që lidhen me rreziqet dhe aktivitetet njerëzore.¹¹ Reagimi ndaj emergjencave mund të përfshijë një kombinim të planeve, procedurave, si dhe improvizim në trajtimin e të gjitha aspekteve të emergjencave.¹² Rimëkëmbja nga fatkeqësia/emergjenca u referohet vendimeve dhe veprimeve të ndërmarra pas një fatkeqësie me qëllim rimëkëmbjen ose përmirësimin e kushteve të jetesës para fatkeqësisë nga komuniteti i goditur, duke inkurajuar dhe lehtësuar rregullimet e nevojshme për të zvogëluar riskun.¹³ Rezilienca ndaj fatkeqësive është "aftësia e individëve, komuniteteve, organizatave dhe shteteve për t'u përshtatur dhe rimëkëmbur nga rreziqet, goditjet ose situatat stresuese të përmasave të mëdha, pa kompromentuar perspektivat afatgjata zhvillimore."¹⁴ Korniza Hyogo për Veprim e përkufizon atë si shkallën në të cilën individët, komunitetet dhe organizatat publike dhe private janë në gjendje të organizojnë veten e tyre për të mësuar nga fatkeqësitë e kaluara dhe për të zvogëluar risqet e tyre të lidhura me fatkeqësitë e ardhshme, në nivelet ndërkombëtare, rajonale, kombëtare dhe lokale.¹⁵

Një grup tjetër konceptesh që shpesh përdoren në mënyrë të ndërsjelltë janë risqet dhe kërcënimet. Risqet nënkuptojnë potencialin për pasoja të dëmshme, ose humbje të pritshme (vdekje, lëndime, prona, mjete jetese, aktivitet ekonomik i prishur ose mjedis i dëmtuar) që rezultojnë nga ndërveprimet mes rreziqeve natyrore apo të shkaktuara nga njerëzit dhe cenueshmëritë.¹⁶ Ato ngërthejnë rreziqet ndaj të cilave është i ekspozuar një komunitet dhe cenueshmëritë e këtij komuniteti.¹⁷ Nga ana tjetër, kërcënimet i referohen dëmit të mundshëm të shkaktuar kur një cenueshmëri e caktuar shfrytëzohet me dashje ose pa dashje. Sigurisht, risqet dhe kërcënimet nuk do të zvogëlohen kurrë plotësisht, megjithatë, kur bëhet fjalë për shmangien e fatkeqësive dhe krizave të mëdha, është me rëndësi roli i planifikimit dhe përgatitjes për situata emergjente.

10 Twig, "Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive", Rrjeti i Praktikës Humanitare, 2004.

11 Po aty.

12 Alexander, "Fatkeqësitë dhe planifikimi i emergjencave për gatishmërinë, reagimin dhe rimëkëmbjen", 2015, fq. 2

13 OBT, "Përkufizime: Emergjencat" qasur përmes <https://www.who.int/hac/about/definitions/en/>

14 GSDRC, "Çfarë është rezilienca ndaj fatkeqësive", qasur përmes <https://gsdrc.org/topic-guides/disaster-resilience/concepts/what-is-disaster-resilience/>

15 Kombet e Bashkuara, Korniza Hyogo për Veprim 2005-2015: Ndërtimi i reziliencës së kombeve dhe komuniteteve ndaj fatkeqësive

16 Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), "Një kornizë strategjike për gatishmërinë ndaj emergjencave", 2016

17 Po aty.

RISQET E SITUATAVE EMERGJENTE NË KOSOVË

Kosova përballet me një numër risqesh që mund të shkaktojnë emergjenca në shkallë të gjerë e që mund të kërcënojnë sigurinë e qytetarëve të saj, duke vënë në provë kapacitetet institucionale për parandalimin e krizave për t'u përgatitur, reaguari, apo rimëkëmbur nga ato. Këto kërcënime mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale në komunitetet më të margjinalizuara, si dhe përkeqësohen nga cenueshmëritë ekzistuese, siç janë ekonomia e brishtë, kapacitetet e kufizuara të shëndetësisë publike dhe ndërtimet e paligjshme në zonat e rrezikshme. Një studim i QKSS-së, i botuar në vitin 2008 me titull Gjendja e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile në Republikën e Kosovës, vuri në pah nevojën për vlerësime gjithëpërfshirëse të kërcënimeve dhe risqeve në Kosovë, duke theksuar rëndësinë e tyre për planifikimin strategjik dhe përpjekjet parandaluese.¹⁸ Edhe pse janë të disponueshme disa dokumente që i konsiderojnë rreziqet e mundshme të shkaktuara nga faktori njeri dhe fatkeqësitë natyrore në Kosovë, vërehet mungesa e vlerësimeve konsistente dhe gjithëpërfshirëse në këtë aspekt. Sfidues mbetet fakti se raportet ekzistuese që vlerësojnë risqet e emergjencave nuk janë gjithëpërfshirëse dhe kryesisht përqendrohen në fatkeqësitë natyrore, duke i përjashtuar fatkeqësitë teknologjike ose ato të shkaktuara nga njeriu. Për shembull, sipas një raporti të UNDP-së, ekonomia, popullsia dhe mjedisi i Kosovës janë "mesatarisht të ekspozuar dhe shumë të ndjeshëm ndaj rreziqeve natyrore".¹⁹ Kosova është e ekspozuar ndaj vërshimeve të shpeshta, reshjeve të mëdha të borës, thatësirës, zjarreve dhe rreziqeve të tjera meteorologjike.²⁰ Edhe pse pjesa më e madhe e Kosovës është e ekspozuar ndaj vërshimeve, në disa pellgje lumore shumë të ekspozuara (p.sh. Drini në pjesën perëndimore të vendit) vërshimet ndodhin çdo 2-3 vjet²¹ dhe shkaktohen nga reshjet e mëdha të shirave, ndërtimet e pakontrolluara në zonat përreth lumenjve, hedhja e mbetjeve të ngurta në lumenj dhe mungesa e mirëmbajtjes së shtretërve të lumenjve dhe argjinaturave.²² Ndikimi i tyre vlerësohet i rëndë për banorët, pasuritë, infrastrukturën jetike, objektet me rëndësi të veçantë, mjedisin, trashëgiminë kulturore dhe ekonominë.²³

Kosova shpesh përjeton edhe thatësira, me mungesën e ujit që prek veçanërisht zonat e ulëta në pjesët qendrore dhe lindore të vendit për shkak të sezonalitetit të rrjedhave natyrore të lumenjve dhe rimbushjes së ujërave nëntokësore, si dhe menaxhimit të dobët të resurseve.²⁴ Sistemi i Menaxhimit të Inventarit të Fatkeqësive (DesInventar) vëren se llojet më të shpeshta të fatkeqësive në Kosovë në 30 vitet e fundit përfshijnë zjarre në pyje, vërshime dhe rrëshqitje të dheut.²⁵ Këto rreziqe natyrore shpesh çojnë në zhvendosje të popullatave lokale, dëmtime të pronave dhe humbje të tokave dhe prodhimitarisë bujqësore. Për shembull, dëmi i shkaktuar nga vërshimet në vitet 2013, 2014 dhe 2016 vlerësohet në mbi 4 milionë euro.²⁶ Vërshimet çdo vit në Kosovë prekin rreth 10,000 persona.²⁷ Edhe zjarret në pyje paraqesin risk të rëndë. Në vitin 2007, zjarret në pyje dogjën 10.597 hektarë me përafërsisht rreth 4.65 milionë euro humbje.²⁸ Burimet kryesore sizmike

18 Qehaja, "Gjendja e emergjencës dhe mbrojtjes civile në Republikën e Kosovës", QKSS, 2008

19 UNDP, "Iniciativa për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë në Kosovë (IZRrFK)", 2013, fq. 1

20 Po aty. fq. 4.

21 Po aty.

22 Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, "Vlerësimi i të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera", 2016, fq. 35

23 Po aty.

24 Po aty.

25 Rrjeti i Veprimit për Ndërtimin e Reziliencës Urbane të Evropës Juglindore, "Kosova", qasur përmes <http://seeurban.net/country-kosovo/>

26 Po aty.

27 Instrumenti Global për Zvogëlimin e Fatkeqësive dhe Rimëkëmbjen (GFDRR), "Profili i riskut të fatkeqësive: Kosova", qasur përmes <https://ëëë.gfdrr.org/en/publication/disaster-risk-profile-kosovo>

28 Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, "Vlerësimi i të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera", 2016, fq. 42

në Kosovë përfshijnë zonat Prizren-Pejë, Ferizaj-Viti-Gjilan (ku ndodhi një tërmet me magnitudë 6.2 në vitin 1921) dhe Kopaonikun.²⁹ Përveç kushteve të lidhura me klimën, i njëjti vlerësim identifikon ndërtimin e ndërtesave me kritere dhe cilësi të dobët si faktorë që rrisin risqet e shembjes së ndërtesave të larta banesore dhe publike, dëmtimeve në infrastrukturë dhe transport, përkeqësimit të mjedisit dhe efekteve dytësore si rrjedhja e ujërave të zeza dhe produkteve toksike³⁰.

Në vitin 2016, Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME) kreu “Vlerësimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera” pas një vlerësimi të mëparshëm të vitit 2009. Përgjithësisht, vlerësimi i AME-së pohon se Kosova nuk ka qenë e ekspozuar kurrë ndaj rreziqeve në shkallë të gjerë, por nuk e përjashton mundësinë e tyre. Vlerësimi i njëjtë thekson se kapacitetet ekzistuese njerëzore dhe burimet teknike për mbrojtje dhe shpëtim nuk kanë arritur nivelet e dëshiruara, dhe se ekziston nevoja për trajnime të mëtejshme dhe testime për nivelin e gatishmërisë përmes ushtrimeve dhe bashkëpunimit rajonal³¹. Natyra e risqeve dhe kërcënimeve që potencialisht çojnë në situata emergjente është e larmishme. Vlerësimi i AME-së vë në pah edhe rreziqet në infrastrukturën kritike, ndërtesat kolektive, gjatë transportit, aksidente industriale dhe mbetje të rrezikshme, si dhe rreziqe epidemiologjike, përfshirë pandeminë.³² Në lidhje me risqet e epidemive, vlen të përmendet se Kosova ka përjetuar shpërthime në të shkuarën, përfshirë shpërthimin e lisë gjatë vitit 1972, e cila preku të paktën 175 persona, dhe shkaktoi 35 vdekje.³³ Në vitin 2009, vendi u përball me qindra raste të virusit H1N1, i cili la më shumë se 10 të vdekur.³⁴

Kosova ka një numër faktorësh që rrisin cenueshmërinë e rrezikut nga emergjencat, sic janë zonat e izoluara rurale, ndërtimet e paligjshme në zona të rrezikshme dhe mosrespektimi i kodeve ndërtimore,³⁵ dizajni joadekuat i sistemeve të kanalizimit në zonat urbane, niveli i lartë i papunësisë, ekonomia e brishtë, kapacitetet e kufizuara të shëndetësisë publike, si dhe paqëndrueshmëria në menaxhimin e ujërave dhe praktika agronomike, shpyllëzimi dhe shkatërrimi i tokave nga aktivitetet e mihjes.³⁶ Për më tepër, cenueshmëria e Kosovës ndaj fatkeqësive të lidhura me klimën është rritur në 15 vitet e fundit si rezultat i një rritjeje dramatike të rreziqeve natyrore të lidhura me ndryshimet klimatike.³⁷ Megjantëse ndryshimet klimatike kanë gjasa t’i përkeqësojnë risqet dhe kërcënimet ekzistuese për emergjenca, është e rëndësishme të theksohet se grupe të ndryshme në shoqëri, siç janë gratë, ndikohen në mënyrë disproporcionale.³⁸ Andaj, qasja e Kosovës ndaj menaxhimit të riskut të fatkeqësive duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të konsiderojë një perspektivë gjinore.³⁹

29 “Vlerësimi i të Rrezikut nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera”, 2016, fq. 42

30 Po aty, fq. 44.

31 Po aty, fq. 114.

32 Po aty.

33 OBSH, “Aspektet epidemiologjike të lisë në Jugosllavi”, 1972

34, Radio Evropa e Lirë, “Kosovë: Deri më tash, 11 viktima nga gripi i derrit”, 2009

35 Po aty.

36 Fetah Halili dhe Agim Gashi, 2009, Raporti Kombëtar i Kontekstit të Kërkimeve Shkencore në fushën e Mjedisit në Kosovë; Banka Botërore, 2005, Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë: Promovimi i Mundësisë, Sigurisë dhe Pjesëmarrjes për të Gjithë, Raporti Nr. 32378-XX.

37 (GFDRR), “Profili i riskut të fatkeqësive: Kosova”

38 GIËPS, Universiteti Georgetoën, qasur përmes <https://giwps.georgetoën.edu/resource/ëomen-building-resilient-cities-in-the-context-of-climate-change/>

39 Po aty.

MUNGESA E NJË ANALIZE KONSISTENTE PËR GATISHMËRINË DHE REAGIMIN NDAJ NDAJ EMERGJENCAVE

Për informimin e politikëbërjes dhe për rritjen e vetëdijesimit të publikut në lidhje me situatat emergjente, janë të domosdoshme vlerësimet e rregullta të rrezikut që mbështeten në dëshmi, përfshirë përmes përdorimit të sistemeve të paralajmërimit të hershëm (SPH). Vlerësimet ekzistuese të rreziqeve janë të vjetëruara apo jo mjaftueshëm gjithëpërfshirëse për të mbuluar spektrin e rreziqeve dhe kërcënimeve me të cilat përballet Kosova - për shkak të planifikimit të dobët të politikave, mungesës së resurseve dhe kapaciteteve, dhe mungesës së një strukture funksionale institucionale për koordinimin dhe kryerjen në mënyrë periodike të vlerësimeve të rrezikut.⁴⁰ Vlerësimi i rreziqeve duhet të realizohet për të gjithë sektorët, siç janë kërcënimet ndaj infrastrukturës kritike kombëtare, fatkeqësitë e lidhura me klimën ose fatkeqësi të tjera natyrore, sulmet terroriste etj. Pas identifikimit të rreziqeve, është e rëndësishme të vendoset një sistem funksional që do t'ia komunikonte rrezikun publikut në mënyrë të koordinuar mes nivelit qendror dhe lokal dhe do të lehtësonte gatishmëri dhe reagim më të mirë. Për shembull, OBSH-ja paraqet një model për një aranzhim që garanton gatishmëri institucionale në baza kombëtare ndaj emergjencave, përmes vlerësimeve të rreziqeve, ndërtimit të një standardi ndërkombëtar për vlerësim adekuat dhe të përditësuar të rrezikut, dhe koordinimin e mekanizmave ndër-institucionale për reagimin ndaj emergjencave.

Përkundër faktit që Kosova nuk është anëtare e kësaj organizate, praktikat për të cilat shtetet anëtare janë zotuar të zbatojnë në vendet e tyre përkatëse mund të shërbejnë si një model i mirë për rritjen e gatishmërisë dhe reagimit të Kosovës ndaj emergjencave në përgjithësi, dhe emergjencave shëndetësore në veçanti. Përmes Planit Evropian të Veprimit të OBSH-së, vendet Evropiane janë zotuar të krijojnë, mirëmbajnë dhe forcojnë sisteme kombëtare që sigurojnë vlerësimin e rreziqeve në kohën e duhur dhe ndarjen e informacionit ndërmjet palëve përkatëse të interesit. Në këtë drejtim, plani përkatës i veprimit parashikon krijimin e mekanizmave kombëtarë që do të merren me koordinimin ndër-sektorial dhe vlerësim të përbashkët të rrezikut për sektorë të ndryshëm për të siguruar gatishmëri dhe reagim të integruar. Teksa Kosova e ka hedhur një hap drejt gatishmërisë dhe reagimit të integruar përmes SIME-së, ky dokument nuk e parashikon krijimin e një mekanizmi specifik për koordinimin ndër-sektorial dhe nuk i përcakton rolet e sektorëve të ndryshëm për kryerjen e vlerësimeve të rregullta të rrezikut në baza sektoriale ose multi-sektoriale. Sistemi i Kosovës është fokusuar kryesisht në reagimin ndaj emergjencave, ndërsa modeli i OBSH-së fokusohet në parandalim, por edhe tenton ta përmirësojë reagimin duke parashikuar vlerësime të rregullta të rrezikut dhe përmirësimin e rregullt të infrastrukturës për reagim emergjent.

40 Rrjeti i Veprimit për Ndërtimin e Reziliencës Urbane të Evropës Juglindore, “Kosova”

TË VEPRUARIT NË VAKUM: MOSANËTARËSIMI I KOSOVËS NË ORGANET NDËRKOMBËTARE

Mosanëtarësimi i Kosovës në organet ndërkombëtare është pengesë ndaj përpjekjeve për një qasje më efektive ndaj situatave emergjente, çka krijon një hendek të njohurive, e bën më të vështirë qasjen në fonde, si dhe nuk lejon bashkëpunimin ndërkombëtar për parandalimin dhe reagimin ndaj fatkeqësive. Që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008, Kosova është anëtarësuar në organe të rëndësishme ndërkombëtare⁴¹, megjithatë mbetet e jashtë organizatave ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara, Organizata Botërore e Shëndetësisë, Organizata Botërore e Tregtisë, Këshilli i Evropës, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, INTERPOL, UNESCO etj. Edhe pse Kosova synon të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, ajo është ende në një fazë të hershme të këtij procesi. Kjo nënkupton se Kosova nuk mund të përfitojë në mënyrë të barabartë nga ekspertiza ndërkombëtare, fondet dhe përvoja në adresimin e sfidave të përbashkëta, por as nuk mund të japë kontributin e saj në këmbim. Kjo e vë Kosovën në disavantazh të drejtpërdrejtë kur flitet për përgatitje dhe për kundërpërgjigje efektive ndaj situatave komplekse siç janë emergjencat (ndër)kombëtare. Meqenëse krizat nuk janë gjithmonë të kufizuara brenda kufijve kombëtarë, kjo do të thotë që efektet e këtij përjashtimi mund të shtrihen jo vetëm në shoqërinë e Kosovës por edhe në vendet fqinje dhe më gjerë.

Për më tepër, Kosova nuk është vend nënshkrues i Kornizës Hyogo për Veprim (KHV) ose Kornizës Sendai për Veprim (KSZRrF), dhe si rezultat nuk është përfshirë në platformat rajonale të ZRRF-së dhe përballet me vështirësi për qasjen në fondet/ekspertizën nga iniciativat globale të tilla si Instrumenti Global Mjedisor (GEF) dhe Fondi i Gjellbër për Klimën (GCF).⁴² Marrë parasysh që Kosova nuk është nënshkruese e Konventës Kornizë të OKB-së për Ndryshimet Klimatike, ajo nuk ka paraqitur një Kontribut të Synuar dhe të Përcaktuar Kombëtar për Marrëveshjen e Parisit 2015, marrëveshja e parë universale për klimën.⁴³ Sidoqoftë, Kosova mbetet e ndikuar nga ndryshimet klimatike, veçanërisht përmes sistemit energjetik shumë të varur nga thëngjilli. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës është sidoqoftë anëtar i Sistemit Evropian të Vetëdijesimit për Vërshimet (EFAS) i cili bën të mundur komunikimin dhe ndarjen e të dhënave të rrezikut nga vërshimet.⁴⁴

41 Si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, Organizata Botërore e Doganave etj.

42 Po aty.

43 Zbatimi Rajonal i Projektit të Marrëveshjes së Parisit, “Kosova”, 2020.

44 Po aty.

DISPOZITAT KUSHTETUESE GJATË NË GJENDJE EMERGJENCASH

Edhe pse Kushtetuta e Republikës së Kosovës përmban disa dispozita në lidhje me emergjencat, kjo nuk është e mjaftueshme për ta parandaluar dykuptimësinë ligjore në praktikë, veçanërisht në aspektin e përcaktimit të rrethanave që justifikojnë ose kërkojnë deklarimin e një emergjence mbarëkombëtare apo të roleve institucionale për kundërpërgjigjen ndaj saj. Sipas Kushtetutës, Presidenti vendos për shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin⁴⁵ kur: (1) ka nevojë për masa emergjente të mbrojtjes; (2) ka rrezik të brendshëm ndaj rendit kushtetues ose sigurisë publike; (3) ka fatkeqësi natyrore, e cila prek tërë territorin e Republikës së Kosovës ose një pjesë të tij.⁴⁶ Sidoqoftë, kjo dispozitë është mjaft e gjerë dhe siç u demonstrua nga pandemia COVID-19, përveç nëse çdo lloj emergjence rregullohet nga ligje të veçanta, ekziston nevoja për legjislacion shtesë (p.sh. një Ligj për Gjendjen e Jashtëzakonshme) që do të ndihmojë për sqarimin e kompetencave shtesë që u jepen ose revokohen institucioneve specifike gjatë një gjendje të jashtëzakonshme, kushteve themelore për procedimin me shpalljen e emergjencave, implikimeve financiare, kriterëve për ndryshime në masat e marra gjatë emergjencave, pezullimin e lirive civile etj. Meqenëse një vend mund të përjetojë më shumë se një lloj emergjence, cilat dispozita specifike duhet të merren parasysh? Cilat do të ishin implikimet ligjore dhe operacionale për palët e përfshira të interesit? Nëse nuk specifikohen qartë në kornizën ligjore, kriza të tilla do të krijojnë konfuzion dhe një gjendje kaosi gjatë rrethanave negative që e rëndojnë më tej reagimin e një vendi.

Siç u demonstrua nga sfidat në përpjekjet për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme gjatë COVID-19, ekziston një hendek ligjor në Kosovë në lidhje me situatat e emergjencës - për t'i sqaruar kompetencat e palëve kyçe të interesit për të siguruar që vendimet e marra janë ligjore dhe legjitime. Më e rëndësishmja është se legjislacioni shtesë duhet të jetë në përputhje me frymën e kushtetutës. Për shembull, megjithëse disa ligje ekzistuese u referohen situatave emergjente, ato nuk përmendin ndonjë rol për Presidentin ose KSK-në, çka shtrun pyetjen - A duhet që këto situata emergjente të mbuluara nga legjislacioni i veçantë, të konsiderohen si rrethanë për gjendje të jashtëzakonshme? Me fjalë të tjera, nëse situatat emergjente që rregullohen me ligj të veçantë nuk kërkojnë veprime nga Kryesuesi i KSK-së, atëherë a do të thotë kjo se shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme është e nevojshme në rastet e një sulmi të jashtëm ose situata që nuk janë të mbuluara nga ligjet ekzistuese?

Në parim, marrë parasysh mandatin e Presidentit dhe Kryeministrit, kushtetuta parashikon koordinimin mes këtyre institucioneve në praktikë gjatë një gjendje të jashtëzakonshme. Në kohë krize, kompetencat e zakonshme të qeverisë mund të jenë të pamjaftueshme dhe mund të jetë e pamundur të bëhen ndryshime në kohën e duhur. Kështu, Presidenti, i cili bazuar në nenin 131 të Kushtetutës mund të mobilizojë FSK-në për të ndihmuar në Gjendjen e Jashtëzakonshme, si përforsim i përkohshëm. Gjatë një Gjendje të Jashtëzakonshme, Presidenti kryeson Këshillin e Sigurisë, i cili në rrethana të rregullta drejtohet nga Kryeministri. KSK-ja ushtron funksione ekzekutive në lidhje me gjendjen e jashtëzakonshme dhe përbëhet nga kryeministri; zëvendëskryeministri(at); ministri për Forcën e Sigurisë së Kosovës; ministri i punëve të jashtme; ministri i punëve të brendshme; ministri i drejtësisë; ministri i ekonomisë dhe financave; dhe ministri i kthimeve dhe komuniteteve.⁴⁷ Përbërja e KSK-së nënvizon se koordinimi mes Presidentit dhe Qeverisë është esencial në kohë krizash, por teksa kushtetuta jonë vihet në provë, një koordinim të tillë nuk është i dukshëm.

45 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 84

46 Po aty, neni 131

47 Po aty, neni 127

Neni 56 i Kushtetutës⁴⁸ flet për kufizime të të drejtave dhe lirive themelore gjatë një gjendje të jashtëzakonshme në rrethanat e nevojshme përkatëse, megjithatë, për t'i respektuar plotësisht këto të drejta, përveçse në kushtetutë, dispozitat duhet të detajohen edhe në ligjet përkatëse.

Edhe pse mund të ekzistojë një supozim se Presidenti do të veprojë në interesin më të mirë të vendit, kompetencat ligjore të Presidentit si rezultat i shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme mundet edhe të keqpërdoren për të rritur autoritetin ose politizuar reagimin e emergjencës. Duke qenë se Gjendja e Jashtëzakonshme mund të shpallet pasi presidenti të nxjerrë një dekret që duhet të miratohet nga Kuvendi, duke përcaktuar natyrën e kërcënimit dhe kufizimet e të drejtave dhe lirive - ekziston nevoja për mbikëqyrje të fuqishme për të siguruar që rrethanat t'i përmbushin këto kritere të nevojshme për përcaktimin e llojit të emergjencës dhe qëllimin e saj, si dhe efektet e saj në pezullimin e lirive civile, ndërkohë që vendoset një afat i qartë kohor për ta bërë këtë.

48 Neni 56 për të Drejtat dhe Liritë Themelore Gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme, Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

KORNIZA LIGJORE

Ligjet ekzistuese të Kosovës përmbajnë dispozitat thelbësore për trajtimin e emergjencave, por ende ka hendekë kur flitet për sqarimin e roleve dhe përgjegjësi të palëve kyçe të interesit në kohë krize, mbulimin e një spektri më të gjerë të situatave emergjente, forcimin e dispozitave për të drejtat e njeriut dhe liritë civile gjatë një gjendje të jashtëzakonshme, promovimin e një qasje më pjesëmarrëse ndaj planifikimit të politikave dhe reagimit ndaj fatkeqësive, dhe gatishmërinë dhe reziliencën pas krizave. Po ashtu, ligjet e humbasin forcën edhe nga zbatimi i dobët, siç dëshmohet nga mungesa e sistemeve të koordinimit dhe komunikimit funksional, planeve të përditësuara të reagimit emergjent dhe vlerësimeve të rrezikut, mungesës së informacionit publik dhe programeve të trajnimit për ndërtimin e kapaciteteve. Ndër ligjet kryesore që rregullojnë reagimin institucional në raste emergjente janë ligjet në vijim: Ligji Nr. 04/L-027 për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, Ligji për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, Ligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse dhe Ligji për Shëndetësi, Ligji Nr. 04/L-147 për ujërat e Kosovës,⁴⁹ Ligji Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës.

- **Ligji për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera**⁵⁰ rregullon mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. Sidoqoftë, në këtë ligj fatkeqësitë janë përcaktuar ngushtë, duke përfshirë situata emergjente si pandemitë, dhe në kontekstin e COVID-19 kjo paraqet një mangësi madhore. Sipas këtij ligji, organe të ndryshme në nivelin qendror dhe lokal, siç janë Kuvendi, Qeveria dhe komunat, ndajnë një spektër të gjerë përgjegjësi në lidhje me organizimin, përgatitjen, zbatimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera - duke kërkuar një nivel të koordinimit ndër-institucional. Sidoqoftë, nuk është e qartë se çfarë mekanizmash e lehtësojnë një koordinim të tillë. Bazuar në këtë ligj, kur institucionet lokale arrijnë limitin e kapaciteteve të tyre për kundërpërgjigje ndaj fatkeqësive, ato mund të kërkojnë ndihmën e institucioneve qendrore duke përfshirë dislokimin e FSK-së, por ky ligj nuk e specifikon procesin e vendimmarrjes dhe as nuk u referohet Presidentit ose KSK-së si autoritete relevante gjatë fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera që mund të shkaktojnë një gjendje të jashtëzakonshme brenda vendit. Për më tepër, shumica e referencave në këtë ligj lidhen më shumë me mbrojtjen, ose masat e menjëhershme të marra për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera, sesa me masat parandaluese, ZRRF-në, ose rimëkëmbjen pas fatkeqësive që mund të përdoren për të ndihmuar në zbutjen e ndikimit të fatkeqësive. Edhe pse është paraparë që vlerësimet e rrezikut të kryhen në nivelin qendror dhe lokal, ky ligj nuk specifikon sa gjithëpërfshirëse duhet të jenë ato, sa shpesh duhet të kryhen, dhe si shfrytëzohen në procesin e vendimmarrjes. Kur flitet për planet e reagimit ndaj emergjencave që duhet të jenë procese nga institucionet qendrore dhe lokale, i njëjti ligj thotë se ato duhet të aprovohen nga publiku, por nuk bën thirrje për një qasje pjesëmarrëse që e përfshin publikun për të informuar hartimin e këtyre planeve.
- **Ligji për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent**⁵¹ e ka paraqet AME si organ të pavarur në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e organizuar në nivelin qendror dhe lokal, me nivelin e saj lokal që mbulon qendrat 112. Shumica e dispozitave sipas këtij ligji lidhen me detyrat menaxheriale dhe teknike të AME-së për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe

49 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8659>

50 Republika e Kosovës (2011) Ligji Nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, Në dispozicion në <https://ame.rks-gov.net/Portals/0/Files/Laë%20for%20protection%20against%20natural%20and%20other%20disasters.pdf>

51 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2014), Ligji NR. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, qasur përmes, <http://old.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/04-L-230%20a.pdf>

- fatkeqësitë e tjera, sesa me kushtet për funksionimin e strukturave organizative të SIME-së.
- **Ligji për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse**⁵² liston sëmundjet ngjitëse dhe përcakton konceptet kyçe në lidhje me parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse. Sidoqoftë, duke qenë se COVID-19 është virus i ri, nuk është pjesë e kësaj liste - pra ligji nuk ka referenca të drejtpërdrejta për adresimin e pandemisë COVID-19. Në raste të tilla të trajtimit të sëmundjeve të reja ngjitëse, ligji ka paraparë që MSH-ja mund të ndërmarë masa parandaluese bazuar në udhëzimet e IKSHPK-së, duke përfshirë masa të tilla si vendosja e njerëzve në karantinë. Si kundërpërgjigje ndaj COVID-19, duke iu referuar kryesisht dispozitave në këtë ligj (siç është 41.2), MSH-ja ndërmori masa parandaluese që kufizuan lirinë e lëvizjes dhe lirinë e tubimit. Sidoqoftë, Gjykata Kushtetuese i shpalli këto masa parandaluese si antikushtetuese⁵³ pasi që ky ligj nuk i specifikon qartë kufizimet mbi të drejtat dhe liritë gjatë emergjencave shëndetësore, përfshirë pandemitë.
 - **Ligji për Shëndetësinë** përmban një kapitull (XIX) i cili rregullon kujdesin shëndetësor gjatë emergjencave. Edhe pse nocioni i emergjencës në këtë ligj është i kufizuar në statusin shëndetësor, mund të argumentohet se shumica e situatave të emergjencës kërkojnë përfshirjen e ofruesve të kujdesit shëndetësor. Sipas këtij ligji, MSH-ja është përgjegjëse për sigurimin e aktiviteteve të kujdesit shëndetësor në raste emergjencash, megjithatë termi gjendje e jashtëzakonshme (e deklaruar në të gjithë vendin nga Presidenti) përdoret në mënyrë të këmbyeshme me situatat emergjente pa pranuar implikimet e mundshme përkatëse për struktura e vendimmarrjes në rastet e ndryshme.⁵⁴ I njëjti ligj gjithashtu e ngarkon Qeverinë me aktivitetet përgatitore gjatë emergjencave, të cilat në rastin e pandemisë COVID-19 përfshijnë sigurimin e stoqeve të barnave dhe materialeve shpenzuese medicinale dhe përtëritjen e rezervave të kujdesit shëndetësor shtetëror në nivelin e nevojshëm. Për më tepër, ky ligj i përmend epidemitë në lidhje me masat e kujdesit shëndetësor për zbulimin e hershëm të rasteve, por nuk i referohet pandemisë, çka mund të jetë relevante për dispozitat që rregullojnë bashkëpunimin ndërkombëtar (neni 92).
 - **Ligji Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 në Territorin e Republikës së Kosovës** - u miratua në vitin 2020 me qëllim të krijimit të bazës ligjore për institucionet shtetërore të Kosovës për të luftuar dhe parandaluar pandeminë COVID-19. Ligji plotësoi një hendek të rëndësishëm në kornizën ligjore të Kosovës për menaxhimin e krizave si pandemitë, pasi përcakton përgjegjësitë dhe rolet në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin dhe sigurimin e fondeve gjatë pandemisë. Miratimi i këtij ligji u ofron autoriteteve bazën ligjore për të marrë masa parandaluese në nivelin kombëtar, duke përfshirë vendosjen e kufizimeve mbi liritë dhe të drejtat e njeriut, si dhe gjobat në rast të mosrespektimit të vendimeve të qeverisë, në përputhje me kushtetutën. Ky ligj shërben edhe si shembull i legjislacionit shtesë kur ligjet ekzistuese nuk arrijnë të sigurojnë qartësi ose nuk parashikojnë shfaqjen e kërcënimeve që shkaktojnë situata emergjente.
 - **Ligji Nr. 06/L-014 për Infrastrukturën Kritike** siguron bazën ligjore për identifikimin e infrastrukturës kritike kombëtare përmes një qasjeje që i mbulon të gjitha rreziqet,

52 Kuvendi i Republikës së Kosovës (2008), Ligji Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës*, Gjendet në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2587>

53 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese mund të qaset përmes <https://gjk-ks.org/vendimet-nga-seancat-shqyrtuese-te-mbajtura-me-30-dhe-31-mars-2020/>

54 Lista e detajuar e aktiviteteve është në dispozicion në <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8666>, p.30

përfshirë kriteret ndërsektoriale dhe sektoriale që duhet të mbështeten nga AME. Meqenëse ky ligj parashikon koordinorët e sigurisë dhe zyrtarët e ndërlidhjes për secilin sektor të identifikuar të infrastrukturës kritike kombëtare dhe krijimin e një Instrumenti Kombëtar të Infrastrukturës Kritike, ekziston një sfidë në sigurimin e koordinimit efektiv me mekanizmat dhe koordinatorin ekzistues institucional. Megjithëse ky ligj plotësoi një hendek në legjislacion dhe transpozoi dispozitat kyçe nga direktivat e BE-së, zbatimi i tij është vonuar⁵⁵.

Marrë parasysh aspiratën e Kosovës për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, edhe legjislacioni i saj në lidhje me gatishmërinë ndaj emergjencave dhe menaxhimin e krizave duhet të jetë në përputhje me acquis të BE-së, duke qenë se negociatat e para-anëtarësimit zhvillohen për 35 kapituj, përfshirë tema të tilla si mjedisi (Kapitulli 27) që ndër të tjera mbulon legjislacionin në lidhje me cilësinë e ujit dhe ajrit, mbrojtjen e natyrës, kontrollin e ndotjes industriale dhe menaxhimin e rreziqeve.⁵⁶ Përgjithësisht, për të siguruar pajtueshmëri me acquis të BE-së, Kosovës i duhet jo vetëm të miratojë ligje që korrespondojnë me politikat e BE-së, por edhe të alokojë fonde për institucionet kyçe të mandatuara për reagimin ndaj emergjencave, si dhe ta trajnojë dhe pajisë administratën e saj.

55 Komuniteti i energjisë, “Siguria Kibernetike”, qasur përmes <https://www.energy-community.org/implementation/Kosovo/CYBER.html>

56 Politikat Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat për Zgjerimin, “Kapitujt e Acquis” qasur përmes https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/conditions-membership/chapters-of-the-acquis_en

KORNIZA STRATEGJIKE

Shfaqja e pandemisë COVID-19 e gjeti Kosovën në një situatë të pafavorshme, duke përfshirë faktin se pothuajse të gjitha dokumentet e strategjike në lidhje me gatishmërinë për emergjencë dhe menaxhimin e krizave kanë skaduar apo janë vjetëruar. Edhe pse që nga viti 2010 janë bërë ndryshime në legjislacion, Strategjia e Sigurisë Kombëtare, SIME dhe PRK-ja nuk janë përditësuar, dhe gjatë këtyre dhjetë viteve nuk është hartuar ndonjë dokument i ri strategjik - ligjërësht i detyrueshëm - për adresimin e situatave të lidhura me emergjencat. Në harkun e dy viteve, nga marsi 2012 deri në vitin 2014, Qeveria e Kosovës filloi një rishikim gjithëpërfshirës të sektorit të saj të sigurisë. RSSH-ja vlerësoi kërcënimet dhe rrezikun ndaj sigurisë për Kosovën, identifikoi reformat legjislativë që do të ndërmerren dhe kapacitetet njerëzore dhe teknike për të përmbushur sfidat e sigurisë.⁵⁷ RSSH-ja identifikoi nevojën për shqyrtimin dhe rishikimin e të gjitha dokumenteve strategjike, përfshirë Strategjinë e Sigurisë Kombëtare, Strategjinë e Mbrojtjes Kombëtare dhe Planin e Reagimit Kombëtar, i cili konsiderohet i vjetëruar.⁵⁸ Procesi tregoi edhe se institucionet e sigurisë në Kosovë përballeshin me mbivendosje në rolet dhe misionet e tyre, nuk ishin të koordinuara mirë, dhe nuk ishin të pajisura për t'u përballur me kërcënimet dhe rreziqet e mundshme ndaj mirëqenies së popullit të Kosovës dhe sigurisë kombëtare në vazhden e ndryshimeve të mëtejshme.⁵⁹

RSSH-ja rekomandoi edhe tranzicionin e FSK-së në Forcat e Armatosura të Kosovës me misionin e mbrojtjes së integritetit territorial të Kosovës, sigurimin e mbështetjes ushtarake për autoritetet civile në situata fatkeqësish dhe pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare; dhe tranzicionin e Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ministri të Mbrojtjes me përgjegjësinë e sigurimit të mbikëqyrjes civile dhe udhëzimeve për Forcat e reja të Armatosura të Kosovës.⁶⁰ RSSH-ja rekomandoi edhe që MPB-ja të punojë nga afër me Ministrinë e Mbrojtjes (MM) për një tranzicion gradual të përgjegjësive në MPB në fushën e menaxhimit të emergjencave.⁶¹ Relevanca e RSSH-së qëndron edhe në faktin se tregoi mangësitë në kornizën aktuale strategjike të Kosovës, të cilat vënë në rrezik sigurinë dhe sigurimin e qytetarëve të vendit. RSSH-ja e konsideroi kërcënimin e epidemive dhe bëri thirrje për ndryshime në kornizën e sigurisë kombëtare që të korrespondojnë me ndryshimin e natyrës së kërcënimeve. Edhe pse disa nga rekomandimet e RSSH-së janë marrë në konsideratë, si miratimi i një pakete ligjesh që lehtëson tranzicionin e FSK-së në FAK, shumica e rekomandimeve nuk janë zbatuar, pjesërisht si rezultat i dobësive të planifikimit të politikave dhe prioritizimit nga qeveritë e mëparshme, ose për shkak të ndryshimeve në qeveri brenda periudhave të shkurtra kohore.

DOKUMENTE STRATEGJIKE

Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave (2010)

Në vitin 2010, Qeveria e Kosovës miratoi Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Emergjencave (SIME) dhe MBP u autorizua të koordinojë zbatimin e tij.⁶² Ky dokument siguron një qasje sistematike dhe proaktive për drejtimin e departamenteve dhe agjencive në të gjitha nivelet e

57 Analiza e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë së Republikës së Kosovës”, 2014, fq. 4.

58 Garentina Kraja, Parimet dhe Praktika e Politikave Publike në Kosovë, fq. 149

59 Kabashi-Ramaj, “Kosova nuk ishte e përgatitur në mënyrë adekuate për pandeminë”, 2020

60 Po aty, fq. 6

61 Po aty.

62 Vendim i Qeverisë së Kosovës, Nr. 12/126, 26.05.2010. Gjetendet në: https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/docs/Vendimet_e_Mbledhjes_se_126-te_te_Qeverise_2010.pdf.

qeverisë, organizatave joqeveritare dhe sektorit privat, në mënyrë që të bashkërendojnë punën për parandalimin, mbrojtjen, reagimin, rimëkëmbjen dhe zbutjen e efekteve të incidenteve, pavarësisht nga shkaku, madhësia, vendndodhja ose kompleksiteti, në mënyrë që të zvogëlohen humbjet e jetëve dhe pasurisë dhe dëmtimi i mjedisit. Në lidhje me Planin e Reagimit Kombëtar (PRK), SIME siguron kornizën për menaxhimin e incidenteve, ndërsa PRK-ja siguron strukturën dhe mekanizmat për politikën në nivel kombëtar për menaxhimin e incidenteve.⁶³

SIME është i bazuar në parakushtet që përdorimi i kornizës së përbashkët për menaxhimin e incidenteve do t'i jap personelit të menaxhimit/reagimit emergjent sistem fleksibël, por të standardizuar për aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident. SIME është fleksibil për faktin se komponentët e tij mund të përdoren për të zhvilluar plane, procese, procedura, marrëveshje dhe role për të gjitha llojet e incidenteve. Në këtë drejtim, SIME është i aplikueshëm në çdo incident pa marrë parasysh shkakun, madhësinë, vendndodhjen apo kompleksitetin e tij, si dhe siguron një seri të strukturave standarde organizative, gjë që është kritike në lejimin e organizatave dhe agjencive të ndryshme të punojnë së bashku në formën e koordinimit të paraparë.⁶⁴ Duke iu referuar komponentëve të tij, ky dokument shprehet se integron praktikat më të mira ekzistuese në një qasje të qëndrueshme, gjithëkombëtare, sistematike në menaxhimin e incidenteve, e cila është e aplikueshme në të gjitha nivelet e qeverisjes, organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe sektorin privat, si dhe në të gjitha disiplinat funksionale në kontekstin e të gjitha rreziqeve. Bazuar në SIME, komponentët nuk janë menduar të qëndrojnë më vete, por për të punuar së bashku në mënyrë fleksibile dhe sistematike për të siguruar një kornizë kombëtare për menaxhimin e incidenteve.⁶⁵ Shtjellimi më i hollësishëm i secilës komponentë të SIME-s përshkruhet më poshtë⁶⁶:

- **Gatishmëria:** Aktivitetet efektive të menaxhimit emergjent dhe reagimit në incident, fillojnë me një mori aktiviteteve përgatitore, të kryera në vijimësi shumë herët para çdo incidenti të mundshëm. Gatishmëria përfshin një kombinim të integruar të vlerësimit, planifikimit, procedurave dhe protokolleve, trajnimeve dhe ushtrimeve, kualifikimit, licencimit dhe certifikimit të personelit, certifikimit, vlerësimit dhe inspektimit të pajisjeve.
- **Komunikimi dhe menaxhimi i informimit:** Aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve, varen në sistemet e komunikimit dhe informimit të cilat sigurojnë pasqyrën e përbashkët operative në të gjitha mjediset e komandimit dhe koordinimit. SIME përcakton kërkesat e domosdoshme për një kornizë standarde të komunikimit dhe potencon nevojën për një pasqyrë të përbashkët operative. Ky komponent është i bazuar në konceptet e ndërveprimit, sigurisë, shkallëzimit dhe mobilitetit si dhe në aftësitë ripërtëritëse dhe zëvendësuese të sistemeve të komunikimit dhe informimit.
- **Menaxhimi i resurseve:** Për mbështetjen e objektivave kritike të çdo incidenti janë të nevojshme resurset (personeli, pajisjet apo furnizimet). Rrjedha e resurseve duhet të jetë e lehtë dhe e përshtatshme për kërkesat e incidentit. SIME përcakton mekanizmat standarde dhe vendos procesin e menaxhimit të resurseve për tu përdorur për përcaktimin e nevojave për resurse, porositjen dhe sigurimin e resurseve, mobilizimin e resurseve, përcjelljen dhe raportimin e resurseve, dhe rimëkëmbjen/riparimin, demobilizimin, kompensimin dhe inventarizimin e resurseve.
- **Komanda dhe menaxhimi:** Ky komponent është i dizajnuar për të mundësuar menaxhim

63 Qeveria e Kosovës. (2010). *Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave*. Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës, fq. 4. Në dispozicion në: <https://ame.rks-gov.net/Portals/0/Files/SIME%20i%20Miratuar.pdf>.

64 Po aty, fq. 5.

65 Po aty, fq. 6.

66 Po aty, fq. 6-8.

dhe koordinim efikas dhe të efektshëm të incidenteve, duke ofruar strukturë të standardizuar dhe fleksibile, për menaxhimin e incidenteve. Struktura është e bazuar në tri forma organizative: Sistemin e Komandës së Incidentit, Sistemet e Koordinimit Ndër-Institucional dhe Informimin Publik.

- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme: Në kuadrin e këtij komponenti, ekzistojnë dy komponentë: Instituti i Menaxhimit Emergjent dhe teknologjitë mbështetëse.

Sa i përket emergjencës së shëndetit publik e shpallur nga Qeveria e Kosovës më 15 mars 2020 në përballje me pandeminë COVID-19 në vend,⁶⁷ SIME nuk ka pjesë specifike kushtuar rreziqeve epidemiologjike, vetëm i përmend ato kalimthi. Vlen të përmendet se ekzistojnë referenca për shëndetin publik brenda SIME, megjithatë më shumë detaje për trajtimin e situatave emergjente të shëndetit publik mund të gjenden në PRK.⁶⁸ SIME përmban disa pika të rëndësishme në lidhje me sigurinë e informacionit, relevante edhe në kontekstin e COVID-19, të tilla si rrjedhja e informacionit të ndjeshëm mbi shëndetin publik dhe dezinformimi me potencial për të paraqitur rrezik për sigurinë - duke krijuar panik në publik dhe duke e prishur rrjedhën normale të informacionit. Megjithëse ishte paraparë që SIME të përditësohej në baza dy vjeçare për të marrë parasysh ndryshimet legjislative dhe procedurale, mësimet e nxjerra nga ushtrimet, incidentet e mundshme ose ngjarjet e planifikuara - nuk ka pasur ndonjë përcjellje ose përditësim të SIME-s që nga fillimi i tij në 2010.⁶⁹ Pra, një SIME i ri do të duhet të pasqyrojë zhvillimet në vitet e fundit në mënyrë që të sigurojë qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për menaxhimin e emergjencave në Kosovë. Për shembull, korniza ligjore për Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës ka ndryshuar plotësisht në fund të vitit 2018, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë është nxjerrë në 2012, Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësinë është nxjerrë në 2013, dhe akte të tjera ligjore relevante janë ndryshuar ndjeshëm që nga viti 2010.

Plani i Reagimit Kombëtar (2010)

Pas SIME-së, Qeveria e Kosovës miratoi PRK-në në fund të vitit 2010, duke e ngarkuar Ministrinë e Punëve të Brendshme me zbatimin e këtij dokumenti strategjik.⁷⁰ Plani përfshin përvojat dhe procedurat më të mira nga disiplina të ndryshme të menaxhimit të incidenteve (p.sh. siguria publike, menaxhimi emergjent, zbatimi i ligjit, zjarrfikja, reagimi ndaj materieve të rrezikshme, punët publike, shëndeti publik, shërbimet mjekësore emergjente dhe punëtorët e reagimit dhe rimëkëmbjes në fushën e shëndetit dhe sigurisë) dhe i integron ato në një strukturë të koordinuar dhe të përbashkët.⁷¹ Për më tepër, PRK-ja ofron një kornizë për ndërveprimin qendror me qeverisjen lokale dhe strukturat e degëve rajonale, sektorin privat dhe organizatat joqeveritare në kontekstin e aktiviteteve të parandalimit, gatishmërisë, reagimit dhe rimëkëmbjes nga incidentet/emergjencat/fatkeqësitë. Përveç kësaj, ai përcakton kapacitetet dhe resurset, dhe cakton përgjegjësitë, proceset operacionale dhe protokollet për të ndihmuar në mbrojtjen e vendit nga rreziqet natyrore dhe teknologjike dhe faktorët e shkaktuar nga njeriu, shpëtimin e jetës, mbrojtjen e shëndetit publik, sigurinë, mallrat dhe mjedisin. PRK-ja në fund të fundit shërben si themel për zhvillimin e procedurave të detajuara shtesë për zbatim të aktiviteteve më efektive dhe efikase të menaxhimit të incidenteve brenda llojeve specifike të incidenteve. Duke e përdorur SIME, PRK-ja përcakton mekanizmat për përballimin e aktiviteteve të ndryshme në

67 Vendimi i Qeverisë së Kosovës për shpalljen e emergjencës për shëndetin publik, Nr. 01/11, 15.03.2020.

68 Po aty.

69 Qeveria e Kosovës. (2010). *Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave*. Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës, fq. 4.

70 Vendim i Qeverisë së Kosovës, Nr. 06/150, 23.12.2010.

71 Qeveria e Republikës së Kosovës. (2010). *Plani i Reagimit Kombëtar*. Prishtinë: Qeveria e Republikës së Kosovës, fq. 9. Në dispozicion në: https://ame.rks-gov.net/Portals/0/Files/National_Response_Plan.pdf.

lidhje me menaxhimin e emergjencave.⁷²

Ky dokument përfshin spektrin e plotë të kërkesave të cilat janë komplekse dhe vazhdimisht ndryshojnë përmes parashikimit ose reagimit ndaj fatkeqësive të mëdha dhe emergjencave të tjera, kërcënimeve ose akteve terroriste.⁷³ Është e rëndësishme të theksohet se PRK-ja ofron një bazë për inicimin e aktiviteteve të rimëkëmbjes afatgjate të komunitetit dhe aktivitete parandaluese, duke rezultuar kështu në krijimin e mekanizmave ligjorë dhe institucionalë me përfshirjen e qeverisë (nën koordinimin e MPB-së) në operacionet e menaxhimit të incidenteve.⁷⁴ Andaj, koordinimi mes strukturave dhe proceseve për incidente nënkupton i) mbështetjen qendrore për organet shtetërore, rajonale dhe lokale, ii) ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësive të drejtpërdrejta qendrore të dhëna nga ligji, dhe iii) integrimin e sektorit publik dhe privat në menaxhimin e incidenteve/emergjencave. Veç kësaj, PRK-ja dallon incidente që kërkojnë koordinim nga Ministria e Punëve të Brendshme, incidente të përcaktuara si të karakterit kombëtar dhe ato incidente që ndodhin në baza ditore të mbuluara nga autoritetet dhe agjencitë përmes autorizimeve dhe planeve ekzistuese. PRK-ja është i zbatueshëm për të gjitha ministrinë e linjës dhe organet qeveritare të cilët janë të mandatuar të ofrojnë ndihmë ose të kryejnë operacione në raste të incidenteve ekzistuese ose incidenteve potenciale në nivel kombëtar (incidentet e nivelit kombëtar shtjellohen nga SIME).⁷⁵

Një komponent i rëndësishëm i PRK-së janë Funkcionet Mbështetëse Emergjente (FME) të destinuar për të konsoliduar kapacitetet e ministrive, organeve qeveritare dhe Kryqit të Kuq të Kosovës për të siguruar planifikim, mbështetje, resurse dhe kryerjen e zbatimit të programit dhe shërbimeve emergjente në rast të incidenteve të karakterit kombëtar. FME shërben si një mekanizëm koordinues për të siguruar ndihmë për autoritetet lokale dhe rajonale dhe organet e tjera të ngarkuara për të kryer misionet të përgjegjësive parësore qendrore.⁷⁶ Në kushtet e emergjencës për shëndetin publik, FME 8 i titulluar “Shëndeti Publik dhe Shërbimet Mjekësore” përfshin shëndetin publik, mjekësinë, shërbimet e shëndetit mendor dhe shërbimet mortore⁷⁷:

- Shëndeti publik dhe ndihma mjekësore (FME 8): Ndhma mjekësore është e nevojshme jo vetëm në objektet mjekësore, por në pikat e evakuimit të të plagosurve, në pikat dhe strehimoret e të evakuarëve dhe të refugjatëve dhe në lokacionet tjera për mbështetjen e operacioneve fushore.
- Pajisjet dhe furnizimet mjekësore: PRK tregon nevojën për sasi të mjaftueshme të preparateve farmaceutike për qëllime parandaluese dhe terapeutike, si dhe personel të kualifikuar mjekësor. Kjo nënkupton shpërndarjen e vaksinave për parandalim të sëmundjeve të caktuara ngjitëse që mund të paraqiten gjatë katastrofave.
- Menaxhimi dhe transportimi i të plagosurve dhe të vdekurve: Resurset qendrore mund të kërkohen për zbatimin e menaxhimit të transportit dhe kujdesit për viktimat e sëmura, plagosura apo ekspozuara, nëse numri i tyre është jashtëzakonisht i madh. Për më tepër, numri i pafund i të plagosurve ka gjasa t'i mbingarkojë kapacitetet në dispozicion të shërbimeve mjekësore rajonale dhe lokale.⁷⁸

PRK-ja është gjithashtu një dokument strategjik i vjetëruar me versionin aktual të prezantuar nga

72 Po aty.

73 Po aty, f. 10.

74 Po aty.

75 Po aty.

76 Po aty, f. 17.

77 Po aty, f. 18.

78 Po aty, fq. 113-114.

qeveria në vitin 2010. Faza III e PRK-së kishte paraparë një rishikim të rregullt të dokumentit në cikle katër vjeçare,⁷⁹ çka nënkupton që PRK-ja duhet të ishte rishikuar dy herë (në 2014 dhe 2018) prej atëherë. Sidoqoftë, deri më sot nuk ka informacion në dispozicion nëse dokumenti është shqyrtuar, rishikuar ose botuar çdo katër vjet siç ishte përcaktuar fillimisht. Përkundrazi, vendimi i qeverisë i vitit 2020 për ta shpallur pandeminë COVID-19 në Kosovë si emergjencë për shëndetin publik tregoi se ishte aktivizuar PRK-ja fillestare e miratuar në vitin 2010 për të vënë në fuqi masat e FME 8.⁸⁰ Prandaj, institucionet e Kosovës po operojnë me një dokument të vjetëruar, i cili nuk pasqyron një sërë zhvillimesh madhore në dekadën e fundit, veçanërisht duke përfshirë kornizën ligjore dhe praktikën në Kosovë. Së fundmi, pas lehtësimit të vazhdueshëm të masave mbrojtëse kundër pandemisë COVID-19 në Kosovë, qeveria dhe ministria/ministritë përgjegjëse duhet të ndërmarrin rishikime madhore dhe ta përditësojnë PRK-në aktual. Në mënyrë të ngjashme, ashtu si me SIME, nuk ka raporte në dispozicion të publikut për të regjistruar nivelin e zbatimit të këtyre dokumenteve përgjatë këtyre dhjetë viteve, duke përfshirë informacionin nëse dhe cilat pjesë të kornizës së tyre të organizimit institucional janë funksionalizuar. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për palët e interesit të tilla si institucionet lokale, degët rajonale ose organizatat e shoqërisë civile të cilët ishin gjithashtu të detyruar sipas këtij plani të raportojnë mbi incidentet, të përshtatin planet e reagimit ndaj emergjencave dhe të koordinojnë me institucionet e tjera për reagimin emergjent.

Strategjia e Sigurisë e Kosovës (2019 - draft dokumenti)

Institucionet e Kosovës, posaçërisht institucionet e sigurisë praktikisht janë duke funksionuar pa një Strategji të Sigurisë Kombëtare. Procesi i iniciuar në vitin 2018 nga Qeveria e Kosovës prodhoi një draft të strategjisë së sigurisë që u miratua nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës⁸¹ dhe Qeveria e Kosovës në qershor 2019.⁸² Sidoqoftë, teksa Kosova hyri në një krizë politike për shkak të dorëheqjes së Kryeministrit të atëhershëm Ramush Haradinaj⁸³ në korrik 2019, pasuar nga shpërbërja e Kuvendit⁸⁴ në gusht 2019, institucionet shtetërore nuk arritën ta miratojnë dhe ta zbatojnë këtë dokument strategjik. Ndërkohë është lansuar procesi i ri i hartimit të Strategjisë së Sigurisë së Kosovës 2021-2030, dhe në nëntor 2020 u botua një draft i dokumentit nga Këshilli i Sigurisë i Kosovës për konsultim publik.⁸⁵

Megjithatë dokumenti u hartua në valën e COVID-19 në Kosovë, strategjia e veçon pandeminë COVID-19 mes emergjencave kyçe në Kosovë. Aty thuhet se fatkeqësitë përfshijnë epidemi dhe pandemi (përfshirë COVID-19), zjarre, rrjedhje toksike, rrëshqitje të dheut, aksidente rrugore, ajrore dhe hekurudhore në shkallë të gjerë dhe tërmete. Ky dokument synon të avancojë aspektet teknike, profesionale dhe ligjore për të përcaktuar çka e përbën Infrastrukturën Kritike Kombëtare për Kosovën dhe aftësitë e nevojshme për mbrojtjen e saj nga fatkeqësitë natyrore apo ato të shkaktuara nga faktori njeri. Në këtë drejtim, drafti i dokumentit të strategjisë së sigurisë për Infrastrukturën Kritike Kombëtare do të përfshijë masa substanciale parandaluese dhe menaxhuese

79 Po aty, f. 5.

80 Vendim i Qeverisë së Kosovës Nr. 01/11, 15.03.2020

81 Koha.Net. (2019, 21 korrik). *Qeveria miraton Strategjinë e Sigurisë, Ramadanit pret mbështetje unanime të Kuvendit.*

Në dispozicion në: <https://ëëë.koha.net/arberi/175213/qeveria-miraton-strategjine-e-sigurise-ramadani-pret-mbeshtetje-unanime-te-kuvendit/>.

82 Vendim i Qeverisë së Kosovës, Nr. 07/111, 19.07.2019

83 Thaqi, D., dhe Berisha, E. (2019, 19 korrik). *Haradinaj jep dorëheqje, ftohet nga Specialja.* Në dispozicion në: <https://www.koha.net/arberi/174939/haradinaj-jep-doreheqje/>.

84 Radio Evropa e Lirë. (2019, 22 gusht). *Shpërndahet Kuvendi i Kosovës.* Në dispozicion në: <https://www.evropaelire.org/a/shperndarja-e-kuvendit-/30121899.html>.

85 Zyra e Kryeministrit, "Draft-Strategjia e Sigurisë së Republikës së Kosovës 2021-2030"

kundër emergjencave natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu, si kryerja e një analize të kërcënimeve për të gjitha infrastrukturat kritike që do të hapë rrugën për politika dhe plane veprimi më efektive që lejojnë nivele më të larta të sigurisë dhe sigurimit gjatë emergjencave. Sa i përket aftësive të autoriteteve civile për t'i trajtuar emergjencat dhe fatkeqësitë natyrore, industriale ose të shkaktuara nga njeriu, parashikohet të publikohet Programi i Ushtrimit dhe Vlerësimit të Gatishmërisë Emergjente. Për më tepër, kur merret parasysh korniza aktuale strategjike për emergjencat, strategjia vë në pah se PRK-ja do të rishikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, ndërsa SIME do të plotësohet, bazuar në mësimet e nxjerra nga situatat reale dhe ushtrimet praktike.⁸⁶

Duke iu referuar pandemisë COVID-19 në Kosovë, strategjia e njeh faktin që Kosova "nuk ishte e përgatitur mjaftueshëm për këtë kërcënim të ri" ndaj popullatës, i cili sfidoi shërbimin e kujdesit shëndetësor të Kosovës, ekonominë dhe çështje të tjera të lidhura me to. Për më tepër, pandemia COVID-19 e bazuar në strategji nxori në pah sfidat e mëposhtme: i) nevoja për komunikim më të mirë dhe një qasje gjithëpërfshirëse në kohë krize; ii) institucionet qendrore dhe lokale duhet të përmirësojnë menaxhimin e rrezikut, të promovojnë një kulturë të gatishmërisë dhe të përmirësojnë planifikimin nëpërmjet trajnimit dhe testimit të vazhdueshëm të planeve ekzistuese; dhe iii) alokime më të mira të buxhetit në sektorin e shëndetit dhe sigurisë. Institucionet e Kosovës, sipas këtij drafti të strategjisë së sigurisë, do të përdorin planet e ardhshme të menaxhimit të krizave, duke demonstruar përkushtimin e Kosovës për vazhdimin e zhvillimit të kapaciteteve dhe aftësive në institucionet e sigurisë dhe shëndetësisë në mënyrë shëndeti dhe siguria publike, të mbrohen më mirë në të ardhmen.⁸⁷ Është e rëndësishme të theksohet se strategjia e sigurisë nuk është miratuar ende nga Qeveria dhe as nga Kuvendi i Kosovës.

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2016 - 2020 është një dokument që synon koordinimin e punës së aktorëve në nivelin lokal, ministrive përkatëse si dhe donatorëve të huaj dhe vendas për të zvogëluar rrezikun nga fatkeqësitë dhe në të njëjtën kohë për të kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm për Kosovën. Ky dokument është strategjia e parë për zvogëlimin e rrezikut në Republikën e Kosovës dhe si e tillë shërben si një bazë themelore për ndërtimin e programeve dhe aktiviteteve për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë, megjithatë, ashtu si PRK-ja, SIME dhe Strategjia e Sigurisë Kombëtare, në këtë pikë, kjo strategjia së shpejti do të skadojë - duke paraqitur kështu një dokument tjetër strategjik pa të dhëna në lidhje me zbatimin e tij, nivelin e përfshirjes në vendimmarrje, integrimin e parimeve të reziliencës mes komuniteteve lokale ose ndikimin e përgjithshëm në përvetësimin e masave lehtësuese ndaj fatkeqësive në Kosovë.

86 Qeveria e Republikës së Kosovës - Strategjia e Sigurisë së Republikës së Kosovës 2021-2030, fq. 10-11..

87 Po aty.

HARTËZIMI I PALËVE TË INTERESIT

Situatat emergjente që shpesh shfaqen si ngjarje të papritura mund të kenë ndikim të thellë në institucionet dhe shoqërinë e një vendi. Megjithëse në shumë raste është e vështirë që emergjencat të parashikohen, vendosja e protokolleve të standardizuara të veprimit në kohë krize, një sistemi koordinimi të komunikimit, si dhe alokim i resurseve janë të domosdoshme për lehtësimin e dëmeve nga fatkeqësitë. Efektiviteti i reagimit gjatë emergjencave dhe aftësia për t'u rimekëmbur nga kriza shpesh varen nga sasia e parashikimit, planifikimit, trajnimit dhe koordinimit në nivelin e palëve të interesit. Në një kontekst të karakterizuar me jostabilitet politik, për të siguruar një qasje të qëndrueshme dhe transparente në lidhje me përgatitjen dhe kundërpërgjigjen ndaj emergjencave, pavarësisht nga ndryshimet në udhëheqje, është veçanërisht e rëndësishme të ketë konsistencë. Kjo konsistencë mund të sigurohet përmes një sërë procedurash dhe procesesh të vendosura dhe të zbatuara siç duhet.

Korniza ligjore dhe dokumentet strategjike që udhëzojnë reagimin emergjent në Kosovë përfshin përpjekjet e institucioneve shtetërore dhe agjencive, institucioneve lokale, aktorëve joqeveritarë dhe sektorit privat. Në këtë drejtim, SIME formon përgjegjësitë e të gjithë aktorëve në tre role kryesore:

ROLI POLITIKËBËRËS	ROLI KOORDINUES	ROLI MBËSHTETËS
Krijimi, shqyrtimi, nënshkrimi apo zyrtarizimi i politikave, procedurave, marrëveshjeve të ndihmës reciproke dhe marrëveshjeve të asistencës dhe planeve të lidhura me programet dhe aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve;	Menaxhimi i resurseve apo çdo përpjekje tjetër koordinuese e nevojshme për programet dhe aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve;	Sigurimi i asistencës për programet dhe aktivitetet e menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve.
Teksa MPB-ja është pika qendrore e menaxhimit të emergjencave, ministrinë dhe institucionet e tjera mund të kenë një nga këto role në varësi të natyrës së emergjencës. Institucione të tilla si FSK-ja, PK-ja, Prokuroria, etj., kryesisht luajnë rol mbështetës, duke ushtruar rolet e tyre të zakonshme siç përcaktohen nga ligjet përkatëse, teksa i vënë kapacitetet dhe resurset e tyre në shërbim të menaxhimit emergjent.		

Organizimi i reagimit emergjent në Kosovë parashikon menaxhimin fillestar të incidenteve në nivelin lokal. Sidoqoftë, emergjencat në nivelin kombëtar pritet të përfshijnë shumë juridiksione, duke nënkuptuar se është i nevojshëm një koordinim i konsiderueshëm i nivelit shtetëror. Në varësi të natyrës specifike të emergjencës, institucione dhe agjenci të ndryshme qeveritare, si dhe institucione lokale, sektori jo-qeveritar dhe privat, do të përfshihen në reagimin e menaxhimit. Në varësi të shkallës së kërcënimit/emergjencës, autoritetet shtetërore krijojnë qendra operationale, të organizuara në nivele të ndryshme për të siguruar mbështetje dhe për të koordinuar përpjekjet institucionale para, gjatë dhe pas përfundimit të një emergjence.

KËSHILLI I SIGURISË SË KOSOVËS (KSK)

KSK-ja është një mekanizëm kyç që këshillon institucionet për të gjitha çështjet në lidhje me sigurinë, duke rekomanduar politikat dhe strategjitë e sigurisë, dhe duke bërë vlerësimin e situatës së përgjithshme të sigurisë në Kosovë.⁸⁸ Zhvillimi i politikave dhe strategjive të menaxhimit të emergjencave dhe vlerësimi i efektit të tyre në siguri kalon përmes Këshillit të Sigurisë të Kosovës (KSK). KSK-ja mbështetet nga një Qendër e Situatave që shërben si një qendër operacionale për mbledhjen e informacionit dhe analizë. Ai gjithashtu siguron mbështetje për menaxhimin e emergjencave duke shkëmbyer informacion me të gjitha institucionet në vend dhe koordinon aktivitetet operacionale në mbarë Kosovën.⁸⁹ Teksa roli i tij në kohë normale është këshillues, Këshilli i Sigurisë merr një rol ekzekutiv në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme. Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, KSK-ja ka autoritetin të ndërmarrë veprime të ndryshme që, në përputhje me ligjet në fuqi, janë të nevojshme për trajtimin e gjendjes së jashtëzakonshme. Nëse është e nevojshme, KSK-ja është i autorizuar ta delegojë autoritetin e vet tek organe të ndryshme për trajtimin e situatave të caktuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.⁹⁰ Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, Presidenti i Republikës së Kosovës merr një rol të drejtpërdrejtë në menaxhimin e emergjencave, duke qenë se ai ose ajo bëhet kreu i KSK-së.⁹¹

QEVERIA E KOSOVËS

Përveç në kohën e një gjendje të jashtëzakonshme, përgjegjësinë parësore për menaxhimin e emergjencave e mban Qeveria e Kosovës. Kryeministri e udhëheq vendin në reagimin ndaj një emergjence dhe siguron angazhimin e shpejtë dhe efikas të resurseve në të gjitha emergjencat me karakter kombëtar.⁹² Gjatë një emergjence aktive ose të mundshme, koordinimi i të gjitha aktiviteteve të menaxhimit qendror kryhet përmes Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ministrinë e tjera dhe agjencitë qeveritare e transferojnë autoritetin dhe përgjegjësitë e tyre për reagimin emergjent brenda një kornize të tillë koordinimi.⁹³

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

MPB-ja është përgjegjëse për koordinimin për t'u përgatitur, reaguar dhe rimëkëmbur nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike dhe të shkaktuara nga faktori njeri. Ministri i Punëve të Brendshme është "koordinator qeveritar" për menaxhimin emergjent.⁹⁴ Për më tepër, Ministri gjithashtu është përgjegjës për koordinimin e resurseve qendrore të përdorura në reagim dhe rimëkëmbje nga fatkeqësitë natyrore, teknologjike, të faktorit njeri apo emergjencat tjera nëse dhe kur njëra nga katër kushtet në vijim aplikohet:

- 1) Ministria apo agjencia qeveritare në veprim (sipas autoritetit të saj vetjak) ka kërkuar ndihmën e Qeverisë;
- 2) Resurset regjionale dhe të autoriteteve lokale janë mbingarkuar dhe është kërkuar ndihma qendrore;

88Ligji Nr. 03/L-050 për themelimin e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

89 Po aty.

90 Po aty.

91 Kushtetuta e Republikës së Kosovës [neni 2, paragrafi 8]. Në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

92 Qeveria e Kosovës, Plani i Reagimit Kombëtar.

93 Po aty.

94 Po aty.

- 3) Më shumë se një ministri apo agjenci janë përfshirë thellësisht në reagim ndaj incidentit;
- 4) Ministri është urdhëruar që të marr përsipër përgjegjësinë e menaxhimit të incidentit nga ana e Kryeministrit.⁹⁵

Për më tepër, MPB ka mekanizma shtesë që kanë role specifike në menaxhimin e emergjencave. **Agjencia e Menaxhimit Emergjent (AME)** është një organ shtesë i pavarur që funksionon në kuadër të MPB-së. AME është përgjegjëse për mbështetjen e qytetarëve dhe reaguesve të parë duke siguruar që të gjithë aktorët e përfshirë në menaxhimin emergjent funksionojnë si një organ i vetëm për të zhvilluar, mirëmbajtur dhe avancuar kapacitetet në të gjithë vendin për t'u përgatitur, mbrojtur, reaguar dhe rimëkëmbur nga të gjitha llojet e emergjencave.⁹⁶ AME është e organizuar në nivelin qendror dhe lokal, dhe Drejtoria e Përgjithshme e agjencisë është përgjegjëse për aktivitetet në nivelin kombëtar dhe qendrat 112 që përbëjnë strukturën operacionale të AME në nivelin lokal. Ato përfshijnë shërbime shëndetësore, zjarrfikje dhe polici në nivelin lokal.⁹⁷

Ministritë e linjës

Në varësi të natyrës së emergjencës dhe resurseve të disponueshme, ministri dhe agjenci të ndryshme mund të luajnë një rol parësor, koordinues ose mbështetës në menaxhimin e emergjencave.⁹⁸ Në situatat kur një agjenci e veçantë qeveritare ka autoritetin, kapacitetin dhe përgjegjësinë ligjore për të drejtuar ose menaxhuar aspektet kyçe të reagimit emergjent, ajo agjenci bëhet pjesë e sistemit qendror.⁹⁹ Teksa secila ministri ka rolin e vet të caktuar dhe fushëveprimin dhe misionin përkatës, në rast emergjencash përpjekjet e tyre përqendrohen në menaxhimin emergjent. Për shembull, **Ministria e Punëve të Jashtme** mbetet përgjegjëse për koordinimin e marrëveshjeve dhe marrëdhënieve ndërkombëtare gjatë emergjencave dhe koordinon veprimtaritë e menaxhimit emergjent me partnerë ndërkombëtarë.¹⁰⁰ Në mënyrë të ngjashme, në raste emergjencash **Ministria e Mbrojtjes** mban përgjegjësinë e zakonshme për menaxhimin e kapaciteteve, infrastrukturës dhe pajisjeve të Ministrisë dhe FSK-së.¹⁰¹ Sipas nevojës, në një situatë emergjente, Ministri i Mbrojtjes autorizon mbështetjen e FSK-së për autoritetet civile për menaxhimin emergjent.¹⁰² Ministri i FSK-së mban autoritetin e komandës së FSK-së në të gjitha situatat dhe operacionet.¹⁰³

Në rast të emergjencave të shëndetit publik, barra parësore e menaxhimit emergjent bie mbi **Ministrinë e Shëndetësisë** dhe agjencitë e saj të pavarura, roli i të cilave është të përshtatin kujdesin shëndetësor në përputhje me planin emergjent, të zbatojnë ndryshimet e nevojshme në sistemin e referimit dhe udhëzimit, të sigurojnë sigurimin efektiv të kujdesit shëndetësor emergjent gjatë periudhës së emergjencës për shëndetin publik, dhe të aktivizojnë institucionet e përkohshme të kujdesit shëndetësor dhe të rezervojnë kapacitete plotësuese.¹⁰⁴ Përveç rolit të drejtpërdrejtë të **MSH-së**, agjencitë që veprojnë në kuadër të saj, siç është **Instituti Kombëtar i**

95 Po aty.

96 Misioni i Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave. Në dispozicion në: <https://ame.rks-gov.net/al/Misioni>

97 Ligji Nr. 04/L-230 për Agjencinë e Menaxhimit Emergjent

98 Qeveria e Kosovës. Plani i Reagimit Kombëtar. Në dispozicion në: https://ame.rks-gov.net/Portals/0/Files/National_Response_Plan.pdf

99 Po aty.

100 Po aty.

101 Ligji Nr. 06/L-122 për Ministrinë e Mbrojtjes

102 Qeveria e Kosovës. Plani i Reagimit Kombëtar.

103 Po aty. Për më shumë mbi rolin specifik të FSK-së në menaxhimin emergjent, ju lutemi referojuni kapitullit mbi përgjegjësitë dhe kapacitetet e FSK-së.

104 Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

Shëndetësisë Publike (IKSHP) mbajnë përgjegjësitë e tyre për menaxhimin e emergjencave duke organizuar, zhvilluar, siguruar mbikëqyrje dhe zbatuar politika dhe strategji të shëndetit publik.¹⁰⁵ Ky institut siguron udhëzimet kryesore për kundërpërgjigjen ndaj emergjencave për shëndetin publik dhe siguron zbatimin efektiv të strategjisë për shëndetin publik. Nga ana tjetër, në raste emergjencash, institucionet shëndetësore janë të detyruara të hartojnë planet e tyre për situatën emergjente, në përputhje me përkufizimet e përcaktuara nga Ministria përmes akteve nënligjore.¹⁰⁶

Përveç angazhimeve specifike të të gjitha ministrive dhe agjencive qeveritare për faza të ndryshme të emergjencave kombëtare, disa ministri kanë autoritet të pavarur për shpalljen e emergjencave. Për shembull, Ministria e Shëndetësisë ka autoritetin të shpallë emergjencë për shëndetin publik. Edhe **Ministria e Bujqësisë** mund të shpallë emergjencë nëse një rajon ka pësuar një humbje prej mbi 30 për qind të një prodhimi të caktuar si rezultat i një fatkeqësie.¹⁰⁷ Në mënyrë të ngjashme, ministrinë e tjera, si Ministria e Mjedisit, kanë autoritetin të reagojnë në mënyrë të pavarur në rast të ndotjes së zonave të caktuara me substanca të rrezikshme ose ndotës të ndryshëm që mund të kenë ndikim në mjedis.¹⁰⁸

Qeverisja lokale/Komunat

Në shumicën e emergjencave, resurset lokale, ndihma reciproke dhe marrëveshjet e ndihmës përbëjnë vijën e parë të menaxhimit emergjent dhe reagimit ndaj incidenteve.¹⁰⁹ Për pasojë, komunat lokale dhe kapacitetet lokale të institucioneve të tilla si Policia e Kosovës, objektet dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor dhe zjarrfikësit shërbejnë si shtylla e parë e menaxhimit emergjent. Komunat e Kosovës kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për kundërpërgjigje ndaj emergjencave lokale.¹¹⁰ Kryetarët e komunave janë përgjegjës për koordinimin e resurseve komunale për të adresuar spektrin e plotë të reagimit emergjent dhe në rrethana të caktuara emergjente kanë fuqinë politike për bërjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e urdhrave dhe rregulloreve.¹¹¹ Për më tepër, ata luajnë një rol vendimtar në komunikimin mes autoriteteve lokale, qytetarëve, OJQ-ve dhe sektorit privat dhe për të koordinuar ndihmën e nevojshme me të gjithë palët e interesit.¹¹² Për më tepër, kryetarët e komunave janë përgjegjës për lidhjen e marrëveshjeve për përdorimin e resurseve dhe kapaciteteve të komunave të tjera dhe të kërkojnë ndërhyrjen e qeverisë qendrore kur resurset dhe kapacitetet lokale janë të pamjaftueshme ose të shteruara për menaxhimin efektiv të emergjencës.¹¹³

SISTEMI I DREJTËSISË

Sistemi i drejtësisë është një shtyllë kyçe në sigurimin e një reagimi të ligjshëm ndaj situatave emergjente. Gjykatat dhe Prokurori i Shtetit janë përgjegjës për të hetuar dhe adresuar shkeljet e mundshme gjatë emergjencave, për të siguruar ligjshmërinë e vendimeve të qeverisë gjatë emergjencave dhe për të garantuar mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Plani i Reagimit Kombëtar e vë fokusin e Prokurorit të Shtetit gjatë emergjencave të shtetit në kërcënimet terroriste. Duke vepruar në bashkëpunim me ministrinë dhe agjencitë tjera qendrore angazhohet në aktivitetet e anëtarëve tjerë të komunitetit të zbatimit të ligjit për të zbuluar, parandaluar, frenuar dhe çrregulluar aktet terroriste

105 Misioni i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike

106 Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi.

107 Qeveria e Kosovës. Plani i Reagimit Kombëtar

108 Po aty.

109 Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Emergjencave (2010).

110 Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

111 Qeveria e Kosovës. Plani i Reagimit Kombëtar.

112 Po aty.

113 Po aty.

kundër Republikës së Kosovës.¹¹⁴ Në rast të një gjendje të jashtëzakonshme si rezultat i një kërcënimi terrorist, të gjitha kapacitetet institucionale do të drejtohen në shërbim të Prokurorit të Shtetit për të identifikuar dhe zhdukur kërcënimet.¹¹⁵

FORCA E SIGURISË SË KOSOVËS

Reagimi emergjent ka qenë shenja dalluese e FSK-së që nga formimi i saj. Përgjegjësitë kryesore të FSK-së janë të reagojë ndaj krizave, të ndihmojë autoritetet civile në reagimin ndaj fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera dhe emergjencave dhe të ndihmojë autoritetet civile përmes operacioneve të mbrojtjes civile.¹¹⁶ Gjithashtu, në përputhje me Ligjin e vitit 2008 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, FSK-ja ka një komponent të reagimit emergjent për të kryer kërkimin dhe shpëtimin, çminimin, trajtimin e materieve të rrezikshme, shuarjen e zjarrit dhe aftësitë e tjera të ndihmës humanitare. Në një gjendje të jashtëzakonshme, FSK-ja mund të thirret nga Presidenti i Kosovës¹¹⁷ të kryejë operacione emergjente në përputhje me kompetencat dhe detyrat e saj kushtetuese dhe ligjore.¹¹⁸ Ligje të reja kanë përcaktuar më tej mandatin e FSK-së, organizimin dhe funksionet e saj pas transformimit të saj. Teksa dokumentet e reja nuk i referohen drejtpërdrejt rolit të FSK-së në situata emergjente, reagimi ndaj krizave dhe emergjencave ende përfshihet në vlerat dhe detyrat thelbësore të organizatës.

POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës vepron nën autoritetin e MPB-së dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Për më tepër, Drejtori i Përgjithshëm bashkëpunon me Ministrin dhe i siguron atij/asaj informacion dhe raporte të përcaktuara me ligj. Në përputhje me këtë, në sferën e rendit dhe sigurisë publike, Ministri ka të drejtë të kryejë funksione në lidhje me përgatitjet për raste emergjente.¹¹⁹ Një nga detyrat dhe kompetencat kyçe të PK-së është të sigurojë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera.¹²⁰ Gjithashtu, kur bëhet fjalë për raste emergjente, përveç zyrtarëve të rregullt policorë, thirren edhe rezervistët.¹²¹ Në përputhje me AME, PK është një nga tre reaguesit e parë emergjent, përgjegjës për të mbrojtur dhe shpëtuar jetën, materialet dhe provat në fazat shumë të hershme të emergjencës. Policia e Kosovës është përgjegjëse për të menaxhuar incidentet në nivelin lokal.¹²²

114 Po aty.

115 Po aty.

116 Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

117 Ligji Nr. 03/L-046 për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

118 Po aty


119 Neni 5 i Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.

120 [2] Neni 10 i Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.

121 Neni 36 i Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë.

122 Qeveria e Kosovës. Plani i Reagimit Kombëtar.

PANDEMIA COVID-19 DHE REAGIMI I KOSOVËS



SHPËRTHIMI GLOBAL I COVID-19

Pavarësisht paralajmërimeve të hershme nga komuniteti shkencor për rreziqet ndaj pandemieve,¹²³ shpërthimi i koronavirusit të ri i gjeti vendet nëpër botë kryesisht të papërgatitura. COVID-19 është sëmundja e shkaktuar nga ky virus i ri, i cili u identifikua për herë të parë në Kinë në dhjetor 2019, kur në Wuhan, Provinca Hubei, u raportuan disa raste misterioze të pneumonisë.¹²⁴ SARS-CoV-2 përhapet kryesisht përmes transmetimit nga spërklat e frymëmarrjes në afërsi ndërmjet personave dhe transmetimit ajror në zona me ventilim të dobët. Megjithëse virusi nuk diskriminon dhe ka shkallë vdekshmërie 10 herë më të lartë se sa gripi sezonal, ai përbën rrezik më të madh për grupe të caktuara të popullsisë, siç janë njerëzit e moshuar dhe ata me probleme eksistuese shëndetësore.¹²⁵ Kjo nënkupton rritje në numrin e të vdekurve me rritjen e numrit të infektiveve. Për më tepër, koronavirusi i ri duket të jetë më ngjithës sesa llojet e tjerë, veçanërisht pasi mund të përhapet përmes “shpërndarësve të heshtur” ose njerëzve që janë infektivë por janë asimptomatikë, që vlerësohet se përbëjnë deri 50% të infektiveve.¹²⁶¹²⁷

Për shkak të niveleve alarmuese të përhapjes, në mars 2020, OBSH-ja e përcaktoi COVID-19 si pandemi - shpërthim i sëmundjes që mbulon një zonë të gjerë gjeografike dhe prek një pjesë jashtëzakonisht të lartë të popullsisë.¹²⁸ Kjo bëri që shumë vende të deklaroinin emergjencë kombëtare për të mbrojtur shëndetin dhe minimizuar dëmet ekonomike dhe sociale.¹²⁹ Ndërkohë që njohuritë rreth virusit të ri janë ende duke u konsoliduar, shtetet përballen me sfidën se si të reagojnë më së miri në kushte paqartësie. Për shkak të mungesës së një trajtimi të gatshëm, siç janë barnat anti-virale ose vaksinat, fokusi u vu tek frenimi i sëmundjes përmes masave të tilla si izolimi i rasteve të infektuara, gjurmimi i kontakteve, testimi, maskat e detyrueshme të fytyrës, distancimi social, karantinat e pjesshme ose të plota, dhe mbyllja e kufijve. Të paktën 186 vende kanë zbatuar shkallë të ndryshme të kufizimeve ndaj lirisë së lëvizjes për të ngadalësuar ritmet e transmetimit dhe për të parandaluar mbingarkesën e sistemeve shëndetësore.¹³⁰ Teksa masat kufizuese kanë ndihmuar për të shpëtuar jetë, ato gjithashtu kanë çuar në rritje të niveleve të papunësisë dhe varfërisë; Banka Botërore pret recesionin më të thellë global që nga Lufta e Dytë Botërore.¹³¹

Deri në fillim të dhjetorit, më shumë se 67 milion njerëz janë infektuar nga COVID-19 në mbarë botën, dhe pandemia ka marrë mbi 1.5 milion jetë.¹³² Numri i infeksioneve ka tendencë të luhet dhe shpesh përshkruhet në terma të valëve, duke nënkuptuar një numër në rritje të infeksioneve, një kulm të përcaktuar, dhe më pas një rënie, duke lënë të kuptohet se edhe gjatë një mpakje, mund të ketë rritje të rasteve në të ardhmen.¹³³ Ndryshimet në kufizime zakonisht duhet të bazohen në parime të shëndetit publik, siç janë informacioni mbi statusin e infeksionit (treguesit për monitorimin e përhapjes), mbështetja e komunitetit (p.sh. mbështetja socio-ekonomike, besimi i publikut), kapaciteti i shëndetësisë publike (testimi, gjurmimi, ekspertiza) dhe kapaciteti

123“Eksptetët paralajmëruan për një pandemi dekada më parë. Pse nuk ishim gati?”, National Geographic, qasur përmes <https://www.nationalgeographic.com/science/2020/04/experts-earned-pandemic-decades-ago-ehy-not-ready-for-coronavirus/>

124Sauer, “What is Coronavirus” qasur përmes <https://www.hopkinsmedicine.org/health/conditions-and-diseases/coronavirus>

125 Grady, “How does coronavirus compare to the flu?”, qasur përmes <https://www.nytimes.com/article/coronavirus-vs-fluhtml>

126 Po aty.

127Brown Chou “Silent spreaders” could be behind half of COVID-19 cases, study finds”, qasur përmes <https://www.cbsnews.com/news/coronavirus-asymptomatic-presymptomatic-silent-spreaders/>

128 Po aty.

129 Fjalë hapëse e udhëheqësit të OBSH-së, 11 March 2020 përmes <https://www.who.int/director-general/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19---11-march-2020>

130 Qasur përmes [https://www.thelancet.com/article/S0140-6736\(20\)32007-9/fulltext](https://www.thelancet.com/article/S0140-6736(20)32007-9/fulltext)

131 Po aty.

132përmes <https://www.bbc.com/news/world-51235105>

133 <https://theconversation.com/what-makes-a-wave-of-disease-an-epidemiologist-explains-141573>

i sistemit shëndetësor (pajisjet e trajtimit, pajisjet mjekësore).¹³⁴ Sidoqoftë, jo të gjitha vendet ndjekin parime të tilla dhe OBSH-ja ka paralajmëruar se lehtësimi i parakohshëm i kufizimeve mund të shkaktojë rritjen e infektiveve dhe të shkaktojë dëme edhe më të rënda dhe afatgjata në ekonomi.¹³⁵

Sfida e menjëhershme ka qenë identifikimi i qasjes së duhur për të ndaluar përhapjen e infektiveve, për të rritur kapacitetet e shëndetësisë publike dhe trajtimit mjekësor për të përmirësuar shanset e rimëkëmbjes, duke lehtësuar pasojat socio-ekonomike. Në përgjithësi, vendet që reagojnë me sukses kanë pasur mesazhe konsistente në nivelin udhëheqës, me masa të hershme kufizuese të shoqëruara me testimet masive dhe gjurmim të kontakteve të rasteve të infektuara, të cilat siguruan informacion të shpejtë dhe të besueshëm se si po përhapet sëmundja. Një trend që u bë i dukshëm në reagimin e shteteve ka qenë niveli relativisht më i madh i suksesit i vendeve të udhëhequra nga gra, si Zelanda e Re, Gjermania dhe Tajvani - të cilat duket se kanë qenë më proaktive sesa homologët e tyre meshkuj, duke marrë masa të hershme vendimtare me aversion ndaj riskut, duke përdorur një qasje më gjithpërfshirëse dhe një sistem të qartë komunikimi me publikun.¹³⁶ Megjithëse vendet e zhvilluara kanë pasur vështirësi me pandeminë dhe reagimet e tyre kanë dhënë rezultate jo konsistente, vendet në zhvillim me resurse dhe kapacitete më të kufizuara janë përballur me sfida shtesë.

Në Ballkanin Perëndimor (BP), rasti i parë i COVID-19 u raportua në fund të shkurtit në Maqedoninë e Veriut, gjatë një kohe kur Italia tashmë po përballej me një krizë serioze, dhe u pasua nga rastet e raportuara në Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Shqipëri, Kosovë, dhe Mal të Zi.¹³⁷ Me përhapjen e COVID-19, vendet e BP-së morën masa për të mbrojtur sistemet e tyre të brishta shëndetësore, p.sh. duke blerë pajisje mjekësore, duke i transformuar objektet mjekësore në qendra të specializuara për COVID-19, ose duke bërë ndryshime në menaxhimin e stafit mjekësor.¹³⁸ Si pjesë e planeve të karantinës së plotë ose të pjesshme, u mbyllën edhe kufijtë dhe aeroportet, shkollat, ndaluan tubimet e mëdha, kufizuan udhëtimet e brendshme dhe zbatuan orët policore.¹³⁹ Masat e pashembullta të karantinës i vunë në sprovë të mëtejshme standardet e brishta ekzistuese të transparencës, llogaridhënies dhe sundimit të ligjit në BP, teksa kanë nxjerrë në pah mangësitë në funksionimin e administratave publike.¹⁴⁰ Megjithatë shumë prej këtyre masave shkelin të drejtat individuale, mbrojtësit e të drejtave të njeriut kanë shprehur shqetësime se vendimet e marra gjatë pandemisë mund të kenë implikime afatgjata në liritë civile dhe funksionimin e demokracisë, duke u përkeqësuar edhe nga pasojat rrënuese sociale dhe ekonomike.

Aktualisht, rajoni po përjeton një rritje tjetër të rasteve, sistemet shëndetësore publike po mbingarkohen dhe stafi mjekësor është i stërmunduar. Në planin afatshkurtër, kjo tregon se koha relative e qetësisë mes valëve të ndryshme të infektiveve nuk ishte e mjaftueshme që sistemet shëndetësore publike të përvetësonin ose zbatonin masa domethënëse për të përmirësuar kapacitetet e tyre. Nga ana tjetër, në planin afatgjatë, do të jetë sfiduese të gjejmë mënyra për t'i brendësuar mësimet e nxjerra nga kjo përvojë në mënyrë që të parandalohen shpërthime të tjera teksa sistemet rikalibrohen për një reagim më efikas dhe efektiv në të ardhmen.

Megjithëse përhapja e shpejtë e pandemisë COVID-19 ilustron cenueshmëritë e përbashkëta dhe

134 [https://www.thelancet.com/article/S0140-6736\(20\)32007-9/fulltext](https://www.thelancet.com/article/S0140-6736(20)32007-9/fulltext)

135 Po aty.

136 <https://www.weforum.org/agenda/2020/09/women-leaders-coronavirus-better-than-men>

137 <https://www.reuters.com/article/us-china-health-north-macedonia-idUSKCN20K2G8>

138 <https://www.oecd.org/south-east-europe/COVID-19-Crisis-Response-Western-Balkans.pdf>

139 Po aty.

140 Hapja e qeverive në kohë karantine: Mësimet e nxjerra për administratat e orientuara drejt qytetarëve nga kriza COVID-19 në Ballkanin Perëndimor, Marko Sošić dhe Milena Lazarević

ndërvarësinë mes vendeve në të gjithë botën, janë ngritur shqetësime në lidhje me mungesën e koordinimit mes vendeve për t'u mobilizuar kundër COVID-19,¹⁴¹ duke marrë e vendimeve të tilla si ndalimi i BE-së për eksport të pajisjeve mjekësore.¹⁴² Vendime të tilla minuan solidaritetin evropian dhe krijuan një ndjenjë braktisjeje mes vendeve të tjera, përfshirë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Pandemia gjithashtu nxiti shtetet dhe komunitetin global shkencor për të hyrë në garën e gjetjes së një vaksine, e cila u zhvillua në kohë rekord.¹⁴³ Teksa vakcina e re ngre shpresën për t'i dhënë fund pandemisë, ajo ngre edhe çështje në lidhje me sistemet e shpërndarjes. Gjegjësisht, vlerësohet se në vendet më pak të zhvilluara, siç janë ato të Ballkanit Perëndimor, do të ketë vonesa të konsiderueshme në sigurimin e vaksinave për shkak të infrastrukturës së mangët, por edhe mungesës së mjeteve financiare për të siguruar blerjen e saj.¹⁴⁴

REAGIMI I KOSOVËS NDAJ SITUATËS SË PANDEMISË COVID-19

Rastet e para të konfirmuara të COVID-19 në Kosovë u raportuan më 13 mars, një italiane 22 vjeçare që qëndronte në qytetin e Klinës dhe një 77 vjeçar nga Vitia, të dy të sapo ardhur nga Italia, e cila gjatë asaj kohë ishte vendi më i goditur evropian nga COVID-19.¹⁴⁵ Deri në mes të dhjetorit, ka pasur rreth 47,952 raste të konfirmuara COVID-19 në Kosovë, më shumë se 1,200 individë kanë humbur jetën, dhe më shumë se 36,000 të tjerë janë shëruar. Ndërkohë që nuk përfshihen si pjesë e të dhënave për COVID-19, duhet të merret parasysh edhe numri i vdekjeve shtesë, ose ndryshimi mes numrave të vëzhguar të vdekjeve në periudha specifike kohore dhe numrave të pritur të vdekjeve në të njëjtat periudha kohore që përfshijnë vdekjet që i atribuohen drejtpërdrejt ose tërthorazi COVID-19.¹⁴⁶ Për shembull, ky lloj i të dhënave do të përfshinte vdekjet si rezultat i keqmenaxhimit të resurseve, mungesës së qasjes në shërbimet mjekësore për sëmundjet e parandalueshme, mungesës së mjeteve financiare ose thjesht pamundësisë për trajtim për shkak të një sistemi të kujdesit shëndetësor të mbingarkuar me pacientë COVID-19. Pas një rënie në gusht dhe shtator, numri i rasteve u rrit ndjeshëm gjatë nëntorit, duke regjistruar numrin më të lartë të rasteve të reja ditore dhe rasteve aktive që nga fillimi i pandemisë në mars 2020.¹⁴⁷ Sipas OBSH-së, shkalla e transmetimit në Kosovë ka arritur në 1.6, që do të thotë se çdo 100 njerëz që e kanë virusin ka të ngjarë të infektojnë 160 persona të tjerë.¹⁴⁸ Spitalet dhe qendrat mjekësore në të gjithë vendin janë pranë shterimit të kapaciteteve dhe po rritet numri i personelit mjekësor të infektuar, duke e munduar edhe më tej sistemin e kujdesit shëndetësor.¹⁴⁹

Për të parë reagimin e Kosovës ndaj pandemisë, duhet të mirret parasysh se brenda kësaj periudhe (shkurt - dhjetor 2020) Kosova u përball me një krizë politike, e cila solli ndërrimin e qeverive dhe më pas të qasjes për trajtimin e krizës së COVID-19. Andaj, reagimi i Kosovës ndaj pandemisë duhet të shqyrtohet në dy periudha të ndara: masat e ndërmarra gjatë Qeverisë Kurti (shkurt - qershor¹⁵⁰ 2020) dhe masat e marra gjatë Qeverisë Hoti (qershor 2020 - deri më sot¹⁵¹). Përkundër

141 <https://www.itv.com/news/2020-06-24/un-chief-criticises-lack-of-global-cooperation-on-covid-19>

142 <https://www.piie.com/blogs/trade-and-investment-policy-ëatch/eu-limits-medical-gear-exports-put-poor-countries-and>

143 <https://www.nytimes.com/2020/11/09/health/covid-vaccine-pfizer.html>

144 <https://europeanëesternbalkans.com/2020/08/27/ëb-so-far-not-included-in-the-eus-contracts-to-procure-the-future-covid-19-vaccines/>

145 <https://balkaninsight.com/2020/03/13/kosovo-confirms-first-tëo-coronavirus-cases/>

146 https://www.cdc.gov/nchs/nvss/vsrr/covid19/excess_deaths.htm

147 IKSHPK, Të dhënat për rastet e konfirmuara me COVID-19 në Kosovë

148 Po aty.

149 Po aty.

150 Qeveri në detyrë prej 25 marsit, 2020

151 Qeveri në detyrë prej 21 dhjetorit, 2020

ndryshimeve të dukshme në qasjen e qeverive përkatëse, disa masa u rivendosën, dhe shumë prej këtyre masave kanë ardhur edhe si rezultat i udhëzimeve të jashtme nga OSH-ja ose ECDC-ja, ose nga rekomandimet e IKSHPK-së.

Reagimi i Kosovës u karakterizua nga zbatimi relativisht i hershëm i masave të karantinës në krahasim me vendet e tjera të rajonit, të cilat në planin afatshkurtër kishin një ndikim në mbajtjen nën kontroll të numrit të rasteve. U vendosën sisteme të ndërlikuara të orës policore, duke e përcaktuar lëvizjen e qytetarëve në orë specifike bazuar në numrat e letërnjoftimeve të tyre, si dhe bazuar në grupmoshat më të ndjeshme ndaj virusit (mbi 65 vjeç). Numri i ulët i rasteve pa dyshim lejoi një gjurmim më efikas të kontakteve të personave të infektuar dhe të testeve. Sidoqoftë, marrë parasysh që në muajt e parë sigurimi i testeve për COVID-19 ishte më sfidues, numri i ulët i testeve të administruara e bëri të vështirë pasjen e një përfaqësimi më të saktë të trendit, krahasuar me situatën aktuale ku kapacitetet e testimit janë rritur ndjeshëm, nga rreth 200 teste në ditë deri rreth 2000 në ditë.

Gjatë fazës së hershme të pandemisë, kur qeveria vendosi masa më kufizuese për herë të parë, u duk se numri i rasteve të infektiveve u mbajt nën kontroll. Sidoqoftë, sapo u lehtësuan masat në muajin maj, kjo u pasua nga rritja e numrit të rasteve të reja, veçanërisht gjatë valëve që ishin në përputhje me rritjen e rasteve në të gjithë Evropën. Sërish, çdo raportim i rasteve duhet të merret në konsideratë në lidhje me kapacitetet e testimit dhe shkallën e vdekshmërisë, që do të thotë se kur ka më shumë teste në dispozicion ka shanse më të larta për të identifikuar më shumë raste.

Spektri i masave përfshinte mbylljen e shkollave, qendrave tregtare, bareve, restoranteve, parqeve dhe aktiviteteve rekreative, si dhe mbylljen e bizneseve jo esenciale. Edhe komunat e Kosovës u klasifikuan në kategori me rrezik të lartë, të mesëm ose të ulët bazuar në numrin e rasteve të infektiveve. Masat e tjera përfshinin kufizime për tubimet në mjedise të brendshme dhe numrin e njerëzve që hynin në institucione publike, kufizimin e numrit të njerëzve në transportin publik dhe privat, mbylljen e kufijve, vendosjen e kontrolleve mjekësore në kufi, zvogëlimin e numrit të personelit jo esencial në hapësirat e punës publike dhe private, aty ku ishte e mundur, bërjen e detyrueshme të mbajtjes së maskave dhe distancimit social, kërkesën ndaj bizneseve dhe institucioneve publike që t'i dezinfektonin rregullisht hapësirat, vendosjen e udhëzimeve të dukshme për masat mbrojtëse kundër COVID-19 etj.

Që nga fillimi i pandemisë, MSH-ja është kthyer në prani të rregullt në shumicën e kanaleve mediatike, gjersa publiku pret të dëgjojë përditësimet e fundit në lidhje me rastet dhe masat e vendosura. Megjithatë, arsyetimi i masave të vendosura për të frenuar pandeminë nuk ishte bërë gjithmonë i qartë, ndërsa prej publikut pritej t'i respektonte masat sapo të njoftoheshin. Për shembull, kur u mor masa për t'i lehtësuar kufizimet, ai vendim nuk përmbante caqe specifike të shkallës së infektimit. Arsyeja për masa të tilla u vu në pikëpyetje kur qeveria u dorëzua nën presionin e restoranteve për t'i lehtësuar masat, përkundër trendit në rritje të rasteve COVID-19. Ngjashëm, në disa raste kritikët shprehën shqetësime se masat qeveritare ishin të gabuara dhe nuk u morën bazuar në të dhëna solide. Për shembull, teksa hulumtimet tregojnë se shkollat kanë tendencë të jenë mjedise relativisht të sigurt,¹⁵² Ministria e Arsimit mori vendimin për t'i mbyllur shkollat për periudha të gjata kohore, pa paraqitur të paktën një arsyetim të qartë pse kërkohen masa të tilla në rastin e Kosovës. Megjithëse MSH-ja e Kosovës e bazoi vendimmarrjen e saj për të gjitha vendimet e marra në lidhje me pandeminë në rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike, asnjë nga këto raporte nuk ishte i disponueshëm për publikun.¹⁵³

¹⁵² "Why schools probably aren't COVID hotspots" via <https://www.nature.com/articles/d41586-020-02973-3>

¹⁵³ Hapja e qeverive në kohë karantine: Mësimet e nxjerra për administratat e orientuara drejt qytetarëve nga kriza COVID-19 në Ballkanin Perëndimor,

Në përgjithësi, shqetësimet rreth validitetit të masave të kundërpërgjigjes ndaj trendit të infektiveve lidhen me mungesën e hulumtimeve rigoroze se si po transmetohet COVID-19 brenda vendit, si dhe mënyrën se si pacientët shërohen ose vdesin prej tij. Kjo lidhet ngushtë me mungesën e të dhënave të disponueshme për rastet me COVID-19, duke përfshirë vënien në dispozicion të të dhënave të zbërthyer bazuar në karakteristika të ndryshme. Zbërthimi i të dhënave për rastet, fatalitetet dhe ndikimet ekonomik dhe social sipas seksit, moshës, etnisë dhe racës, aftësisë së kufizuar dhe statusit ekonomik - është me rëndësi jetike për të kuptuar ndikimet diferenciale të pandemisë në grupe të caktuara të shoqërisë dhe për ta përshtatur kundërpërgjigjen.¹⁵⁴ Informacione më të plota të disponueshme për publikun rreth COVID-19 do t'u mundësonte ekspertëve dhe akademikëve të kryejnë hulumtime më rigoroze për ta vlerësuar më mirë situatën, duke siguruar edhe një pasqyrë më të saktë të mënyrës se si po përhapet virusi në Kosovë, ku ndodhen pikat e nxehta, dhe cilat masa duket se po funksionojnë ose jo. Studime të tilla janë të dobishme për informimin më të mirë të publikut dhe për hartimin e politikave të bazuara në dëshmi, përfshirë edhe shpërndarjen e vaksinave bazuar në cenueshmërinë e komuniteteve të ndryshme.

Pandemia COVID-19 paraqet një situatë në zhvillim e sipër, dhe me përjashtim të vonesave relative mes dy valëve, situata mund të përqeshohet jo vetëm brenda javës, por edhe brenda ditëve. Megjithatë, teksa politikëbërësit kërkojnë të rrisin efektivitetin e tyre të reagimit, ata duhet të jenë të kujdesshëm ndaj dyzimit të rremë mes shëndetit publik dhe ekonomisë, me fjalë të tjera mes shpëtimit të jetëve apo ruajtjes së ekonomisë. Shëndeti dhe ekonomia janë të ndërlidhura janë qytetarët e shëndetshëm që e bëjnë produktive fuqinë punëtore dhe shoqërinë. Në vend të kësaj, masat duhet të përqendrohen në adresimin e fushave prioritare që ndihmojnë në zbutjen e humbjeve ekonomike duke mos vënë në rrezik jetën e njerëzve.¹⁵⁵ Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të disa prej vendimeve kryesore të qeverisë që janë marrë për të parandaluar përhapjen e infektiveve në Kosovë, duke u përpjekur që ngjarjet të paraqiten në rend kronologjik.

QEVERIA KURTI PËRBALLET ME PANDEMINË COVID-19

Rastet e para të COVID-19 në Kosovë u raportuan kur në pushtet erdhi partia kryesore opozitare në vend, Lëvizja Vetëvendosje e udhëhequr nga Albin Kurti, në sajë të një marrëveshjeje për ndarjen e pushtetit me Lidhjen Demokratike të Kosovës. Qeveria jetëshkurtër e mori detyrën ndërkohë që udhëheqësit e Kosovës u vunë nën presion nga Administrata Trump për ta vulosur një marrëveshje me Serbinë përpara zgjedhjeve në SHBA. Kurti dhe bashkëpunëtorët e tij e kundërshtuan këtë marrëveshje, çka përfundimisht çoi në një seri lëvizjesh që i thelluan përçarjet brenda koalicionit qeverisës duke ndikuar që planifikimi për fillimin e pandemisë të mbetej në prapavijë. Pas kësaj erdhi kriza politike, një rivalitet dhe polarizim i thelluar politik që u zhvillua paralelisht me përpjekjet për ta menaxhuar pandeminë, duke i minuar shpesh përpjekjet për ta frenuar përhapjen e pandemisë dhe për t'i sanuar pasojat e saj. Pa referenca të qarta paraprake, me organe joadekuete për menaxhimin e një fatkeqësie të shëndetit publik, dhe me politizimin e masave të ndërmarra për ta luftuar COVID-19, zyrtarët qeveritarë, nëpunësit publikë dhe kryesisht profesionistët e kujdesit shëndetësor u përballën me një betejë të pamundur të karakterizuar nga improvizimi dhe vendimmarrje ad hoc që i dha një goditje të dëmshme besimit tashmë të dobët të publikut në institucionet e reja të vendit.

Një nga masat e hershme qeveritare të ndërmarra për të rritur nivelet e gatishmërisë ishte formimi i Komitetit për Koordinimin dhe Vlerësimin e Situatës Emergjente me COVID-19, i ngritur përmes

¹⁵⁴ <https://reliefweb.int/report/world/insights-action-gender-equality-eake-covid-19>

¹⁵⁵ <https://www.channelnewsasia.com/news/singapore/who-tedros-ghebreyesus-covid19-updates-singapore-13121480>

Ministrisë së Shëndetësisë bazuar në Planin e Reagimit Kombëtar dhe dispozitat e nenit 8 për emergjencat për shëndetin publik.¹⁵⁶ Më pas u formua një grup punues për të hartuar një plan reagimi ndaj pandemisë teksa zyrtarët shëndetësorë tentuan të përmirësojnë furnizimin me pajisje mbrojtëse për stafin mjekësor, të rrisin kapacitetet për të trajtuar rastet me COVID-19, të trajtojnë stafin mjekësor për të menaxhuar ngarkesën e rasteve, të mbajnë publikun të informuar, të mbajnë bashkëpunimin me OBSH-në dhe ECDC-në dhe të zbatojnë rekomandimet e tyre. Qeveria miratoi Planin e Gatishmërisë dhe Reagimit ndaj COVID-19, duke përcaktuar drejtimin e veprimit për mekanizmat relevantë të përfshirë në menaxhimin e pandemisë, si dhe miratoi kërkesat e MSH-së për një sërë çështjesh si mbyllja e shkollave, pezullimi i përkohshëm i udhëtimit, ndalimi i eksportit të pajisjeve dhe materialeve mjekësore.¹⁵⁷ Edhe institucionet palë kyçe të interesit siç janë Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) zhvilluan protokolle për menaxhimin e rasteve bazuar në udhëzimet e ECDC-së dhe OBSH-së.

Përveç masave të menjëhershme parandaluese për të frenuar përhapjen e virusit, përfaqësuesit e ndërlidhjes nga institucionet përkatëse u mblodhën në Qendrën e Situatave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës për të koordinuar aktivitetet operacionale. Më 15 mars 2020, me kërkesë të Ministrit të Shëndetësisë, u shpall një gjendje e emergjencës për shëndetin publik që i detyroi institucionet të vepronë në përputhje me PRK-në, duke e vendosur MSH-në si njësinë përgjegjëse për menaxhimin e pandemisë.¹⁵⁸ Qendra Operative u krijua në Ministrinë e Shëndetësisë më 16 mars, dhe kjo u pasua nga qendrat operative në nivele ministrore dhe komunale. Në të 38 komunat anembanë Kosovës, u krijuan Shtabet Lokale të Emergjencës.¹⁵⁹ MSH-ja hapi edhe një ueb faqe kushtuar pandemisë COVID-19, që përmbante informacion mbi statistikën më të fundit, simptomat e COVID-19, masat parandaluese që duhej të merreshin nga qytetarët, opsionet për vullnetarizëm, informacionet e kontaktit, dhe një seksion për orët selektive policore.¹⁶⁰ Konviktet e Qendrës së Studentëve u caktuan si hapësirë karantine, me 1180 persona të pranuar gjatë funksionimit të saj. Një qendër shtesë në periferi të Prishtinës u caktua si një qendër karantine për të huajt që hynin në Kosovë, dhe prej 31 marsit u ndalua i gjithë transporti urban.

Qeveria e Kosovës i ndaloi tubimet në të gjitha mjediset private dhe publike më 23 mars, duke lejuar vetëm deri në dy persona që duhej të praktikonin distancimin social. Me kërkesë të autoriteteve shëndetësore, qeveria e Kosovës caktoi edhe orën policore ndërmjet orës 10:00 dhe 16:00 dhe nga 20:00 deri në 06:00, me përjashtim të personave në nevojë për kujdes mjekësor, por edhe për prodhimin, furnizimin dhe shitjen e mallrave esenciale, siç janë ushqimet dhe barnat. Kufizimet nuk zbatoheshin as për shërbimet dhe aktivitetet në lidhje me menaxhimin e pandemisë.¹⁶¹ Sidoqoftë, vendimi i qeverisë për kufizimin e lëvizjes u kundërshtua nga Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, rivali politik i Kurtit, i cili bëri thirrje publike për mosrespektim duke e quajtur masën antikushetuese për shkak të kufizimit të lirisë së lëvizjes,¹⁶² duke e zhytur Kosovën në gjendje konfuzioni dhe duke e politizuar menaxhimin e pandemisë përgjatë vijave politike. Një javë më vonë, Gjykata Kushtetuese vendosi që vendimi i qeverisë për të kufizuar lëvizjen gjatë pandemisë nuk ishte në përputhje me kushtetutën e Kosovës, duke e shpallur të paligjshëm.¹⁶³

156 <https://msh.rks-gov.net/sq/njoftimi-per-coronavirus/>

157 <https://ëëë.koha.net/veshtrime/218921/ra-kjo-pandemi-e-u-pame/>

158 <https://kallxo.com/lajm/qeveria-shpall-gjendje-emergjente-dokument/>

159 <https://komunat-ks.net/2020/07/09/asociacioni-i-komunave-nxori-studimin-mbi-nevojat-emergjente-dhe-ndikimin-so-cio-ekonomik-te-covid-19-ne-pushtetin-lokal-ne-kosove/?lang=en>

160 hapja

161 Lista e detajuar e masave është e qasshme në <https://kryeministri-ks.net/en/the-kosovo-government-holds-its-15th-meeting/>

162 <https://ëëë.koha.net/arberi/215490/per-thirrjen-per-rezistence-thaci-mund-te-denohet-me-5-vjet-burgim/>

163 Sipas vendimit të marrë njëzëri nga Gjykata “Vendimi i Qeverisë nuk është në përputhshmëri me nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në lidhje me Nenin 35 [Liria e Lëvizjes], 36 [E Drejta e Privatësisë], 43 [Liria e Tubimit] të Kushtetutës dhe Nenin 2 (Liria e Lëvizjes) të Protokollit nr. 4, nenin 8 (E drejta për jetë private dhe familjare) dhe nenin 11 (Liria e tubimit dhe asociimit) të KEDNJ”, thuhet në vendimin e gjykatës.

Vendimi i qeverisë u bazua në dy ligje, Ligjin për Parandalimin e Sëmundjeve Ngjithëse dhe Ligjin për Shëndetësi. Sipas Gjykatës Kushtetuese, këto dy ligje nuk e autorizojnë Qeverinë të kufizojë lirinë e lëvizjes dhe të drejtat e garantuara nga Kushtetuta, mirëpo e autorizojnë Ministrinë e Shëndetësisë të marrë masa në ato ligje.¹⁶⁴ Në pritje të një ligji të ri për masat parandaluese gjatë situatës së pandemisë, Gjykata Kushtetuese lejoi dy javë që vendimi i saj të hynte në fuqi për shkak të pandemisë, rekomandimeve të institucioneve shëndetësore shtetërore, dhe pasojave të dëmshme të mundshme për shëndetin publik që mund të rezultonin nga anulimi i menjëhershëm i vendimeve të qeverisë.¹⁶⁵

Në prill, MSH-ja kufizoi hyrjen dhe daljen nga zonat më të prekura, duke i vënë lagjet dhe komunitat në karantinë bazuar në gjurmimin e kontakteve dhe shkallen e infektimit. Deri në fund të prillit, dhe pas 14 ditësh nga mbyllja e plotë e të gjitha aktiviteteve ekonomike, MSH-ja paraqiti qasjen për heqjen e kufizimeve në mënyrë graduale.¹⁶⁶ Lehtësimi i masave të distancimit social dhe urdhrat për qëndrim në shtëpi ishin planifikuar në tre faza, të cilat u zbatuan gradualisht.¹⁶⁷

Masat qeveritare për kufizimin e aktivitetit ekonomik për disa sektorë, kufizimet në lëvizjen e qytetarëve, kufizimet në qarkullimin ndërkombëtar të mallrave, vendimet për shtyrjen e pagesës së detyrimeve tatimore dhe rënia e kërkesës agregate, rezultuan në rënien e të hyrave në sektorët e prekur. Këto kufizime u reflektuan menjëherë në një rënie të shpejtë të të hyrave nga tatimet dhe doganat. Bazuar në parashikimet, tkurrja kumulative e parashikuar e Kosovës në të hyrat nga taksat vlerësohet në 7.5 deri në 12.5% të buxhetit vjetor.¹⁶⁸ Në varësi të jetëgjatësisë së krizës në vazhdim, në terma monetarë, kjo do të thotë që buxheti publik mund të përfundojë me një hendek prej 200 milionë eurosh ose rreth 10 për qind të buxhetit aktual.¹⁶⁹

Në fund të marsit, Ministria e Financave hartoi një paketë fiskale emergjente për t'u ndihmuar nevojtarëve dhe bizneseve të prekura nga pandemia, e cila u miratua më 30 mars. Si pjesë e saj, deri më 8 maj 2020, fondet u ndanë për:

- a. Një shtesë prej 5.181 milionë eurosh për përfituesit e skemave sociale për dy muaj (100 mijë përfitues të kësaj skeme);
- b. Një shtesë prej 4.880 milionë eurosh për pensione me pagesë mujore deri në 100 euro (me 162.687 përfitues);
- c. 13.7 milionë euro për të subvencionuar pagën prej 170 eurosh për deri në 80,608 të punësuar të sektorit privat të prekur nga vendimet e qeverisë për frenimin e infektiveve;
- d. Një shtesë prej 6.7 milionë eurosh për paga për rreth 21,518 të punësuar të sektorit publik të ekspozuar ndaj rritjes së rrezikut të infektimit afatgjatë gjatë kryerjes së punës së tyre. Në mënyrë të ngjashme, me Paketën Fiskale Emergjente u punësuan 11,633 të punësuar të rinj, ndërsa vetëm 1,459 punëtorë u pushuan nga puna. Atyre iu ofruan 130 euro në muaj si ndihmë financiare.¹⁷⁰

Më 31 maj, qeveria në detyrë njoftoi heqjen e masave për të kufizuar përhapjen e pandemisë, duke përfshirë hapjen e kufijve tokësorë të Kosovës për herë të parë në më shumë se dy muaj.¹⁷¹

164 Po aty;

165 <https://kosovotopointzero.com/en/constitutional-court-decision-shoës-state-of-emergency-is-not-required/>

166 <https://msh.rks-gov.net/sq/adresimi-i-ministrut-arben-vitia-para-mediave-per-masat-e-reja-per-covid-19/>

167 https://klankosova.tv/ep-content/uploads/2020/05/raporti-100-dite-qeverisje-e-mire_shqip.pdf

168 <https://kryeministri-ks.net/miratohet-pakojat-emergjente-fiskale/>

169 Po aty.

170 https://klankosova.tv/ep-content/uploads/2020/05/raporti-100-dite-qeverisje-e-mire_shqip.pdf

171 <https://prishtinainsight.com/coronavirus-measures-lifted-in-kosovo/>

MENAXHIMI I COVID-19 NGA QEVERIA HOTI

Në qershor, IKSHPK-ja njoftoi një rënie të rasteve pozitive COVID-19 duke sinjalizuar se Kosova arriti ta kontrollojë virusin.¹⁷² Por deri në atë kohë, për shkak të krizës të vazhdueshme politike u formua një qeveri e re nga një koalicion i partive opozitare me shumicë të thjeshtë, duke e larguar fituesin e zgjedhjeve të përgjithshme në Kosovë. Fokusi i qeverisë së re në dialogun me Serbinë, ndërmjetësuar nga Trump, e bëri më të paqartë reagimin ndaj pandemisë. Lehtësimi gradual i masave rezultoi në një rritje të shpejtë të rasteve të COVID-19 në Kosovë, por qeveria e re u hezitoi të rivendoste masat më kufizuese të mëparshme, dhe prioritzoi hapjen e ekonomisë.

Në mungesë të një vaksine për COVID-19 ose disa masave të tjera të qëndrueshme për ta kontrolluar virusin, lehtësimi i masave bëri që shumë shpejt të fillonte një përhapje e re e virusit, e ndikuar gjithashtu nga vendimi i qeverisë për të ndaluar gjurmimin e kontakteve. Më 22 qershor, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit u krijua Komisioni Ekzekutiv për Luftimin, Monitorimin dhe Reagimin ndaj virusit SARS-COV-2 me qëllim të informimit dhe këshillimit të qeverisë për situatën e pandemisë¹⁷³ dhe më 12 korrik u thirr një takim tjetër i KSK-së për të shqyrtuar nëse duheshin rivendosur masat e jashtëzakonshme marrë parasysh rritjen e infektiveve.¹⁷⁴ Nga 6 korriku, qeveria rivendosi disa masa kufizuese të tilla si ora policore në katër komuna me numrin më të lartë të rasteve, duke detyruar institucionet publike dhe private të punojnë vetëm me stafin themelor, dhe duke e kufizuar orarin e hapjes për restorantet dhe kafenetë. Masa parandaluese u vendosën edhe për katër komunat veriore: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.¹⁷⁵ Ministrisë së Shëndetësisë iu kërkua të riorganizojë klinikat në kuadër të QKUK-së dhe të miratonte masa për të rritur numrin e personelit shëndetësor si dhe testimet.¹⁷⁶

Pas një proteste nga pronarët e bizneseve të gastronomisë, më 28 korrik, qeveria miratoi një seri tjetër masash që synonin lehtësimin e kufizimeve ndaj COVID-19, përfshirë aktivitetet rekreative, me gjithë një rritje të mprehtë të rasteve.¹⁷⁷ Më 14 gusht, qeveria vendosi t'i hapë kufijtë shtetërorë me vendet fqinje¹⁷⁸ dhe më 25 shtator me kërkesë të MSH-së, qeveria mori një numër vendimesh në lidhje me kufizimet dhe rregulloret e udhëtimit, duke përfshirë testet RT-PCR për shtetas të huaj që hyjnë në Kosovë dhe vetë-izolimim 7 ditor për ata që nuk mund të paraqisnin një test. Ajo gjithashtu ndau fonde për të rimbursuar zyrtarët e Policisë së Kosovës që punojnë jashtë orarit.¹⁷⁹ Pas rritjes në gusht, numri i rasteve pati ulje relative në shtator dhe në fillim të tetorit. Ndërkohë, u rrit numri i shtretërve në objektet shëndetësore dhe u zgjerua furnizimi me oksigjen për trajtimin e këtyre pacientëve.¹⁸⁰ Teksa numri i rasteve COVID-19 arriti në 120 për 100,000 njerëz, MSH-ja dhe IKSHPK-ja rekomanduan masa shtesë, duke e konsideruar situatën epidemiologjike të rëndë dhe me potencial për t'u përkeqësuar.¹⁸¹

Më 13 nëntor, u rivendosën ora policore në disa komuna në varësi të nivelit të tyre të rrezikut (të lartë, të mesëm, të ulët) ndërsa spitalet pothuajse e kapën kapacitetin e plotë.¹⁸² Me rritjen e shfrenuar të rasteve, brenda dy javësh u dyfishuan shtrimet në spital. Megjithatë, nuk u mbyllën qendrat

172 <https://prishtinainsight.com/a-manual-hoë-to-lose-the-battle-ëith-covid-19/>

173 <http://osk-ks.org/themelohet-komisioni-ekzekutiv-per-luftimin-monitorimin-dhe-reagimin-ndaj-sars-cov2-covid-19/2417/>

174 <https://kallxo.com/lajm/hoti-te-dielen-mbledh-komitetin-per-menaxhimin-e-pandemise-dhe-keshillin-e-sigurise/>

175 Po aty.

176 <https://kryeministri-ks.net/qeveria-miratoi-masat-e-reja-per-parandalimin-e-pandemise-covid-19/>

177 <https://kosvotëopointzero.com/en/government-eases-covid-19-restrictions-as-cases-soar/>

178 <https://kryeministri-ks.net/en/the-government-approved-the-decision-for-opening-the-state-border-ëith-neighbour-countries-and-supplementing-the-laë-on-official-holidays/>

179 <https://kryeministri-ks.net/en/government-approves-neë-measures-to-prevent-the-spread-of-covid-19-and-allocates-additional-funds-to-members-of-the-kosovo-police/>


180 Po aty.

181 <https://kryeministri-ks.net/situata-epidemiologjike-me-covid-19-ne-kosove-eshte-serioze/>

182 <https://kosvotëopointzero.com/en/the-government-adopts-neë-anti-covid-19-measures/>

rekreative, restorantet dhe shkollat, por thjesht iu kërkua të kufizojnë kapacitetin e tyre, një vendim që u mirëprit nga entitetet si Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) e cila avokonte për masa për të mos lejuar kolapsin ekonomik. Sipas Bankës Botërore, ekonomia e Kosovës pritet të tkurret me 8.8% gjatë vitit 2020,¹⁸³ ndërsa Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike me vlerë mbi 1.2 miliardë për 24 muaj, u miratua më 4 dhjetor, pas nëntë përpjekjeve të dështuara.¹⁸⁴ Ndër masat e tjera, u lejon kontribuuesve të tërheqin 10% të kursimeve pensionale në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, parashikon krijimin e një fondi të posaçëm për të mbështetur ata që humbën vendet e tyre të punës si rezultat i pandemisë, si dhe masa në mbështetje të bizneseve të prekura.¹⁸⁵

RASTET E COVID-19 NË KOSOVË NË MBIVENDOSJE ME MASAT KYÇE PARANDALUESE TË QEVERISË



SFIDAT NË ZBATIMIN E MASAVE PARANDALUESE

Mungesa e vendosjes së masave parandaluese dhe planifikimit adekuat përgatitor u bënë të dukshme që herët në Kosovë. Zbatimi i masave për të frenuar ndikimin e COVID-19 dhe efektivitetin institucional të reagimit ndaj pandemisë në Kosovë është sfiduar nga disa faktorë. Këto përfshijnë mungesën e qasjes parandaluese dhe përgatitore ndaj situatave emergjente, mungesën e bazës së qartë ligjore për vendimet e qeverisë, kufizimet në resurse dhe kapacitetet e stafit, luhatjet e besimit të publikut në institucione, pretendimet për keqmenaxhim dhe diskriminim, dhe mungesën e një sistemi të qartë, transparent dhe konsistent të komunikimit me publikun.

Siç u theksua nga RSSH-ja, Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Kosovës nuk e pasqyron kontekstin aktual të sigurisë së vendit, një situatë e cila përkeqësohet më tej nga fakti se PRK-ja, i cili është thelbësor për nxitjen e kundërpërgjigjes institucionale në kohë krizash, është i vjetëruar.¹⁸⁶ RSSH-ja paraqiti një numër rekomandimesh për të ndërmarrë një rregullim në kornizën e sigurisë kombëtare për ta përshtatur atë më mirë me ndryshimin e nevojave, mjeteve dhe kontekstit. Rishikimi i RSSH-së kishte treguar edhe që rreziku i një epidemie është një skenar me probabilitet të ulët dhe pasoja të larta i konsideruar në vlerësimin e kërcënimeve dhe rreziqeve.¹⁸⁷ Strategjia

183 <http://pubdocs.eorlbank.org/en/993701492011106034/mpo-ksv.pdf>

184 https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/FEC082F0-53E1-46B9-BC9B-5F23C29920CE.pdf?fbclid=IëAR2c6uVrënmK8ËtMFk-NO-eNLCi4Heol25BQoP_Ydmq-ëc131NTAfh2XVv6Q

185 Po aty.

186 RSSH

187 <http://europeanëesternbalkans.com/2020/04/28/kosovo-ëas-not-adequately-prepared-for-the-pandemic/>

më e fundit për mënyrën si duhet të përballohet një pandemi u miratua shtatë vjet më parë, në 2013, dhe ishte hartuar specifikisht për kërcënimin e atëhershëm nga SARS.¹⁸⁸ Sidoqoftë, duke qenë se rekomandimet e RSSH-së nuk janë zbatuar plotësisht, në përballjen e saj me COVID-19 Kosovës i mungonte një Sistem funksional i Menaxhimit Emergjent (SME) me të gjitha kapacitetet shoqëruese. Vendi kishte aftësi të zvogëluar për të parandaluar, përgatitur, reaguar dhe rimëkëmbur në mënyrë efikase nga një kërcënim madhor ndaj sigurisë së qytetarëve të vet.¹⁸⁹ Ndërhyrja dhe përmirësimet janë me rëndësi kritike edhe në fusha të tilla si krijimi i një qendre operacionale dhe sistemit të komunikimit emergjent.¹⁹⁰ Për shembull, si pjesë e përpjekjeve të koordinimit, MBP kërkoi nga institucionet e përfshira në reagimin emergjent që të caktojnë një pikë kontakti për menaxhimin e pandemisë. Sidoqoftë, për shumë prej këtyre institucioneve një nga sfidat e para ishte mungesa e mjeteve mbrojtëse, çka nuk ishte parashikuar në planin e mëparshëm financiar.¹⁹¹ Kjo u kthye në sfidë posaçërisht për institucionet me numër të madh të të punësuarve, siç është Policia e Kosovës (PK).

PK, një institucion dhe instrument kyç për zbatimin e masave të qeverisë gjatë situatës së pandemisë, raportoi se ishte përballur me sfida të ndryshme gjatë zbatimit të masave kundër COVID-19. Një sfidë kyçe ka qenë mungesa e bazës ligjore për gjatëzimin e qytetarëve që shkelin rregullat e karantinës.¹⁹² Për pasojë, këto shkelje u penalizuan dhe nuk u trajtuan si kundërvajtje.

Kërkesat për të organizuar protesta e sfiduan më tej PK-në, sepse pavarësisht rrezikut nga COVID-19, PK-ja nuk mund t'i ndalonte protestat, një e drejtë e garantuar sipas ligjeve ekzistuese dhe kushtetutës.¹⁹³ Një sfidë tjetër e vërejtur nga PK-ja ishte mungesa e pajisjeve personale mbrojtëse (PPM). Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), i ngarkuar me mbështetjen e zyrtarëve policorë për t'i respektuar standardet demokratike gjatë kryerjes së punës së tyre, në një raport në muajin prill konstatoi se policia kufitare dhe njësitë e patrullimit ishin të pajisura në mënyrë joadekuate me pajisje mbrojtëse dhe në disa raste zyrtarëve u kërkohej t'i blinin vetë këto mjete.¹⁹⁴ Kjo sfidë u adresua përfundimisht me ndihmën e MSH dhe donatorëve. Zyrtarët e PK-së punuan jashtë orarit në shtrirje prej 12 orësh në ditë gjatë karantinës, çka e stërmundoi forcën dhe i shteroi resurset e saj.¹⁹⁵

Sa i përket performancës së saj, PK-ja nuk ishte në gjendje ta monitoronte rregullisht zbatimin e masave të tilla si hyrjet-daljet në komuna që ishin vendosur në karantinë, dhe një nga sfidat ka qenë vështirësia e verifikimit të lejes së qytetarëve për të thyer orën policore.¹⁹⁶ Më tej, sipas një përfaqësuesi të IPK-së,¹⁹⁷ masa të tilla si ruajtja e zonave të karantinës ushtrojnë trysni mbi PK-në, e cila ka mungesë të personelit dhe resurseve të fushës logjistike. Megjithatë IPK-ja nuk raportoi një ndryshim të rëndësishëm në numrin e ankesave kur bëhet fjalë për punën e PK-së, ata vunë re se gjatë pandemisë janë bërë të paktën 8 ankesa kundër zyrtarëve të PK-së për shkelje të pretenduar të të drejtave të qytetarëve, si dhe një rritje të lehtë të rasteve të dhunës në familje me zyrtarë të PK-së si autorë të raportuar.¹⁹⁸ Ka pasur disa raporte për rastet kur zyrtarët e PK-së nuk i respektuan masat anti-COVID, siç është ndalimi i tubimeve publike. Sipas Rashit Qalaj, drejtor i PK-së, këta

188 Po aty

189 Po aty.

190 <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-kosovo-report.pdf>

191 Intervistë me përfaqësues nga Inspektorati Policor i Kosovës, QKSS, gusht 2020.

192 Intervistë e QKSS-së me Rashit Qalaj, ish Drejtori i Policisë së Kosovës, maj 2020.

193 Po aty.

194 <https://ipk.rks-gov.net/ep-content/uploads/2020/07/RAPORTI-I-INSPEKTIMIT-NR.-01-2020-VLER%C3%8BSIMI-I-ANGAZHIMEVE-POLICORE-N%C3%8B-KUADRIN-E-MASAVE-PARANDALUESE-T%C3%8B-AUTORITETEVE-P%C3%8BRGJEGJ%C3%8BSE-N%C3%8B-LUFTIMIN-E-COVID-19.pdf>

195 <https://zeri.info/aktuale/349248/qalaj-skemi-ligj-per-trajtimin-e-rasteve-te-thyerjes-se-masave-kufizuese-gjate-pandemise/>

196 Po aty.

197 Intervistë me përfaqësues të Inspektoratit Policor të Kosovës, QKSS, gusht 2020.

198 Intervistë me përfaqësues të Inspektoratit Policor të Kosovës, QKSS, gusht 2020.

zyrtarë u pezulluan.¹⁹⁹

Pretendimet për keqmenaxhim dhe diskriminim, kryesisht ndaj zyrtarëve shëndetësorë, e minuan më tej menaxhimin e pandemisë. Edhe në mungesë të një situatë të pandemisë, sistemi shëndetësor publik në Kosovë konsiderohet i brishtë dhe përballet me kapacitete të kufizuara, mungesë të resurseve dhe praktika të dobëta të menaxhimit. Në fakt, për shëndetësinë Kosova shpenzon vetëm rreth 8% të buxhetit të saj vjetor, ose rreth 250 milionë euro çdo vit, që është investimi më i ulët për shëndetësinë publike në rajon.²⁰⁰ Mungesa e investimeve të duhura në sektorin shëndetësor dhe neglizhenca ndër vite i kanë lënë institucionet e kujdesit shëndetësor të pajisura në mënyrë joadekuate dhe me furnizime të pakta në medikamente, ndërsa ofruesit privatë të kujdesit shëndetësor ofrojnë shërbime kundrejt kostove të rënda. Në Kosovë kishte vetëm 95 respiratorë të nevojshëm për trajtimin e rasteve më të rënda të COVID-19.²⁰¹ Përveç kësaj, në muajin korrik zyra e prokurorisë nisi hetimet për shqyrtimin e rasteve të vdekjeve të lidhura me COVID-19 pas problemeve me furnizimin me oksigjen në spitalin kryesor të Kosovës.²⁰² Megjithëse testimi është zgjeruar muajt e fundit me licencimin e laboratorëve privatë, për shkak të kostos së tyre të lartë, testimi për publikun e gjerë është ende i kufizuar.²⁰³ Repartet në spitalet në të gjithë vendin janë përdorur për të trajtuar pacientët me COVID-19, duke qenë se Klinika Infektive në Prishtinë arriti limitin, ndonëse këto hapësira nuk i përmbushin standardet për të trajtuar këto raste.²⁰⁴

Sistemi i shëndetësisë publike sfidohet edhe nga kapacitete të kufizuara, të ndikuara edhe nga një trend në rritje i largimit të mjekëve të rinj nga vendi për perspektiva më të mira diku tjetër - zakonisht në Gjermani ose ndonjë vend tjetër evropian.²⁰⁵ Në fillim të pandemisë, IKSHPK-ja e bëri të qartë se Kosova ka mungesë të personelit të specializuar në epidemiologji (gjithsej 22) dhe mikrobiologji (gjithsej 29), sektorë që kanë nevojë për 17 dhe 32 specialistë shtesë, respektivisht.²⁰⁶ Për disa muaj, në IKSHPK kishte vetëm dy mikrobiologë të ngarkuar me kryerjen e testeve për COVID-19, të cilët punonin pa ndërprerje për një periudhë të zgjatur kohe.²⁰⁷ Stafit mjekësor, veçanërisht në njësitë intensive, po përballet edhe me stresin e vazhdueshëm dhe stërmundim duke qenë të mbingarkuar me punë dhe duke u përballur jo vetëm me lodhje fizike por edhe mendore.²⁰⁸ Është e rëndësishme të theksohet se personeli mjekësor u privua edhe nga e drejta e tyre për pushim vjetor për një periudhë kohore.²⁰⁹ Për më tepër, një numër alarmues i stafit mjekësor u infektua nga COVID-19. Që nga fillimi i shtatorit, stafi mjekësor i infektuar përbënte 11 për qind të të gjitha rasteve të regjistruara me COVID-19.²¹⁰ Kontribues për këto raste mund të jenë praktikantët e dobëta të menaxhimit, të tilla si caktimi i personelit që vuan nga sëmundje kronike ose terminale për të trajtuar drejtpërdrejt pacientët me COVID-19, si dhe lejimi i rasteve të konfirmuara me COVID-19 që të vazhdojnë punën.

Në nivelin lokal, komunat e patën të vështirë t'i zbatojnë masat për shkak të varësisë së lartë buxhetore nga niveli qendror, infrastrukturës së dobët të shëndetësisë publike dhe mungesës së pajisjeve mbrojtëse dhe higjienike.²¹¹ Për më tepër, komunat të cilat kanë kapacitete të kufizuara

199 Intervistë me Rashit Qalaj, ish Drejtori i Policisë së Kosovës,

200 https://library.fes.de/pdf-files/bueros/belgrad/10758.pdf?fbclid=IwAR3_T4X5RaeN5JxIO-I9RrepushQGqROJ0VcEREUL3n-11i6Yzx8QCPIjMg

201 <https://kosovotëopointzero.com/en/young-doctors-look-to-leave-kosovo/>

202 Po aty.

203 <https://ëëë.evropaelire.org/a/testimi-per-covid-19-labororet-private-/30775338.html>

204 <https://prishtinainsight.com/covid-19-puts-strain-on-kosovo-health-system/>

205 Po aty.

206 <https://kallxo.com/lajm/ikshpk-perballet-me-mungese-te-epidemiologeve-dhe-mikrobiologeve-ne-kohen-e-pandemise/>

207 <https://kosovotëopointzero.com/en/photostory/kosovos-covid-19-frontline/>

208 <https://prishtinainsight.com/covid-19-puts-strain-on-kosovo-health-system/>

209 <https://kosovapress.com/rritja-e-pandemise-krasnici-pezullon-pushimet-vjetore-per-te-gjithe-personelin-mjekesor/>

210 https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/s_2020_964_e.pdf

211 <https://mapl.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2020/07/Raport-i-situates-se-pandemise-COVID-19-per-komunat-e-Re->

kanë përjetuar sfida të cilat nxiten kryesisht nga vendimet në nivelin qendror, siç janë mungesa e barnave të disponueshme esenciale në institucionet shëndetësore publike, vonesa e vaksinave për gripin sezonal, kujdesi i shtrenjtë mjekësor. Sidoqoftë, për të siguruar mbështetje për qytetarët e tyre, komunat ofruan ndihmë financiare për ata që janë infektuar nga COVID-19.²¹²

Zbatimi i masave kundër COVID-19 në komunat me shumicë serbe në Kosovë paraqiti një tjetër sfidë. Kishte shpërndarje mes sistemit qendror të shëndetësisë dhe strukturave shëndetësore paralele të mbështetura nga Beogradi në komunat me shumicë serbe në Kosovë.²¹³ Në muajt e parë, rastet e COVID-19 në veri nuk u përfshinë në raportet ditore të IKSHPK-së, megjithatë, kjo çështje u adresua pas disa raportimeve në media.²¹⁴ Përkundër mungesës së koordinimit në fazat e hershme të pandemisë, një lloj bashkëpunimi u bë gradualisht.²¹⁵

Ngjashëm me shumë vende në botë, një sfidë tjetër e drejtpërdrejtë ka qenë vështirësia në formësimin e sjelljes publike, duke qenë se qytetarët shpesh i injorojnë masat e thjeshta por shumë efektive parandaluese, siç janë mbajtja e distancimit social dhe mbajtja e maskave. Teksa disa individë mund ta nënvlerësojnë rrezikun e pandemisë ose nuk e kuptojnë rolin e parandalimit, studimet tregojnë se ka individë që hezitojnë ose refuzojnë të mbajnë maska si një akt të qëllimshëm rebelimi, një përpjekje për të ndjerë njëfarë fuqie në një situatë që i bënë të ndihen të pafuqishëm.²¹⁶ Studime të tjera e lidhin hezitimin për mbajtje të maskave me stigmën për t'u përceptuar si të sëmurë.²¹⁷ Për më tepër, ndryshimi i shprehive, edhe pse nuk është i pamundur, mund të jetë i vështirë për disa.

Një numër raportesh kanë vërejtur se respektimi i masave kundër COVID-19 nuk ka qenë konsistent.²¹⁸ Teksa ekziston korrelacion mes mbajtjes së maskave dhe përhapjes së infeksionit COVID-19,²¹⁹ në Kosovë nuk ka të dhëna që tregojnë se sa qytetarë i kanë respektuar këto dhe masa të tjera kundër COVID-19. Në fakt, në përballjen me një virus të ri, për të cilin nuk ka një trajtim të disponueshëm dhe kundër të cilit njerëzit nuk kanë imunitet paraekzistues, një mënyrë kyçe për qeverinë për t'i mbrojtur në mënyrë efektive qytetarët nga njëri tjetri është duke i bindur të marrin masat e nevojshme që ta mbrojnë veten e tyre.²²⁰ Kjo gjë e bënë parakusht besimin mes qeverisë dhe qytetarëve.

Besimi i publikut në institucione është një faktor i rëndësishëm që ndikon në aftësinë/gatishmërinë e qytetarëve të ndjekur vendimet e qeverisë dhe gjithashtu lidhet me aftësinë e qeverisë për t'i komunikuar qartë veprimet dhe politikat e veta. Të dhënat e QKSS-së të mbledhura përmes Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS) tregojnë se gjatë gjithë vitit shumica e të anketuarve kanë pasur më shumë kontakte me komunat (48.4%) dhe institucionet shëndetësore (41.7%), me 55.9% të të anketuarve që i perceptojnë institucionet shëndetësore si shumë të korruptuara.²²¹ Bazuar në pyetjet e hapura, 41% e të anketuarve e kanë renditur Policinë e Kosovës si më të besuar, pasuar nga Forca e Sigurisë së Kosovës (17%), ndërsa 10% e të anketuarve i kanë renditur institucionet shëndetësore si institucionet më të besuara.²²²

[publikes-se-Kosovoes-shqip.pdf](#)

212 <https://prishtinaonline.com/lajmet/3164/aplikimi-per-ndarjen-e-ndihmes-prej-50-euro-per-personat-me-covid19>

213 https://unmik.unmissions.org/sites/default/files/s_2020_964_e.pdf

214 <https://literal.media/Pas-kritikave-te-infektuarit-me-COVID-19-ne-Veri-perfshihen-ne-njoftimet-e-IKSH-P%E2%80%99se/83790>

215 Po aty.

216 <https://ëëë.lamag.com/citythinkblog/ëearing-a-mask-psychology/>

217 Po aty.

218 <https://unmik.unmissions.org/sg-reports>

219 <https://health.clevelandclinic.com/neë-study-highlights-neë-evidence-that-masks-prevent-coronavirus-spread/>

220 <https://ëëë.foreignaffairs.com/articles/united-states/2020-10-23/coronavirus-fighting-requires-trust>

221 Të dhënat e Barometrit Kosovar të Sigurisë, QKSS, 2020

222 Po aty.

Nga ana tjetër, institucionet më pak të besuara, sipas të dhënave të BKS-së, janë Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës, përkatësisht institucioni më pak i besuar në Kosovë është Qeveria, duke gëzuar besimin e vetëm 13% të të anketuarve, ose 70% e të anketuarve nuk kanë besim tek ajo. Pas qeverisë vjen Kuvendi i Kosovës me 16% të të anketuarve që deklaruan se kanë besim në punën e Kuvendit (ndërsa 58 për qind e tyre nuk kanë besim).²²³ Kur u pyetën për perceptimet se si e kanë trajtuar pandeminë institucionet e ndryshme, shumica e të anketuarve e kanë konsideruar punën e PK-së si “të shkëlqyeshme” (30%) ose të mirë (44.2%), pasuar nga puna e institucioneve shëndetësore publike, me 28% prej tyre që e perceptojnë punën e tyre si “të shkëlqyeshme” dhe 39.6% si “të mirë”. Nga ana tjetër, Zyra e Presidentit u perceptua si institucioni që e trajtoi më dobët pandeminë, me 31% të të anketuarve që e renditën punën e këtij institucioni si “shumë të dobët”. Perceptime të ngjashme u raportuan ndaj Kuvendit të Kosovës, me 21.9% që e konsideruan punën e tij për menaxhimin e pandemisë si “shumë të dobët”.

Luhatja e perceptimeve publike nënvizon rëndësinë e komunikimit të qartë me publikun, në mënyrë që, ndër të tjera, të ndihmohet t’i kuptojë gabimet konceptuale. Për shembull, një sfidë e tërthortë që mund të ndikojë në efikasitetin e reagimit është normalizimi i vdekjeve dhe humbja e empatisë. Teksa publiku po përballet me një numër në rritje të vdekjeve të paraqitura në formën e statistikave, ekziston rreziku që nivele të tilla të vdekshmërisë të perceptohen si të pashmangshme. Dhe problemi me normalizimin e vdekjeve është se mund të shpie në më shumë vdekje.²²⁴

PASOJAT POLITIKE TË COVID-19

Siç u përmend në pjesët e mësipërme, pandemia solli pasoja politike për demokracinë dhe institucionet demokratike në Kosovë. Nën pjesët e mëposhtme i shtjellojnë disa nga arsyet që provokuan probleme politike në Kosovë mes krizës së pandemisë COVID-19.

GJENDJA E JASHTËZAKONSHME

Mosmarrëveshjet mes Lëvizjes Vetëvendosje dhe LDK-së u intensifikuan dukshëm pas përpjekjes së ish Presidentit Hashim Thaçi për ta shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në përballje me pandeminë COVID-19,²²⁵ çka u kundërshtua ashpër nga ish Kryeministri Kurti.²²⁶ Kushtetuta e Kosovës përcakton që Presidenti e shpall gjendjen e jashtëzakonshme “pas konsultimit” me Kryeministrin,²²⁷ duke nënkuptuar kështu që gjendja e jashtëzakonshme nuk mund të deklarohet nëse Kryeministri e refuzon këtë. Në këtë drejtim, nuk u shpall gjendja e jashtëzakonshme pasi Presidenti nuk i paraqiti Kuvendit një dekret për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme.²²⁸ Sidoqoftë, inicitiva e Thaçit u mbështet plotësisht nga LDK-ja dhe figurat e saj të profilit të lartë para se të ndodhte mocioni i mosbesimit ndaj qeverisë, përfshirë Ministrin e atëhershëm të Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Agim Velin.²²⁹ Ky i fundit e pranoi publikisht

223 Po aty.

224 <https://eatson.broen.edu/research/2020/ëe-can-t-let-covid-19-deaths-become-normalized>

225 Koha.Net. (2020, 17 mars). *Presidenti propozon gjendjen e jashtëzakonshme për koronavirusin*. Në dispozicion në: <https://ëëë.koha.net/arberi/213711/thaci-i-kerkon-qeverise-ta-therrase-keshillin-e-sigurise/>.

226 Zyra e Kryeministrit. (2020, 18 mars). *Kryeministri Albin Kurti: Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme është e palogjikshme, e panevojshme, e padobishme*. Në dispozicion në: <https://kryeministri-ks.net/en/kryeministri-albin-kurti-shpallja-e-gjendjes-se-jashtezakonshme-eshte-e-paarsyeshme-e-palogjikshme-e-panevojshme-e-padobishme/>.

227 Neni 131, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 9 prill 2008.

228 Vllahu, E., dhe Sopi, A. (2020, 19 mars). *Kuvendi ende nuk e ka pranuar zyrtarisht dekretin e Thaçit*. Në dispozicion në: <https://kallxo.com/lajm/kuvendi-ende-nuk-e-ka-pranuar-zyrtarisht-dekretin-e-thacit/>.

229 Klan Kosova. (2020, 17 mars). *VV dhe LDK me qëndrime të kundërta për propozimin e Thaçit për Gjendje të Jashtëzakonshme*. Në dispozicion në: <https://klankosova.tv/vv-dhe-ldk-me-qendrime-te-kunderta-per-propozimin-e-thacit-per-gjendje-te-jashtezakonshme>

se duhej të shpallej gjendja e jashtëzakonshme duke qenë se në Kosovë numri i rasteve të konfirmuara me sëmundjen e pandemisë COVID-19 “po rritet çdo orë.”²³⁰ Pas deklaratës së tij mbi këtë çështje, ministri u shkarkua nga Kryeministri Kurti për pozicionimin e tij kundër qeverisë si dhe për ekzagjerimin publik të numrit të qytetarëve të infektuar.²³¹

Përkundër kësaj, LDK-ja nuk ishte dakord me lëvizjen e Kurtit për ta shkarkuar Veliun (i cili është gjithashtu një nga nënkryetarët më me ndikim në LDK) dhe për pasojë ndërmori iniciativën për një mocion mosbesimi në Kuvend, çka çoi në shkarkimin e qeverisë.²³² Edhe kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, e mbështeti shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, duke i dhënë një goditje përpjekjeve të Kurtit dhe duke e minuar koalicionin qeverisës.²³³ Mosmarrëveshja për gjendjen e jashtëzakonshme shkaktoi një situatë të tensionuar dhe e polarizoi skenën politike në Kosovë. Përveç kësaj, Presidenti Thaçi i kundërshtoi haptazi masat mbrojtëse dhe parandaluese të ndërmarra nga qeveria për të trajtuar situatën me pandeminë COVID-19, të cilat bartnin kufizime ndaj lirisë së lëvizjes.²³⁴ Për më tepër, Thaçi deklaroi se qytetarët e Kosovës, PK, dhe institucionet e tjera të lidhura me sigurinë, nuk duhej t’i respektonin dhe as t’i zbatonin vendimet e Qeverisë së Kosovës në lidhje me masat kufizuese ndaj lirisë së lëvizjes, dhe i quajti ato antikushtetuese.²³⁵ Përfundimisht, Thaçi i kundërshtoi vendimet e qeverisë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike e paditi Thaçin për thirrjen e tij drejtuar publikut që të mos t’u bindej kufizimeve të qeverisë.²³⁶

DIALOGU KOSOVË-SERBI

Ngjarjet në lidhje me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë konsiderohen si faktorë kyç që e rrëzuan qeverinë Kurti. Kritikët pretendojnë se rënia e qeverisë së Kurti erdhi për shkak të presionit të drejtpërdrejtë të ushtruar nga i Dërguari i Posaçëm i Presidentit të Shteteve të Bashkuara për Negociatat e Paqes mes Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, i cili në mënyrë të përsëritur i kërkoi Kurtit t’i hiqte plotësisht tarifatat për mallrat që hynin në Kosovë nga Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina, si dhe të mos zbatonte masa reciprociteti kundër Serbisë, në mënyrë që të rifillonte dialogu,²³⁷ siç kërkohet nga Serbia në këmbim të pjesëmarrjes në proces. Sidoqoftë, për dallim nga kërkesa që Kosova të ndërmarrë këto hapa politikë, Kurti në anën tjetër e kritikoi të dërguarin e SHBA-së që nuk kishte aplikuar të njëjtën politikë ndaj Serbisë për ndalimin e fushatës së heqjes së njohjes kundër shtetësisë së Kosovës dhe njohjes ndërkombëtare.²³⁸

Ndërkohë, Presidenti Thaçi dhe ish partneri i koalicionit qeveritar, LDK-ja, u bënë gati t’i heqin tarifatat e Kosovës për ta rikthyer me shpejtësi dialogun me Serbinë nën ndërmjetësimin e Shteteve të Bashkuara pas formimit të qeverisë në shkurt 2020.²³⁹ Kurti tregoi hezitim për të lëvizur në favor të kërkesës së Grenell për shkak të pretendimit të tij se politika e jashtme e SHBA dhe i dërguari

230 Po aty.

231 Zyra e Kryeministrit. (2020, 18 mars). *Kryeministri Kurti shkarkon Ministrin Veliu*.

232 Koha.Net. (2020, 20 mars). *LDK: Kurti nuk reflektoi, sot dorëzuar kërkesën për mocion mosbesimi me 46 nënshkrime*. Në dispozicion në: <https://ëëë.koha.net/arberi/214182/ldk-kurti-nuk-reflektoi-sot-dorezuam-kerkesen-per-mocion-mosbesimi-me-46-nenshkrime/>.

233 Radio Evropa e Lirë. (2020, 17 mars). *Isa Mustafa kërkon shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme*. Në dispozicion në: <https://ëëë.evropaelire.org/a/30493144.html>.

234 Vendim i Qeverisë së Kosovës, Nr. 01/15, 23.03.2020.

235 Koha.Net. (2020, 23 mars). *Thaçi: Kurti shkeli Kushtetutën - qytetarët s’janë të obliguar të respektojnë këtë vendim*. Në dispozicion në: <https://ëëë.koha.net/arberi/214575/thaci-kurti-shkeli-kushtetuten-ne-menyre-flagrante/>.

236 Ramaj, S. (2020, 31 mars). Për “thirrjen për rezistencë” Thaçi mund të dënohet me 5 vjet burgim. *Koha Ditore*, fq. 5.

237 Prishtina Insight. (2020, 2 shkurt). *Reagime të përziera ndaj planeve tarifore të Kurtit*. Në dispozicion në: <https://prishtinain-sight.com/mixed-reactions-to-kurtis-tariff-plans/>.

238 Mackinnon, Amy. (2020, 23 prill). *Në Ballkan, nëse e neglizhon historinë, do të përplasesh me pasojat*. Në dispozicion në: <https://foreignpolicy.com/2020/04/23/balkans-kosovo-serbia-albin-kurti-richard-grenell/>.

239 Kumnova, Kestrin. (2020, 25 mars). *Bashkimi dhe ndarja e LVV- LDK*. Në dispozicion në: <https://ëëë.evropaelire.org/a/bashkim-ndarje-lvv-ldk-/30509570.html>.

i Presidentit Donald Trump po kërkonin një marrëveshje të shpejtë përfundimtare Kosovë-Serbi në prag të zgjedhjeve presidenciale në SHBA.²⁴⁰ Për më tepër, Kryeministri në detyrë i Kosovës la të kuptohet se Grenell po ndërhynte në politikën e brendshme për ta shkarkuar qeverinë duke e shtyrë LDK-në që të inicioje mocionin e mosbesimit.²⁴¹ Kurti ngrii shqetësime se marrëveshja përfundimtare për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë e ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara mundej potencialisht të nënkuptonte shkëmbime territore, veçanërisht ndarje të komunave veriore të mbizotëruara nga serbët e Kosovës,²⁴² një pretendim i mohuar me forcë nga zyrtarët e lartë të SHBA.²⁴³ Bashkimi Evropian, si lehtësuesi zyrtar i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, ishte pozicionuar së fundmi kundër shkëmbimit të territoreve. Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë, Joseph Borrell, deklaroi se ideja mund të ketë një efekt domino në rajon dhe se BE-ja do të preferonte të ruante situatën aktuale kur bëhet fjalë për çështjet e kufirit.²⁴⁴ Sidoqoftë, kryediplomati i Bashkimit Evropian më herët ishte mjaft i paqartë në lidhje me një marrëveshje të mundshme përfundimtare që do të çonte në shkëmbimet e territoreve.²⁴⁵

Përfaqësuesi i Posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë-Serbi, Miroslav Lajčák, ka deklaruar se ideja e shkëmbimit të territoreve nuk është dhe nuk duhet të jetë në agjendën e dialogut.²⁴⁶ Nga ana tjetër, qeveria në detyrë e Kosovës i hoqi tarifat kundër Serbisë dhe Bosnjë-Hercegovinës, por vendosi disa masa reciprociteti ndaj Serbisë,²⁴⁷ megjithatë kjo e fundit nuk e ka ndaluar ende fushatën e saj kundër njohjes ndërkombëtare të Kosovës. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese shpalli se dekreti i Thaçit për mandatin e të nominuarit të LDK-së për zgjedhjen e një qeverie të re është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Kosovës.²⁴⁸ Gjykata vendosi që një mocion i suksesshëm mosbesimi "nuk rezulton në shpërndarje të detyrueshme të Kuvendit", duke refuzuar kështu kërkesën e Lëvizjes Vetëvendosje për shpërbërjen e Kuvendit për organizimin e zgjedhjeve të reja të parakohshme parlamentare në Kosovë.²⁴⁹ Përveç Kurtit, i cili theksoi se vendimi i gjykatës është i padrejtë dhe i papranueshëm,²⁵⁰ Presidenti Thaçi²⁵¹ dhe partitë e tjera politike bënë thirrje për respektim të vendimit të Gjykatës. Megjithatë Kryeministri në largim bëri thirrje për zgjedhje të reja legjislative, pandemia bëri që të

240 Ëalker, Shaun. (2020, 20 prill). *Kryeministri në detyrë i Kosovës akuzon të dërguarin e Trumpit për ndërhyrje*. Në dispozicion në: https://ëëë.theguardian.com/ëorld/2020/apr/20/kosovan-acting-pm-accuses-trump-envoy-of-meddling?CMP=share_btn_të.

241 Semini, Ll. (2020, 20 prill). *Kryeministri i Kosovës e akuzon të dërguarin e SHBA për përfshije në rrëzimin e qeverisë së tij*. Në dispozicion në: <https://apneës.com/0d9243a8a85b0e411b727e46b7ea6c25>.

242 Ëalker, Shaun. (2020, 20 prill). *Kryeministri në detyrë i Kosovës akuzon të dërguarin e Trumpit për ndërhyrje*. Në dispozicion në: https://ëëë.theguardian.com/ëorld/2020/apr/20/kosovan-acting-pm-accuses-trump-envoy-of-meddling?CMP=share_btn_të.

243 Departamenti i Shtetit i SHBA-ve. (2020, 26 mars). *Deklarata e Përbashkët për Kosovën e të Dërguarit të Posaçëm të Presidentit, Richard Grenell, Ambasadorit Philip Kosnett dhe Përfaqësuesit të Posaçëm për Ballkanin Perëndimor Mattheë Palmer*. Në dispozicion në: https://ëëë.state.gov/joint-statement-of-special-presidential-envoy-richard-grenell-ambassador-philip-kosnett-and-special-representative-for-the-ëestern-balkans-mattheë-palmer-on-kosovo/?fbclid=IëAR1zTëq5q8FgxQëisXnKF9_ae-tRjUVv5vaU9cdkjoM22i4XnziTs5ax7-ns.

244 Radio Evropa e Lirë. (2020, 29 maj). *Borrell: BE-ja preferon gjendjen e tanishme të kufijve midis Kosovës dhe Serbisë*. Në dispozicion në: <https://ëëë.evropaelire.org/a/be-dhe-ideja-e-shkëmbimit-te-territoreve/30642285.html>.

245 Palokaj, A. (2020, 5 maj). *Borrell nuk është kundër ndryshimit të kufijve të Kosovës*. Në dispozicion në: <https://ëëë.koha.net/arberi/220523/borrell-nuk-eshte-kunder-ndryshimit-te-kufijve-te-kosoves/>.

246 Koha.Net. (2020, 11 maj). *Lajçak: Shkëmbimi i territoreve nuk do të jetë në rend dite në dialogun Kosovë-Serbi*. Në dispozicion në: <https://ëëë.koha.net/arberi/221391/lajcak-shkëmbimi-i-territoreve-nuk-do-te-jete-ne-rend-dite-ne-dialogun-kosove-serbi/>.

247 Vendim i Qeverisë së Kosovës për zbatimin gradual të reciprocitetit si parim në marrëdhëniet me Serbinë, Nr. 01/20, 31.03.2020. Në dispozicion në: <https://kryeministri-ks.net/ëp-content/uploads/2020/04/Vendim-i-mbledhjes-s%C3%AB-20-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB.pdf>

248 Gjykata Kushtetuese e Kosovës. (2020, 28 maj). *Vendimet nga seanca shqyrtuese e mbajtur më 28 maj 2020*. Në dispozicion në: <https://gjk-ks.org/en/decisions-from-the-revieë-session-held-on-28-may-2020/>.

249 Po aty.

250 Koha.Net. (2020, 29 maj). *Kurti nuk e pranon vendimin e Kushtetueses për dekretin e Thaçit*. Në dispozicion në: <https://ëëë.koha.net/arberi/223741/kurti-si-i-padrejte-vendimi-i-kushtetueses-eshte-i-papranueshem/>.

251 Koha.Net. (2020, 29 maj). *Thaçi kërkon respektim të vendimit të Kushtetueses e formim të shpejtë të qeverisë së re*. Në dispozicion në: <https://ëëë.koha.net/arberi/223733/thaci-ben-thirrje-per-respektim-te-vendimit-te-kushtetueses-kerkon-formimin-e-shpejte-te-qeverise-se-re/>.

kishte pak gjasa për zgjedhje të reja.²⁵² Zinxhiri i zhvillimeve politike që ndodhën gjatë pandemisë solli një qeveri të re më 3 qershor, të udhëhequr nga Avdullah Hoti i LDK-së. Sidoqoftë, përveç udhëheqjes së vendit në një kohë krize të pashembullt dhe mes një kompleksi sfidash ekonomike, politike dhe sociale, qeveria e re u përball edhe me një krizë legjitimiteti.²⁵³ Ndërkohë, pandemia mori një kthesë dramatike në Kosovë,²⁵⁴ duke dhënë përshtypjen se lufta për pushtet mes partive politike e vë drejtpërdrejt në rrezik shëndetin e publikut të Kosovës. Kjo grindje ilustron më tej nga vështirësitë që hasi qeveria për miratimin e Paketës aq të nevojshme të Rimëkëmbjes Ekonomike, e cila u votua nga Kuvendi pas gjashtë përpjekjeve të dështuara.²⁵⁵

IMPLIKIMET NDAJ SUNDIMIT TË LIGJIT DHE SIGURISË

Përhapja e COVID-19 i ka përkeqësuar sfidat ekzistuese dhe ka sjellë sfida të reja, përfshirë ato që paraqesin kërcënim për sigurinë e qytetarëve në Kosovë. Masat e karantinës bënë që shumë individë t'u drejtoheshin platformave digjitale për punë ose studime. Sidoqoftë, teksa gjatë pandemisë njerëzit filluan të kalonin më shumë kohë në internet, u vërejtë edhe një rritje të krimeve kibernetike.²⁵⁶ Kriminelët janë përpjekur t'i shfrytëzojnë cenueshmëritë dhe të përfitojnë duke kryer aktivitetet e tyre të paligjshme online.²⁵⁷ Shumë institucione, kompani dhe organizata po përballen me sfidën e përcaktimit të praktikave të reja të punës në distancë, duke mbetur të cenueshëm ndaj skemave të ndryshme të mashtrimit online. Sipas PK-së, që nga fillimi i pandemisë, ka pasur një rritje të dukshme të profileve të rreme në mediat sociale, përmes të cilave kriminelët kibernetikë kanë përhapur dezinformata dhe lajme të rreme.²⁵⁸ Edhe hakimet dhe vjedhja e identitetit janë rritur. PK-ja ka identifikuar kërcënime kibernetike siç janë ransomware, mashtrime të bizneseve dhe mashtrime përmes ueb faqeve ose platformave të rrjeteve sociale.²⁵⁹ Në raste të tilla, kriminelët kibernetikë i nxisin individët të bëjnë blerje online dhe vjedhin të dhënat e tyre personale dhe i përdorin ato në tregjet e uebit të errët.²⁶⁰

Përhapja e dezinformimit në sferën online është ndoshta një nga sfidat kryesore të sigurisë që u ndikua nga pandemia, jo vetëm në nivel global, por edhe në një nivel rajonal dhe kombëtar. Mbingarkimi i informacionit që ndodh gjatë një epidemie shpesh quhet "info-demi", duke iu referuar edhe përpjekjeve të qëllimshme për shpërndarjen e informacionit të gabuar për të minuar reagimin e shëndetësisë publike dhe për të avancuar agjendat alternative të grupeve ose individëve.²⁶¹ Në mesin e krizës së pandemisë, kur kërkesa për informacion është e lartë, dezinformimi mund të jetë i dëmshëm për shëndetin fizik dhe mendor të njerëzve, duke rritur stigmatizimin, duke kërcënuar suksesin e masave shëndetësore, dhe duke ulur kështu aftësinë e vendeve për ta frenuar ose ndaluar pandeminë.²⁶² Për më tepër, dezinformimi mund të jetë vdekjeprurës, pasi që individët e keqinformuar kanë më pak gjasa të përdorin teste diagnostike ose t'i respektojnë masat e

252 <https://ëëë.atlanticcouncil.org/blogs/neë-atlanticist/covid-19-in-the-ëëstern-balkans/>

253 <https://link.springer.com/article/10.1007/s42597-020-00046-ë>

254 Po aty.

255 <https://prishtinainsight.com/economic-recovery-package-passes-at-kosovo-assembly/>

256 Policia e Kosovës, "Mbrotjtja nga mashtrimet - Pandemia Covid-19", 31 mars 2020, qasur përmes <https://ëëë.kosovopolice.com/>

257 Po aty.

258 Po aty.

259 Po aty.

260 Po aty.

261 <https://ëëë.ëho.int/neës/item/23-09-2020-managing-the-covid-19-infodemic-promoting-healthy-behaviours-and-mitigating-the-harm-from-misinformation-and-disinformation>

262 Po aty.

tjera të shëndetit publik që janë të nevojshme për të shpëtuar jetë.²⁶³ Më e rëndësishmja është se dezinformimi kontribuon në polarizimin e debatit publik mbi temat që lidhen me COVID-19, duke amplifikuar gjuhën e urrejtjes, duke rritur rrezikun e dhunës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut dhe duke kërcënuar perspektiva afatgjata për avancimin e demokracisë, të drejtave të njeriut dhe kohezionit social.²⁶⁴

Studime të shumta kanë paralajmëruar se dezinformimi është një kërcënim në zhvillim që kërkon të minojë besimin e publikut në qeveritë dhe kohezionin social në rajon, i cili duket se është përkeqësuar më tej gjatë pandemisë COVID-19.²⁶⁵ Që kur u shfaqën raportet e para mbi rastet e COVID-19, filluan të qarkullojnë lloje të ndryshme të dezinformimit, veçanërisht në rrjetet sociale, të cilat në Kosovë vlerësohen si një nga burimet kryesore të informacionit, por edhe një burim kryesor i dezinformimit.²⁶⁶ Përhapja e dezinformimit rreth COVID-19, si p.sh. në formën e trajtimeve të rreme kundër COVID-19, e nxitën edhe MSH-në që të reagojë.²⁶⁷ Nivelet e ulëta të njohurive mediatike kontribuuan në faktin që njerëzit përhapin dezinformim duke mos qenë të vetëdijshëm se buronte nga burime të paverifikuara.²⁶⁸

Një anketë e kohëve të fundit në Kosovë zbuloi se një e treta e popullsisë nuk besonte se virusi ishte i vërtetë, ndërsa 61 % thanë që COVID-19 ishte "më pak i rrezikshëm nga sa përshkruhej."²⁶⁹ Një anketë tjetër më e fundit tregoi se pothuajse 50% e të anketuarve në Kosovë thanë se "e besojnë shumë çdo teori konspirative" ndërsa pak më shumë se 70% thanë se "u besojnë shumë ose disa teorive konspirative".²⁷⁰ Komuniteti më i prirur për teori konspirative në Kosovë janë serbët e Kosovës, të cilët bazuar në këtë studim shfaqën edhe rezistencën më të madhe ndaj vaksinimit: 89.6% e të anketuarve i refuzojnë vaksinat.²⁷¹

Anketa e BKS-së e realizuar nga QKSS-ja tregoi se shumica e të anketuarve (66.9%) renditën papunësinë si një kërcënim të lartë, pasuar nga korrupsioni (56.36%), krimi i organizuar (53.80%), ndërsa për 28% të të anketuarve pandemia paraqet kërcënimin më të lartë. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se kur bëhet fjalë për perceptimet ndaj krizës së pandemisë, rol mund të ketë luajtur edhe koha kur u bë pyetësori, varësisht nga fakti nëse vendi po përballej me një numër relativisht të ulët të rasteve apo rastet kishin arritur majat. Rëndësi ka që 33.83% e të anketuarve treguan se kishin dyshime për ekzistencën e pandemisë COVID-19, dhe kjo ishte pak më e përhapur në mesin e të anketuarve serbë të Kosovës. Ky nivel skepticizmi sigurisht që e bën të vështirë zbatimin me efikasitet të masave për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe përbën një kërcënim serioz për shëndetin publik.

Një trend tjetër shqetësues që e ka kërcënuar sigurinë e qytetarëve gjatë pandemisë, ka qenë rritja e numrit të rasteve të dhunës në familje. Sipas Rashit Qalaj, ish drejtor i PK-së, edhe pse gjatë pandemisë pati një rënie të kriminalitetit, rastet e raportuara të dhunës në familje pësuan rritje.²⁷² Konkretisht, ka pasur një rritje prej 20 deri në 25 për qind të raportimit nga viti 2018 në vitin 2020, në krahasim me vitet e mëparshme.²⁷³ Në shumicën e rasteve, dhuna ushtrohej mbi gratë, fëmijët dhe

263 Po aty.

264 Po aty.

265 [https://ëëë.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU\(2020\)653621_EN.pdf](https://ëëë.europarl.europa.eu/RegData/etudes/STUD/2020/653621/EXPO_STU(2020)653621_EN.pdf)

266 <https://en.ejo.ch/ethics-quality/kosovo-coronavirus-and-the-media?fbclid=IëAR1sZRzX3jRChCvËëyekNg-d9iVvvRbbnkQDGy2nj2e7ABuvfLyGkIiUP-M>

267 <https://ëëë.koha.net/arberi/230142/msh-ja-rreth-recetave-mos-bini-pre-e-lajmeve-te-tilla/>

268 <https://digicomnet.org/disinformation-kosovo>

269 <https://ëëë.france24.com/en/20200911-as-hospitals-fill-kosovo-battles-plague-of-virus-deniers>

270 <https://biepag.eu/ëp-content/uploads/2020/12/Conspiracies-and-COVID19-in-the-Balkan-English-2.pdf>

271 Po aty.

272 <https://telegrafi.com/faktoret-e-rritjes-se-dhunes-ne-familje-gjate-pandemise-covid-19/>

273 <https://prishtinainsight.com/pandemic-lays-bare-the-flaës-in-kosovos-domestic-violence-response/>

të moshuarit.²⁷⁴ Teksa masat e karantinës kishin si qëllim parandalimin e infektiveve dhe mbrojtjen e jetëve të qytetarëve, në shumë raste kjo nënkuptonte se viktimat e dhunës në familje ishin mbyllur brenda me abuzuesit e tyre. Për pasojë, u shfaq “një pandemi brenda pandemisë”, një trend që është në përputhje me të dhënat për numrin në rritje të rasteve të dhunës në familje në nivelin global. Sfidat në adresimin e këtyre rasteve përfshijnë fajësimin e viktimave, mungesën e reagimit të policisë, normat patriarkale të ngulitura në sistemin institucional, pengesat ndaj raportimit, duke përfshirë stigmatizimin nga anëtarët e familjes dhe komunitetit, ose mungesën e garancive për raportimin e sigurt.²⁷⁵ Andaj, janë bërë thirrje që institucionet ta marrin seriozisht parandalimin e dhunës dhe të mos ta përdorin krizën aktuale si justifikim për çdo rritje, meqenëse pandemia mund të jetë shkas, por fajtorët janë kryesit.²⁷⁶

Pandemia COVID-19 i ka minuar edhe përpjekjet për sundimin e ligjit, veçanërisht kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ka pasur sfida të dukshme logjistike për shkak të COVID-19, të cilat kanë shkaktuar vonesa të konsiderueshme dhe kanë rritur numrin e lëndëve të prapambetura, duke përfshirë disa lëndë të profilit të lartë. Gjatë vitin 2020 nuk janë mbajtur një numër i konsiderueshëm i seancave gjyqësore për shkak të mungesës së hapësirave për mbajtjen e seancave në përputhje me masat kundër COVID-19, dhe sfidave të lidhura me mungesën e pajisjeve mbrojtëse kundër COVID-19.²⁷⁷ Që kur u vendosën masat e karantinës, gjykatat dhe prokuroria i pezulluan aktivitetet e tyre, duke u marrë vetëm me raste urgjente, siç janë rastet e të miturve, dhuna në familje, vërtetimi i paraburgimit,²⁷⁸ kanë punuar me numër të reduktuar të stafit, kanë mbajtur seanca pa praninë e publikut, dhe i kanë zhvilluar takimet online aty ku është e mundur.²⁷⁹ Megjithatë, kritikët vërejnë se pandemia nuk duhet të përdoret si justifikim për mungesën e rezultateve në frontin e luftës kundër korrupsionit, veçanërisht pasi prirja në rënie është e lidhur me imunitetin sistematik të dëshmuar në të gjithë zinxhirët e ndryshëm në prokurori dhe procese gjyqësore.²⁸⁰ Indeksi i Perceptimeve Kundër Korrupsionit nga Transparency International tregoi se renditja e Kosovës kishte rënë nga vendi i 93-të be vendin 101 në renditjen ndërkombëtare - duke treguar se publiku ka perceptuar se janë përkeqësuar përpjekjet e Kosovës për luftimin e korrupsionit në sektorin publik.²⁸¹

Në vitin 2020 ka pasur dy aktgjykime dënuese të profilit të lartë, njëri në lidhje me keqpërdorimin e fondeve në emër të “Fondit 3%” të formuar nga kontributet e diasporës shqiptare gjatë viteve 90-të, dhe tjetri për lëndën “Ferronikeli”, që përfshin ish kryetarin e komunës së Lipjanit në akuzat për ryshfet dhe ushtrimin e ndikimit.²⁸² Sidoqoftë, këto dënime janë apeluar.²⁸³ Ekspertët e kanë quajtur vitin 2020 si një ‘vit të humbur’ në luftën kundër korrupsionit, duke theksuar se gjyqësori në vitin 2020 ka përjetuar regresin më të thellë që nga viti 2015.²⁸⁴ Më tej, gjatë vlerësimit të ndikimit të COVID-19 në punën e institucioneve gjyqësore, ekspertët vërejnë se pandemia dhe përpjekjet për reagim nuk e shfajësojnë sistemin për mungesën e vullnetit dhe guximit për t’i ndjekur penalisht rastet e korrupsionit, madje edhe ato që përfshijnë zyrtarë të nivelit të lartë.²⁸⁵

274 Po aty.

275 <https://peacekeeping.un.org/en/security-and-gender-group-calls-prevention-of-domestic-violence-amid-covid-19-pandemic>

276 <https://prishtinainsight.com/pandemic-lays-bare-the-flaës-in-kosovos-domestic-violence-response/>

277 Saranda Ramaj, “Beteja e humbur kundër korrupsionit”, p.4, Koha Ditore, 13 dhjetor, 2020

278 <https://crd.org/2020/05/26/impact-of-covid-19-measures-on-human-rights-and-criminal-justice-in-ëestern-balkans-and-turkey/>

279 <https://kallxo.com/gjate/funksionimi-i-gjyqesorit-ne-kohe-pandemie/>

280 Po aty.

281 Transparency International, “Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit”, qasur përmes <https://ëëë.transparency.org/en/cpi/2019/results/table>

282 Saranda Ramaj, “Beteja e humbur kundër korrupsionit”, p.4, Koha Ditore, 13 dhjetor, 2020.

283 Po aty.

284 Saranda Ramaj, “Miftaraj: Drejtësia në 2020-n ka shënuar regresin më të madh që nga 2015-a”, Koha Ditore, 13 dhjetor, 2020.

285 Po aty.

IMPLIKIMET SOCIO-EKONOMIKE DHE NDIKIMI NË TË DREJTAT E NJERIUT DHE LIRITË CIVILE

Përhapja e pandemisë COVID-19 ka sjellë pasoja të dukshme sociale dhe ekonomike në Kosovë. Ka rritur papunësinë, pabarazitë sociale, dhe ka përkeqësuar shëndetin fizik dhe mendor të publikut. Për më tepër, pandemia ka vënë në rrezik mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive civile, të cilat janë thelbësore për një demokraci funksionale. Këto efekte janë ndjerë veçanërisht në mesin e grupeve të marginalizuara, të cilët janë privuar nga mundësi të ndryshme, përfshirë qasje në shërbimet e duhura shëndetësore publike, ose janë përballur me nivele më të larta të diskriminimit.

Kriza e COVID-19 ka ushtruar trysni të pashembullt mbi ekonominë e Kosovës, e cila ka pësuar rënie dhe sipas vlerësimeve të Bankës Botërore pritet të tkurret rreth 8.8%.²⁸⁶ Kriza e pandemisë ekspozoi brishtësinë e modelit të rritjes së bazuar në konsum të Kosovës, por gjithashtu konfirmoi rolin domethënës që luajnë remitanecat gjatë këtyre kohërave të vështira, me Kosovën që është vendi i vetëm në rajon me rritje të remitanecave.²⁸⁷ Edhe para pandemisë, Kosova ka pasur numrin më të lartë të papunësisë në rajon, ndërsa katër muaj pas fillimit të pandemisë për beneficionet e papunësisë janë regjistruar mbi 37,000 persona, gati gjysma e të cilëve (16,820) janë gra, kurse numri i punëkërkesve u shumëfishua 40 herë.²⁸⁸ Tek ata që u preken më shumë nga papunësia përfshihen persona me aftësi të kufizuara, punëtorë të pakualifikuar, gra, të rinj që sapo kanë dalë nga shkolla, dhe anëtarë të pakicave etnike.²⁸⁹

Vlerësimi i implikimeve socio-ekonomike për grupet e pafavorizuara, si komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, është veçanërisht i vështirë pasi që shumica e tyre janë të përjashtuar nga aktivitetet ekonomike. Pa regjistrim zyrtar në qendrat e punësimit, ata e kanë të vështirë që të përfitojnë nga Pakoja Fiskale Emergjente e qeverisë.²⁹⁰ Veçanërisht, gjatë COVID-19 anëtarët e këtyre komuniteteve kanë pasur qasje të kufizuar në testime dhe arsimim. Për shembull, deri në qershor, nga 1600 të testuar në Ferizaj, vetëm dy prej tyre ishin anëtarë të komunitetit ashkali, ndërsa në komunën e Ferizaj, mbi 50% e nxënësve romë, ashkali dhe egjiptas nuk e ndoqën mësimin në distancë, duke i rritur potencialisht normat e braktisjeve.²⁹¹ Shqetësuese është se as MSH-ja dhe as IKSHPK-ja nuk kanë të dhëna për personat e prekur nga këto komunitete. Edhe UNICEF-i ka paralajmëruar për pasojat afatgjata mbi fëmijët për shkak të mbylljes së shkollave.²⁹² Duhet të theksohet se ndikimi i krizave ka tendencë të jetë gjinor, dhe teksa raportohet se burrat kanë një normë më të lartë të fatalitetit nga COVID-19, gratë dhe vajzat janë veçanërisht të dëmtuara nga implikimet ekonomike dhe sociale.²⁹³ Për shembull, meqenëse gratë janë përballur në mënyrë disproporcionale me ngarkesa më të larta të kujdestarisë, punës së papaguar dhe punës në shtëpi, ka studime që paralajmërojnë prapambetje në përparimet e arritura ndër vite në fushën e barazisë gjinore.²⁹⁴

Azilkërkesit në Kosovë paraqesin një kategori tjetër të grupeve të prekur negativisht nga situata e pandemisë. Me shpalljen e emergjencës shëndetësore nga qeveria, u mbyllën të gjitha pikat e kalimit kufitar, por vazhduan të ndodhin lëvizje të parregullta, duke ndikuar që shumë azilkërkes të

286 <https://ëëë.eorlbank.org/en/neës/press-release/2020/10/22/recession-deepens-as-covid-19-pandemic-threatens-jobs-and-poverty-reduction-in-kosovo>

287 <https://ëëë.eorlbank.org/en/neës/press-release/2020/10/22/recession-deepens-as-covid-19-pandemic-threatens-jobs-and-poverty-reduction-in-kosovo>

288 <https://ëëë.institutigap.org/neës/2558>

289 <https://kosovotëopointzero.com/en/jobless-in-the-pandemic/>

290 <https://kosovotëopointzero.com/en/the-pandemic-ëorsens-conditions-in-roma-ashkali-and-egyptian-communities/>

291 Po aty.

292 <https://ëëë.nytimes.com/2020/11/19/ëorld/unicëf-ëarns-of-a-lost-generation-and-finds-school-closures-are-ineffective.html>

293 <://reliefëeb.int/report/ëorld/insights-action-gender-equality-ëake-covid-19>

294 Po aty.

mbesin praktikisht të bllokuar në Kosovë. Edhe pse Kosova ka një qendër kryesore të azilkërkuesve dhe disa mjedise shtesë akomodimi, aktualisht ato janë të mbipopulluara për shkak të rritjes së numrit të azilkërkuesve të pranishëm në Kosovë. Sidoqoftë, shumica e tyre nuk janë të gatshëm të regjistrohen si azilkërkues në Kosovë, pasi qëllimi i tyre është ta përdorin Kosovën vetëm si vend tranziti. Sipas raporteve të mediave, edhe pse Kosova ka siguruar ushqim dhe strehim për azilkërkuesit në qendra, ka edhe të tjerë që po flenë jashtë kampit, në shtëpi të braktisura ose në ambiente të tjera në kushte shumë të këqija, duke mos pasur ushqim dhe veshmbathje.²⁹⁵ Disa prej tyre kanë kryer vepra penale të tilla si vjedhja e njerëzve në rrugë, vjedhja në qendrat tregtare, shkatërrimi i makinave dhe pronave të tjera etj.²⁹⁶ Kohët e fundit, siç u raportua, disa prej tyre i vunë flakën qendrës së azilit të vendosur në Vranidoll.²⁹⁷ Përveç kësaj, u dogj edhe xhamia e vjetër në fshatin Magure ku është vendosur qendra kryesore e azilit.²⁹⁸ Xhamia ishte e zbrazët, por u përdor nga disa migrantë për të fjetur gjatë natës.²⁹⁹

Testimi për COVID-19, i cili konsiderohet si një nga mjetet kritike për vlerësimin e situatës së pandemisë, nuk u bë menjëherë i qasshëm për të gjithë. Me kapacitete të kufizuara të testimit, qytetarët e zakonshëm duhej të prisnin me ditë për t'u testuar, ose as nuk ishin në gjendje ta bënin këtë, me gjithë shfaqjen e simptomave ose faktin se kishin pasur anëtarë të familjes së ngushtë të prekur nga COVID-19.³⁰⁰ Nga ana tjetër, politikanët ose personat e famshëm testoheshin brenda një dite.³⁰¹ Mbikëqyrësit e të drejtave të njeriut në Kosovë kanë ngritur shqetësime në lidhje me praktikën diskriminuese të testimit, duke bërë thirrje për transparencë më të madhe dhe monitorim të procesit të testimit, duke përfshirë qasjen në listat e testimit.³⁰² Për më tepër, u ngritën shqetësime lidhur me licencimin e laboratorëve privatë për të kryer teste PCR (RT-PCR) dhe teste serologjike, për çështje që lidhen me akuzat për korrupsion, çmimet e tepruara, madje edhe krijimin e një tregu të zi për shërbimet mjekësore.³⁰³

Stresi, izolimi, humbja e të hyrave, frika dhe ankthi si rezultat i pandemisë, po rrisin nevojën për mbështetje ndaj shëndetit mendor.³⁰⁴ Por, pandemia e ka ndërprerë ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor duke i privuar shumë nga mbështetja e nevojshme. Përkundër kërkesës në rritje për shërbime të shëndetit mendor, MSH-ja nuk ka alokuar asnjë fond shtesë për këto shërbime.³⁰⁵ Mangësitë e sistemit kur flitet për mbështetjen e shëndetit mendor u ekspozuan në mënyrë tragjike nga vetëvrasja e të riut Agon Musliu, i cili po mbahej në karantinë në Qendrën e Studentëve.³⁰⁶ Kjo u pasua nga një hetim i rastit, ndërsa publiku i konsideroi përgjegjëse institucionet e ngarkuara me mbikëqyrjen e masave të karantinës. Më tej, studimet kanë treguar që frekuenca e simptomave të ankthit dhe depresionit në mesin e profesionistëve shëndetësorë në Kosovë gjatë pandemisë Covid-19 ka arritur nivele shqetësuese, megjithëse mungon një krahasim me periudhën para Covid-19.³⁰⁷

295 <https://indeksonline.net/azilantet-ne-kosove-pamje-te-mjerueshme-se-ku-po-kalojne-naten/>

296 Po aty.

297 <https://ëëë.zeri.info/kronika/376028/emigranti-i-ve-zjarr-kampit-ne-vranidoll-arrestohet-nga-polica/>

298 <https://indeksonline.net/ekskluzive-eurofast-arreston-tre-maroken-ne-prishtine-dyshohet-se-para-nje-jave-i-prene-koken-nje-personi/>

299 <https://ëëë.koha.net/arberi/246654/mbi-2-600-imigrante-kane-ardhur-ne-kosove-nga-1-janari-mbi-50-te-tyre-siriane/>

300 <http://ekonomia-ks.com/sq/shendetesi/kmdlj-denon-diskriminimin-gjate-testimit-per-koronavirus>

301 <https://fakteplus.net/qytetaret-presin-me-dite-per-rezultat-in-e-testit-per-covid-19-politikanet-e-marrin-brenda-dites/>

302 <http://ekonomia-ks.com/sq/shendetesi/kmdlj-denon-diskriminimin-gjate-testimit-per-koronavirus>

303 https://globalinitiative.net/ep-content/uploads/2020/12/GI-TOC_SEE_RB_3_EN.pdf

304 <https://ëëë.ëho.int/neës/item/05-10-2020-covid-19-disrupting-mental-health-services-in-most-countries-ëho-survey>

305 <https://ëëë.evropaelire.org/a/shendetit-mendor-pandemia-/30917863.html>

306 <https://balkaninsight.com/2020/05/28/kosovo-students-demand-justice-over-youngsters-suicide-in-quarantine/?fbclid=IëAR2JUVEftËfvP-gËgadZLUqxZzH2yo9P1d4YAcikRI'TmLXCxdNyZbaeDb0>

307 https://ëëë.researchgate.net/publication/343453340_Anxiety_and_depressive_symptoms_among_healthcare_professionals_during_the_Covid-19_pandemic_in_Kosovo_A_cross_sectional_study

Shumë vendime të qeverisë kanë ndërhyrë në të drejtat e qytetarëve, duke përfshirë të drejtën për privatësi dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe kanë shkelur lirinë e shprehjes dhe të drejtat për informacion.³⁰⁸ Siç thekson Flutura Kusari, juriste për media, gjatë pandemisë mbrojtja e privatësisë së pacientëve është një nga përgjegjësitë kryesore gjatë raportimit të mediave, por edhe një nga sfidat më të vështira.³⁰⁹ Një numër i organizatave mediatike i kanë shkelur këto të drejta të privatësisë duke e ekspozuar identitetin e pacientëve ose duke publikuar listat e emrave të personave në karantinë, gjë që potencialisht ka shkaktuar dëme të pariparueshme, përfshirë stigmatizimin social.³¹⁰ Nga ana tjetër, sipas Hilmi Jasharit, ish Avokati i Popullit i Kosovës, gjatë situatës së pandemisë nuk ka pasur rritje të dukshme të ankesave për shkelje të të drejtave të njeriut në Kosovë,³¹¹ por kjo mund të ketë të bëjë edhe me faktin se gjatë asaj kohe shumica e zyrtarëve punonin vetëm online. Kur u pyet për sfidat në adresimin e rasteve që paraqiten në Institucionin e Avokatit të Popullit, Jashari vuri në dukje se shumica e sfidave vijnë nga kultura e përgjithshme publike e mosrespektimit të të drejtave të njeriut, së cilës i bashkohet nevoja për një shqyrtim gjithëpërfshirës të funksionimit të aparatit shtetëror.³¹² Në përgjigjen e tij ai shtoi se në shumë raste ka shkelje të të drejtave të njeriut që nuk bëhen me qëllim nga shteti, por më tepër sepse ato janë një produkt i sistemit.³¹³

Pandemia COVID-19 pritet të ketë ndikim afatgjatë në aspekte të ndryshme në jetën e qytetarëve, duke qenë se masat e karantinës i pezulluan përkohësisht liritë civile dhe ngritën shqetësime mbi funksionimin e përgjithshëm të demokracive. Sipas anketës të BKS-së, 45.67% e të anketuarve nuk mendonin se pandemia COVID-19 në Kosovë ka ndikuar në cilësinë e demokracisë, 32% mendonin se po, ndërsa 22% e të anketuarve nuk ishin të sigurt.

BASHKËPUNIMI DHE NDIHMA NDËRKOMBËTARE

Pandemia COVID-19 ka ekspozuar mangësitë dhe joefikasitetin në sistemin institucional në Kosovë në lidhje me përgatitjen dhe kundërpërgjigje ndaj krizës. Megjithatë pandemia është kryesisht një krizë e shëndetit publik, ndikimi i saj është ndjerë në sfera të ndryshme në shoqëri. Me resurse dhe kapacitete të kufizuara, institucionet e Kosovës u përballën me sfida të shumta në kundërpërgjigjen ndaj nevojës në rritje për masa parandaluese, si pajisje mbrojtëse adekuate për punonjësit e vijës së frontit dhe publikun, pajisje mjekësore dhe barna, dhe objekte trajtimi për COVID-19. Disa nga sfidat janë lehtësuar përmes bashkëpunimit dhe ndihmës ndërkombëtare nga vendet ose organizatat partnere. Veçanërisht, Bashkimi Evropian ndau 5 milionë euro mbështetje të menjëhershme për sektorin shëndetësor, dhe 63 milionë euro mbështetje për rimëkëmbjen sociale dhe ekonomike.³¹⁴ Mbështetja e përgjithshme e BE-së për Kosovën për trajtimin e krizës COVID-19 arrin në 168 milionë euro, duke përfshirë mbështetjen për pajisjet mjekësore, mbështetjen për grupet e cënueshme dhe pakicat dhe qasjen e tyre në shërbimet themelore, dhe mbështetjen për buxhetin e Kosovës si kundërpërgjigje ndaj krizës.³¹⁵

Përveç sigurimit të mbështetjes përmes organizatave shumëpalëshe dhe projekteve rajonale, një **numër vendesh** kanë siguruar edhe mbështetje dypalëshe, duke përfshirë por pa u kufizuar nga

308 https://repository.gchumanrights.org/bitstream/handle/20.500.11825/1622/4.GlobalCampus2020_COVID-19.pdf?sequence=1&isAlloëed=y

309 <http://ëëë.arbresh.info/lajmet/gazetaret-nuk-cenuan-privatesine-e-personave-te-prekur-me-covid19/>

310 Po aty.

311 Intervistë me Hilmi Jasharin, Avokati i Popullit

312 Po aty.

313 Po aty.

314 https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/coronavirus_support_ëb.pdf

315 Bashkimi Evropian në Kosovë, <https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=ëD-oBCcRa4&fbclid=IëARITëV-R3ëV-XYoM-tpxiyhKy-0mxgëGRNVrlkHN754Me3mgBdV34q2Q2-yQ>

